

Zhbllkohet
projekti Bella-
nocë – Stançiq



FAQE 3

Mirëqenia,
të fundit në
rajon



FAQE 4

Vrasja e Lekut,
autori ende
në arrati



FAQE 5

"Sahat
Kulla"
në terr



FAQE 6

Koha

www.koha.mk

Skicë për
mbrothësinë
e përbashkët



FAQE 10

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3149 • E mërkurë 16 gusht 2017 15 DEN



Shqiptarët vërshojnë universitetet

Shkup, 15 gusht - Ethet e regjistrimit në universitete për vitin akademik 2017/2018, tanimë kanë filluar. Të martën, universitete ku studimet zhvillohen në gjuhën shqipe kane hapur dyert për pranimin e dokumenteve. Në Universitetin e Tetovës, Universitetin

"Nënë Tereza" në Shkup dhe në Universitetin e Evropës Juglindore, pritet janë të mëdha dhe në bazë të interesimit që kanë treguar kandidatët për regjistrim, ato shprehen entuziastë për jehonë që do të kenë ofertat e tyre akademike. E veçanta e këtij viti, është se listës së in-

stitucioneve ku shqiptarët mund të studiojnë në gjuhën e tyre amtare, krahas UT-së dhe UEJL-së i është shtuar edhe UNT-ja e cila vjet filloi punë pasi në universitetet tjera kishin përfunduar të gjitha afatet e regjistrimit. E, parë në këtë këndvështrim...

FAQE 2

S'ka verifikim të "votuesve fiktiv" në Listën zgjedhore

Me dilema të vjetra në zgjedhje të reja



Të ashtuquajturit "votues fiktiv" me automatizëm për zgjedhjet lokale kthehen në Listën zgjedhore pasi u hoqën në zgjedhjet e fundit parlamentare, por mbeten dilemat e mëhershme për verifikimin e plotë të tyre. Në pyetjen nëse institucionet kanë ndërmarrë hapa konkret për verifikim, anëtari i KSHZ-së Subhi Jakupi, thotë se përveç deklarimeve publike, nuk ka ndonjë punë serioze nga Qeveria në këtë drejtim

FAQE 3

Pa vullnetin e opozitës, nuk ka reforma në gjyqësor



Shkup, 15 gusht - Nëse ne kemi presion politik dhe gjykatës të cilët e pranojnë këtë presion, atëherë modeli i përkryer i reformave në sistemin gjyqësor të Maqedonisë nuk ekziston. Ky është qëndrimi i ekspertës juridike, Margarita Caca-Nikollovska, e cila njëherit është pjesë e Këshillit për reforma, të cilin javë

më parë e formoi ministri i Drejtësisë, Bilent Sali. Ish gjykatësja e Strasburgut, Caca-Nikollova, duke folur për reformat e paralajmëruara në sistemin juridik, thotë se çfarëdo lloj modeli të ishte, nëse gjykatësit dhe politikanët nuk janë për pavarësi të gjyqësorit, atëherë shumë rëndë se mund të

ndryshohet diçka në këtë drejtim. Praktika evropiane, sipas Margarita Caca-Nikollovsksës, njih modele të ndryshme të reformave në sistemin gjyqësor. Mirëpo, pyetja esenciale që e parashtron ish gjykatësja, është nëse vallë sa këto modele të llojllojshme mund të zbatohen në vendin tonë...

FAQE 5

RAJON

Shqipëria e
Madhe zonë
influence e
perëndimit



"Pika që gërryen Fushë-Kosovën" - Gazeta gjermane "Frankfurter Allgemeine Zeitung" i kushton vëmendje ideve të hedhura nga ministri i Jashtëm serb, Ivica Dačić në median serbe

FAQE 14

AKTUALE

Vonesat
rrezikojnë
fillimin e vitit
shkollor

FAQE 7

GLOBI

Luftë?
SHBA
paralajmëron
Korenë e
Veriut

FAQE 15

SPORT

Gjithçka për
prezantim
dinjitoz



FAQE 19



Nis regjistrimi në UT, UNT dhe UEJL

Shqiptarët vërshojnë universitetet

Në Universitetin e Tetovës, Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup dhe në Universitetin e Evropës Juglindore, pritet për regjistrimin e studentëve në vitin akademik 2017/2018 janë të mëdha. Sipas interesimit që kanë treguar kandidatët për regjistrim, në ditën e parë të dorëzimit të dokumenteve, ato shprehen entuziastë për jehonën që do të kenë ofertat e tyre. Në UT ka afër 4000 vende, në UNT 1580 vende, ndërsa në UEJL 730 vende

Koha | Laura PAPANIKU

Shkup, 15 gusht - Ethet e regjistrimit në universitetet për vitin akademik 2017/2018, tanimë kanë filluar. Të martën, universitete ku studimet zhvillohen në gjuhën shqipe kane hapur dyert për pranimin e dokumenteve. Në Universitetin e Tetovës, Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup dhe në Universitetin e Evropës Juglindore, pritet janë të mëdha dhe në bazë të interesimit që kanë treguar kandidatët për regjistrim, ato shprehen entuziastë për jehonë që do të kenë ofertat e tyre akademike. E veçanta e këtij viti, është se listës së institucioneve ku shqiptarët mund të studiojnë në gjuhën e tyre amtare, krahas UT-së dhe UEJL-së i është shtuar edhe UNT-ja e cila vjet filloi punë pasi në universitetet tjera kishin përfunduar të gjitha afatet e regjistrimit. E, parë në këtë këndvështrim, viti

akademik 2017/2018 është testi i parë i njëmendët sa i takon jehonës së regjistrimit të studentëve në këtë universitet, apo "UNT është në pozita të barabarta me universitete e tjera", sikurse shprehet rektori Aziz Pollozhani.

"Nënë Tereza" në vitin e dytë akademik

Për UNT-në, faktikisht ky është viti i dytë i fillimit me punë. Mirëpo, nisur nga rrethanat pak a shume të jashtëzakonshme me të cilat filloi puna një vit më parë, nuk është e tepërt të thuhet se 2016/2017 do të shënohet në historinë e këtij universiteti si viti i parë, por realisht fillimi sikurse duhet i regjistrimit të studentëve në UNT nis me vitin akademik 2017/2018/ Madje, nga e marta e 15 gushtit, studentët kanë Info qendrën e tyre apo zyrën për çështje studentore e cila nisi të funksionojë këtë ditë. Për të ndihmuar kandidatët, në mbushjen e formulave dhe përcaktimin e drejtimeve në UNT kishte angazhuar stafin akademik, një pjesë e mirë e të cilëve sqaronin të papërcaktuarit me kualifikimet që ofrojnë 25 drejtimet dhe profilet e këtij universitet. Vitin që shkoi, ishin 14 programe studimore, ndërsa këtë vit ofrohen 20 të tilla. UNT është rritur edhe në ofertën e regjistrimit. Nga 1280 vende, sa ishte Konkursi i para një viti për vitin 2017/2018 është hapur Konkurs me 1580 vende. Në procedurë e sipër është pranimi i 43 profesorëve dhe asistentëve, të cilët do tu shtohen 40 mësimd-



hënësve që u pranuan në punë vitin e kaluar, ndërsa janë zgjeruar edhe me hapësira. Në objektin e lidhjes së Sindikatave është do të kenë në dispozicion edhe një kat të ri, kurse do të shfrytëzohen edhe një pjesë të hapësirave në Shkollës Fillore "Kongresi i Manastirit", ku sipas parajmërimeve, më 25 gusht do të përurohet vënia në përdorim e laboratorëve për programet studimore të teknikës dhe teknologjisë.

Për regjistrimin e studentëve të rinj, në UNT për këtë vit janë siguruar 1580 vende gjithsej, prej të cilave 940 me kuotën shtetërore, 410 me kuotën e bashkëfinancimit dhe 230 vende me korrespondencë. Në Universitetin e Tetovës do të ketë afër 4 mijë vende, prej të cilave 1405 me kuotën shtetërore, 2005 me bashkëfinancim dhe 460

me korrespondencë. Ndërkaq, në universitetin privat të Evropës Juglindore, për këtë vit janë planifikuar të regjistrohen 730 studentë të rinj, në programet studimore që ofrohen në Tetovë dhe Shkup. Në Universitetin "Kirili dhe Metodi" në Shkup, dorëzimi i dokumenteve do të jetë më 17 dhe 18 gusht. Dorëzimi i dokumenteve për këtë at do të zgajt deri më 18 gusht.

UT hap dyert për 4 mijë studentët e rinj

Në Universitetin e Tetovës filloi afati i parë i regjistrimit të studentëve të rinj për vitin akademik 2017/18. Regjistrimi i studentëve në afatin e parë të regjistrimit zhvillohet në 13 fakultetet dhe 60 programet e Universitetit të Tetovës. Në bazë të konkursit të shpallur në

muajin korrik, Universiteti i Tetovës për vitin akademik 2017/18 pritet që të regjistrojë rreth 4000 studentë të rinj. Nga ky universitet shprehen të kënaqur me interesimin e maturantëve të cilët kanë zgjedhur për të studiuar në Universitetin e Tetovës. "Në Universitetin e Tetovës duke filluar nga dita e sotme deri në ditën e premtë do të mbahet afati i parë i regjistrimit të studentëve për vitin akademik 2017/18, edhe atë gjithë maturantët e kësaj gjenerate do të kenë mundësi që në gjashtëdhjetë programet studimore përkatësisht në 13 fakultetet të zgjedhin njërin prej tyre. Në bazë të konkursit i cili ishte i shpallur që në muajin korrik parasheh që të regjistrojë 4000 studentë, në bazë të dinamikës së interesimit të studentëve në ditën e parë ne si Universitet jemi të kënaqur dhe shpresojmë se kësajsoj do të vazhdojë edhe në ditën e vijim, pra deri në ditën e premtë, që procesi i regjistrimit të studentëve të rrjedhë siç duhet Universiteti i Tetovës i ka marrë të gjitha masat në veçanti ka angazhuar stafin administrative që të gjithë të jenë në nivelin e detyrë në mënyrë që të mos ketë pritje dhe vonesa në kryerjen e procesit të regjistrimit. Të theksojmë edhe atë se rezultatet pre-

liminare të afatit të parë të regjistrimit do të shpallen ditën e hënë edhe atë që nga ora 8.30 minuta të mëngjesit", deklaroi Reshat Qahili prorektor për arsim. Konkursi për regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2017/18 në Universitetin e Tetovës ashtu sikurse edhe vitin e kaluar nuk parasheh të regjistrojë student të rinj në drejtimet e disperzuara në Kërçovë dhe Shkup, pasi që këto drejtime sipas prorektorit për arsim Reshat Qahili për momentin janë në pauzë, por megjithatë në konkursin e vitit të ardhshëm ka mundësi që konkursi i të përfshijë edhe drejtimet e disperzuara. "Fakultetet e disperzuara në konkursin të cilin ne e kemi shpallur nuk parashihet që të ketë disperzime pasi që edhe vitin e kaluar nuk ka pasur disperzime, mirëpo kjo që me konkurs nuk parashihen disperzime do të thotë se këto drejtime nëpër disa fakultete që ka pasur deri më tani siç ka qenë rasti në Shkup dhe në Kërçovë në fakt këto drejtime janë vënë në pauzë kështu që në vitin e ardhshëm ose në një vit tjetër kur Universiteti do të vlerësojë se ka nevojë për disperzim të drejtimeve atëherë me konkursin e vitit të ardhshëm të shpallim sërish regjistrim të studentëve në drejtimet e disperzuara", tha Qahili. Ndryshe afati i parë i regjistrimit të studentëve të rinj në Universitetin e Tetovës do të vazhdojë deri më 18 gusht gjegjësisht deri në ditën e premtë, ndërsa rezultatet preliminare për pranimin e studentëve do të shpallen më 21 gusht ditën e hënë.

Harvard kryeson në Listën e Shangait, universitetet e Maqedonisë nuk figurojnë

Universiteti më i mirë në botë është Harvardi, ndërsa pas tij vijojnë Stanford, Kemrixh, MIT, Berkli, Princeton, Oksford, Kolumbia, Kalifornia dhe Universiteti në Çikago, tregon lista prestigjioze e Shangait që është publikuar të martën. Midis dhjetë universiteteve të para në këtë listë janë tetë universitete amerikane dhe dy britanike. Lidhur me rajonin, në listë janë vetëm Universiteti i Beogradit, i cili është i pozicionuar midis vendit 201 dhe 300 dhe Universiteti i Lubjanës, i cili është në grupin prej vendit 401 deri në vendin 500. Në listë nuk janë universitetet nga Maqedonia, Kroacia, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina. Lista e Shangait, të cilën e publikon çdo vit universiteti Xhia Tong nga Shangai, është një nga listat më prestigjioze, e cila i rendit 500 universitet më të mira në botë.

Afati i dytë i maturës shtetërore

Njëlloj si afatin e parë

Në kuadër të provimeve të dyta të maturës shtetërore, të martën u testuan nxënësit në lëndën e matematikës. Ishin vetëm 56 maturantë. Ndërkaq, provimet e gjuhëve të huaja, po në kuadër të provimeve të dyta të maturës, do të mbahen të mërkurën. Për këtë lëndë janë 1480 kandidatë. Kështu i thellë ishte dallimi për matematikën dhe gjuhën e huaj edhe në afatin e parë të qershorit

Shkup, 15 gusht - Afati i dytë i maturës shtetërore 2017, nuk ka sjellë asnjë ndryshim nga afati i parë të paktën sa i përket përcaktimit të nxënësve mes matematikës dhe gjuhëve të huaja. Të martën, më 15 gusht vetëm, 56 kandidatë iu nënshkruan provimit të dytë të maturës shtetërore në lëndën e matematikës. Ndërkaq,

për të mërkurën, më 16 gusht, për lëndën e gjuhëve të huaja janë 1480 kandidatë edhe atë vetëm nga 7 për gjuhët frënge dhe gjermane, kurse 1466 kandidatë për gjuhën angleze. Lëndët e matematikës dhe gjuhëve të huaja janë pjesë e provimeve të dyta të maturës shtetërore, ku nxënësit duhet patjetër të gjedhim mes tyre, ose matematikën ose ndonjërin prej gjuhëve të huaja të cilin kanë mësuar katër vjet.

Tradicionalisht në Maqedoni është tepër i madh dallimi në përqindje të nxënësve që zgjedhin matematikën dhe gjuhët e huaja, sidomos anglishten për provim të maturës shtetërore. Edhe në afatin e parë të provimeve të maturës, në muajin qershor dallimi ishte tepër i madh. Matematikën e



zgjodhën si lëndë për verifikimin e njohurive të tyre vetëm 2 070 maturantët nga 16 426 që përgjithësisht kishin paraqitur provimeve të maturës në afatin e qershorit. Marrëdhëniet e nxënësve të shkollave të mesme me lëndën e matematikën, sikurse tregojnë të dhënat zyrtare, nuk janë të njëjta për nxënës të cilët mësojnë në gjuhë të ndryshme. Në

nivele dukshëm më të ulëta është kjo zgjedhje tek nxënësit shqiptarë. Nga 5120 maturantë që kanë paraqitur provim të parë të detyrueshëm gjuhën dhe letërsisë shqipe, për provimin e dytë të detyrueshëm mes matematikës dhe anglishtes për lëndën e matematikës janë paraqitur vetëm 274 nxënës ose 5.4 për qind e atyre që do japin shqipen

si provim të parë. Analiza e provimeve të qershorit tregon se te paralelet turke dhe maqedonase ajo përqindje është në shkallë më të lartë. Nëse detyrimisht provimin e gjuhës dhe letërsisë maqedonase e kanë paraqitur 10632 nxënës, për matematikën janë paraqitur 1749 ose 16.5 për qind. Ndërkaq të turqit, matematika është zgjedhur në nivelin e 11.2 për qindëshit, ose nga 47 nxënës prej 418 maturantë që do të kenë gjuhën dhe letërsinë turke provim të parë. Këta tendenca konfirmohen edhe me provimet e paraqitura në afatin e gushtit ku nxënësit në masë dërmuese zgjedhin gjuhën e huaj dhe shumë pak matematikën. Ndërkaq, provimet e para të maturës shtetërore, respektivisht provimet nga lënda e

gjuhës amtare, për afatin e gushtit provimet u organizuan më 14 gusht. Provimit nga maqedonishtja iu nënshkruan 280 kandidatë, në shqip 370 dhe në turqisht 43 nxënës. Më 18 gusht do të realizohen provimet nga fizika, kimia, biologjia, biznesi, historia, filozofia dhe estetika. Konkretisht, biznesin e kanë paraqitur 219 kandidatë, historinë 210, biologjinë 77, filozofinë 164, kiminë 5, fizikën dhe estetikën nga 2 kandidatë. Për afatin e gushtit, këtë vit provime e maturës shtetërore i kishin paraqitur 2011 nxënës. Sipas konceptit të maturës dhe provimeve përfundimtar në arsimin e mesëm katërvjeçare në Maqedoni, nxënësit duhet tu nënshkruan verifikimit të dijeve në 3 lëndëve. Kontrolli i testeve të provimit bëhet nga Qendra Shtetërore e Provimeve, pra nga jashtë shkollës për cka edhe kanë marrë emrin provime eksterne. (L.P)



S'ka verifikim të "votuesve fiktiv" në Listën zgjedhore

Me dilema të vjetra në zgjedhje të reja

Të ashtuquajturit "votues fiktiv" me automatizëm për zgjedhjet lokale kthehen në Listën zgjedhore pasi u hoqën në zgjedhjet e fundit parlamentare, por mbeten dilemat e mëhershme për verifikimin e plotë të tyre. Në pyetjen nëse institucionet kanë ndërmarrë hapa konkret për verifikim, anëtari i KSHZ-së Subhi Jakupi, thotë se përveç deklarimeve publike, nuk ka ndonjë punë serioze nga Qeveria në këtë drejtim



Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 15 gusht - Komisioni Shtetëror zgjedhor ka filluar përgatitjet intensive për mbajtjen e zgjedhjeve lokale më 15 tetor të këtij viti. Sipas asaj që thotë anëtari shqiptar në KSHZ, Subhi Jakupi, aktualisht po presin përpunimin e të dhënave të zgjedhësve më të drejtë vote nga Enti Shtetëror i Statistikave dhe më 21 gusht të vënë të njëjtën në shqyrtim publik. "Ministria e Punëve të Brendshme më 11 gusht ka bërë përditësimin e ri të listës zgjedhore, ndërsa ne menjëherë e kemi dorëzuar në Entin Shtetëror të Statistikave që t'i përpunojë të dhënat personale të të gjithë zgjedhësve më të drejtë vote. Por, presim që pasi të mbarojë me punë ESHS ne të marrim vendim për vënien e listës zgjedhore për shqyrtim

publik sipas afatit ligjor më 21, ndërsa i njëjti do të zgjasë 20 ditë, deri më 9 shtator. Gjatë kësaj kohe presim që qytetarët të dorëzojnë ankesa për parregullsi eventuale të të dhënave personale dhe po këtë të drejtë e kanë edhe partitë politike", thotë Subhi Jakupi. Të ashtuquajturit "votues fiktiv" me automatizëm për zgjedhjet lokale kthehen në Listën zgjedhore pasi u hoqën në zgjedhjet e fundit parlamentare, por mbeten dilemat e mëhershme për verifikimin e tyre. Në pyetjen nëse institucionet kanë ndërmarrë hapa konkret për verifikimin e tyre, anëtari i KSHZ-së Jakupi, thotë se përveç deklarimeve publike nuk ka ndonjë punë serioze nga Qeveria në këtë drejtim. "Zotime publike ka pasur, por jo edhe ndonjë iniciativë konkrete nga ana e institucioneve shtetërore, aq më shumë kur këta votues u hoqën me kërkesë të

LSDM-së dhe tani kjo parti është në pushtet. Mbetet të shihet si do të veprohet pas zgjedhjeve lokale, sepse tani më koha nuk premtonte edhe aq shumë. KSHZ ashtu siç ka ngritur problemin më herët me votuesit e Pustecit, ku shumë banorë kishin letërnjoftim me një adresë të vetme, edhe kësaj radhe është e gatshme të punojë maksimalisht që të hiqen të gjitha dilemat e listës zgjedhore. Por, barrën kryesore e kanë institucionet qeveritare", thekson për gazetën KOHA, Subhi Jakupi. Sa i përket kërkesës së Lëvizjes BESA që të ketë anëtarin e vetë në KSHZ, Jakupi nuk dëshiron të deklarohet, ndërsa sa i përket Këshillave zgjedhor ai thotë se partitë politike opozitare do t'i kenë përfaqësuesit e vetë, por ndarjen, siç tha, e bëjnë vetë ato. Në komisionet lokale zgjedhore siç njofton Jakupi, anëtarët përzgjidhen nga Ministria

e Shoqërisë Informatike dhe administratës publike, nga e cila presim që këto ditë t'i japë emrat. "Partitë, si ato të pushtetit ashtu edhe të opozitës, delegojnë anëtarët e tyre në këshillat zgjedhor dhe aty ndarja bëhet me marrëveshje mes tyre, në këtë rast të opozitës kur bëhet fjalë për Lëvizjen BESA. Ndryshe qëndron puna në komisionet lokale zgjedhore, sepse aty përzgjedhja bëhet nga ana e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe administratës publike, nga e cila këto ditë presim të na dërgojë listën me emra", thekson Jakupi. Ndërkaq, Lëvizja BESA pretendon se i takon anëtar në KSHZ, që të zëvendësojë anëtarin e tanishëm Bedredin Ibrahim i deleguar nga PDSH, me arsyetimin se PDSH nuk e ka pozicionin e partisë së dytë më të madhe opozitare. Por, BESA akuzon se deri më tani ka munguar vullneti nga ana e partive në pushtet për të

ndërmarrë veprime në Parlament për zëvendësimin e anëtarit të KSHZ-së Bedredin Ibrahim i me përfaqësuesin që do të delegojnë ata. Nga LSDM kanë shfaqur qëndrimin se Lëvizjes BESA i takon anëtari në KSHZ, por që nuk ka pasur hapa konkret në Parlament nga kjo parti. Nga BDI kanë qëndruar neutral, duke mos pranuar të japin ndonjë qëndrim për këtë çështje. Lëvizja BESA më herët ka dorëzuar iniciativë në Qeveri për të dhënë mendim mbi dispozitat e Kodit zgjedhor dhe po ashtu kërkesë në Parlament për interpretim autentik të Kodit Zgjedhor. Deputeti nga Lëvizja BESA Afrim Gashi thotë se shumë shpejtë do të kenë takim me kryetarin e Parlamentit Talat Xhaferi, për të parë se deri ku ka shkuar puna rreth kërkesës për interpretim autentik të Kodit zgjedhor. "Po presim që në mbledhjen e Qeverisë të jepet mendim pozitiv rreth pretendimit tonë të mbështetur në dispozita ligjore se neve na takon anëtari nga opozita në KSHZ. Kur jemi tek Parlamenti, shumë shpejtë do të kemi takim me kryetarin Talat Xhaferi për të parë më për së afërmi se deri ku ka shkuar puna e kërkesës sonë për interpretim autentik të Kodit Zgjedhor. Edhe këtu presim përgjigje pozitive bazuar në dispozita konkrete ligjore se neve

na takon anëtari në KSHZ", thotë Afrim Gashi nga Lëvizja BESA.

Ndryshe, kur jemi tek përgatitja e zgjedhjeve do të dihet numri i zgjedhësve tek kur KSHZ do të vendosë për shqyrtim publik Listën zgjedhore, por numri nuk mund të lëviz shumë nga 1.820.00 mijë zgjedhës, kjo nga të dhënat e përditësimit paraprak të MPB-së. Sa i përket kandidatëve, partitë afatin fundit e kanë 14 shtatorin deri në ora 24:00 që ti dorëzojë emrat për kryetar komune dhe emrat për këshilltar komunal. KSHZ në afat prej 48 orëve do të vendosë për parregullsi eventuale në listat e kandidatëve, dhe më pas partitë apo kandidatët e pavarur kanë afat prej 48 orëve të përmirësojnë ato. Nëse KSHZ përsëri konstaton në afat prej 24 orëve se lista prapë ka parregullsi me aktvendim e hedhë poshtë atë. Fushata zgjedhore do të fillojë më 25 gusht, ndërsa në rrethin e parë zgjedhor ajo mbaron më 13 tetor në ar 24:00 ku 24 orë të tjera kemi heshtje parazgjedhore. Fushata në rrethin e dytë zgjedhor sipas dispozitave ligjore mbaron më 27 tetor në ora 24:00 dhe më pas kemi heshtje parazgjedhore ndërsa rrethi i dytë për kryetar komunash do të mbahet më 29 tetor. Në ditën e 11 të fushatës parazgjedhore partitë apo kandidatëve pavarur të detyruar të dorëzojnë në KSHZ raport financiar për të hyrat dhe të dalat në parti.

Osmani pret që BE të japë rekomandim për fillim të bisedimeve

Osmani realizoi mëngjes pune me ambasadorët e pesë vendeve të Ballkanit Perëndimor, atë të Shqipërisë, Kosovës, Bosnje dhe Hercegovinës, Malit të Zi dhe Serbisë. Në këtë takim të parë nga një sërë takimesh koordinative të parapara me ambasadorët e vendeve të Ballkanit Perëndimor u diskutuan disa tema strategjike me interes të përbashkët



zoi mëngjes pune me ambasadorët e pesë vendeve të Ballkanit Perëndimor, atë të Shqipërisë, Kosovës, Bosnje dhe Hercegovinës, Malit të Zi dhe Serbisë. Në këtë takim të parë nga një sërë takimesh koordinative të parapara me ambasadorët e vendeve të Ballkanit Perëndimor u diskutuan disa tema strategjike me interes të përbashkët. "Bullgaria do të kryesojë Bashkimin Evropian nga 1 janari. Mendoj se ka interes që ky rajon mos të bëhet një vrimë e zezë në Evropë, por të jetë lartë në prioritetet e Bashkimit Evropian dhe mendoj se ata si udhëheqës të Bashkimit

Evropian për gjashtë muaj do të fusin axhendën e zgjerimit të Ballkanit Perëndimor shumë lartë në prioritetet e Bashkimit Evropian", deklaroi Osmani para fillimit të takimit me ambasadorët e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ai, duke theksuar se bashkëpunimi mes shteteve të Ballkanit Perëndimor do të jetë më i dobishëm se sa angazhimet individuale të këtyre gjashtë shteteve, bëri të ditur se një ndër temat kyçe në takimin e parë koordinues është axhenda për zgjerimin e Ballkanit Perëndimor. Sipas tij, është një mundësi his-

"Zhblokohet realizimi i projektit Bellanocë - Stançiq"

Zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Bujar Osmani, të martën e nënshkroi plotësimin e Marrëveshjes për financim të IPA programit për bashkëpunim ndërkufitar mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës për vitin 2013, me çka edhe ligjërisht IPA mjetet e këtij programi vihen në dispozicion për financim të projektit strategjik Bellanocë - Stançiq. Kësaj i parapriu vendimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë me çka Osmani mori autorizimin për nënshkrim të plotësimin të marrëveshjes për financim të IPA-s. "Me përkushtim të madh u punua për plotësimin e të gjitha kushteve të domosdoshme, të cilat ishin të nevojshme për fillimin e realizimit të këtij projekti. Një prej aktivitetëve më të rëndësishme ishte ndërtimi i rrugës deri tek kalimi i ri kufitar, i cili u financua prej mjeteve nacionale në shumë prej rreth 6.000.000 eurosh", tha Osmani për mediat. Ai shtoi se bëhet fjalë për kalim kufitar të përbashkët, ku organet kufitare do të ndajnë një ndërtesë të përbashkët e cila gjendet në territoret e dy vendeve. Prej këtu rrjedh edhe kompleksiteti i këtij projekti, për fillimin dhe realizimin e të cilit ishte e nevojshme të bëhen konsultime dhe harmonizime gjithë-përfshirëse të procedurave, në pajtim me legjislacionet e dy shteteve, që padyshim kërkonte shumë kohë. Pas harmonizimit afatgjatë të procedurave për përpunim të dokumentacionit urbanistik dhe projektues, ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme dhe vënien në përdorim të kalimit kufitar, ndarjes së shpenzimeve operative dhe kryerjes së kontrolleve kufitare etj, gjatë ditës së nesërme do të vijojë nënshkrimi i Protokollit mes dy vendeve, me të cilin të gjitha procedurat do të finalizohen.

torike për Ballkanin Perëndimor në aspiratat euro-atlantike, pasi që BE-në do ta udhëheqin tre vendet e rajonit, së pari Bullgaria, pastaj Austria dhe Rumania. "Ne duhet ta shfrytëzojmë këtë mundësi kur këto vende mund ta sjellin axhendën

e zgjerimit të Ballkanit Perëndimor në nivel me prioritet shumë të lartë. Ne duhet të shfrytëzojmë këtë dritare mundësish për të dhënë rezultate konkrete, që pastaj mund të bëjmë një thyerje substanciale në këtë drejtim", u shpreh Osmani. Plani 3-

6-9 është miratuar në fillim të muajit të kaluar, bazuar në programin e Qeverisë, Marrëveshjen e Përzhinës, Raportin e Pribres, të Komisionit të Venecias, Komisionit të Grekos, si dhe rekomandimeve OSBE-ODIHR.



Maqedonia me vendin e 83-të, renditet e fundit në rajon sipas Indeksit të zhvillimit njerëzor. Para nesh janë Serbia në vendin e 66-të, Shqipëria në vendin e 75-të, por edhe Bosnja e Hercegovina në vendin e 81-të

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 15 gusht - Maqedonia duke u pozicionuar në vendin e 83-të, renditet e fundit në rajon sipas Indeksit të zhvillimit njerëzor. Para nesh janë Serbia në vendin e 66-të, Shqipëria në vendin e 75-të, por edhe Bosnja e Hercegovina në vendin e 81-të. Indeksi i Zhvillimit Njerëzor i OKB-së apo (UN Human Development Index-HDI), në çdo shtet vëzhgon Prodhimin e Brendshëm Bruto, gjegjësisht të ardhurat apo mirëqenien, jetën e gjatë dhe të shëndetshme, si dhe arsimin. Në bazë të këtyre treguesve renditen edhe shtetet e ndryshme anëtare të OKB-së.

Të dhënat e fundit për Maqedoninë janë edhe më dëshpëruese, për shkak se si shtet shënojmë rënie për tetë vende në Indeksin e Zhvillimit njerëzor përgjatë periudhës 2010-2016. Derisa në vitin 2010 Maqedonia renditej në vendin e 71-të, tash kemi shënuar ulje në vendin e 83-të.

Sipas indikatorëve që përllogarit Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, Indeksi i zhvillimit njerëzor është një metodë e standardizuar në vlerësimin dhe matjen e mirëqenies së një popullsie, duke qene një matje krahasuese e pasurisë, alfabetizimit të të rriturve dhe shkallës së

përfshirjes së nxënësve në arsimin e ulët, të mesëm dhe të lartë, edukimin, jetëgjatësinë e lindjeve dhe mirëqenien të matur përmes Prodhimit të Brendshëm Bruto për kokë banori, si dhe faktorëve të tjerë përcaktues për shëndetin e shoqërisë. Lista është e ndarë në katër grupe nga rreth 45 shtete

Indeksi i Zhvillimit Njerëzor të OKB-së

Mirëqenia, Maqedonia e fundit në rajon



Maqedonia ka pritshmëri të jetëgjatësisë prej 75.5 vjet, vitet e pritshme të shkollimit prej 12.9 vjet dhe prodhim të brendshëm bruto prej 12.405 dollarë për kokë banori

vendet e botës së tretë. Mjaft analistë në bazë të kësaj formule i ndajnë shtete në të zhvilluara, në zhvillim dhe ato të botës së tretë. Autori kryesor i raportit, Selim Xhahan, thotë se lidhur me zhvillimin njerëzor fokusi duhet të vendoset në cilësinë para kuantitetit. "Një kohë të gjatë jemi marrë me kuantitetin e zhvillimit njerëzor dhe atë sa fëmijë shkojnë në shkollë, a kanë njerëzit jetë të gjatë dhe të shëndetshme, etj. Megjithatë tani ka ardhur koha të shtrojmë çështjen."

Në rregull, fëmijët vijnë shkollën, por çka mësojnë atje? Një e treta e fëmijëve kanë problem me matematikën dhe leximin, edhe pse kanë përfunduar pesë klasë të arsimit themelor. Pra, çështja e cilësisë së arsimit paraqet problem në çdo shoqëri", thekson Xhahan. Sipas tij, raporti thekson se një kohë të gjatë bota ka qenë nën tiraninë e mesatares. Për shembull, indeksi multidimensional i varfërisë tregon se një miliardë e gjysmë njerëz jetojnë në varfëri multidimensionale. Por, kur kjo ndahet në viset urbane dhe rurale, shikohet se nga ky total vetëm 11

të vlerësuar sipas shkallës së zhvillimit njerëzor. Maqedonia me vendin e 82-të, edhe pse është në grupin e dytë të vendeve me një zhvillim të lartë njerëzor për vitin 2016, pas grupit të shteteve me zhvillim "shumë të lartë njerëzor", ajo megjithatë ngrec në raport me të gjitha shtetet e rajonit. Para nesh janë Serbia në vendin e 66-të, Shqipëria në vendin e 75-të, por edhe Bosnja e Hercegovina në vendin e 81-të. Një zhvillim shumë më të madh se ne, në këtë tregues, kanë shtetet e ra-

jonit si Mali i zi në vendin e 48-të, Kroacia në vendin e 45-të, ndërsa më mirë e renditur është Sllovenia në vendin e 25-të, duke kaluar bile Italinë që renditet në vendin e 26-të në botë.

Për vetë faktin se nuk është e njohur nga të gjitha anëtarët e OKB-së, në këtë renditje nuk figuron Kosova me të dhënat e saja respektive. Listën e kryeson Norvegjia me jetëgjatësi të pritshme prej 81.7 vjet, vitet e pritshme të shkollimit prej 17.7 vjet dhe të ardhura për kokë banori prej 67.614 dollarë. Sa për

ilustrim Maqedonia ka pritshmëri të jetëgjatësisë prej 75.5 vjet, vitet e pritshme të shkollimit prej 12.9 vjet dhe prodhim të brendshëm bruto prej 12.405 dollarë për kokë banori.

Përndryshe Indeksi i zhvillimit njerëzor apo HDI, The UN Human Development Index paraqet një formulë që mat varfërinë, arsimin, mjeshtrinë e të shkruarit apo nivelin e të lexuarit dhe të shkruarit në një shtet, jetëgjatësinë dhe faktorët e tjerë në vendet e zhvilluara dhe

MF LËSHOI LETRA SHTETËRORE ME VLERË, NË VLERË PREJ 43,93 MILIONË EURO

Ministria e Financave sot në ankand ka lëshuar letra shtetërore me vlerë, në vlerë prej 2.701 miliardë denarë (43,93 milionë denarë). "Bëhet fjalë për bono 12-mujore shtetërore me vlerë 1,741 milionë denarë me kamatë prej 1,85 për qind, obligacione persëvjeçare shtetërore me vlerë prej 80 milionë denarë me kamatë prej 2,50 për qind dhe obligacione 15-vjeçare shtetërore me vlerë prej 880,50 milionë denarë me kamatë prej 3,80 për qind, kumtoi Ministria e Financave. Paralajmëron se nesër, në bazë të letrave paraprakisht të dhëna shtetërore me vlerë, do të paguajë 2,001 miliardë denarë (32,55 milionë euro). Dallimi prej 700,01 milionë denarë (11,38 milionë euro) do të shfrytëzohet për aktivitete të parapara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë, thuhet në kumtesë.

Pesë vite pa Arbën Xhaferin

Tetovë, 15 gusht - Dje, më 15 gusht, u mbushën pesë vjet që kur u nda nga jeta ish kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare, Arbën Xhaferi. Me këtë rast, kryetari aktual i Partisë Demokratike Shqiptare, Menduh Thaçi, bëri homazhe tek varri i tij në varrezat e qytetit në Tetovë. Ish kryetari Arbën Xhaferi ndërroi jetë në Tetovë, më 15 gusht të vitit 2012. Përndryshe, ai u lind më 24 janar 1948 në Tetovë, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin, kurse studimet në degën e filozofisë i kreu në Universitetin e Beogradit. Në moshën kur ishte student ai u dënua me burg për bindjet e tij politike, orga-



nizimin dhe pjesëmarrjen në demonstratat e Tetovës të vitit 1968, ndërsa pas

lirimit ai u transferua në Prishtinë. Nga viti 1975 deri në vitin 1990 punoi

në Radiotelevizionin e Prishtinës si redaktor përgjegjës i programit të

kulturës. Gjatë kësaj periudhe punoi si analist në të përjavshmet "Koha" të Vetton Surroit dhe "Forum" të Adem Demaçi, si dhe në disa media të tjera shqiptare dhe të huaja. Në vitin 1993, Arbën Xhaferi u kthye në vendlindje, për ta vazhduar veprimtarinë e tij intelektuale dhe politike. Në vitin 1994 u zgjodh kryetar i Partisë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve (PPDSH). Gjatë konfliktit të armatosur të vitit 2001, Arbën Xhaferi dha një kontribut të veçantë, sidomos për nënshkrimin e Marrëveshjes së Prizrenit dhe arritjen e Marrëveshjes së Ohrit. Qasja konstruktive e

Xhaferit në atë kohë u përkrah nga faktori ndërkombëtar, duke e legjitimuar luftën e shqiptarëve dhe nisur kështu bisedimet që përfunduan me Marrëveshjen e Ohrit, për ndërrimin e konceptit të shtetit. Arbën Xhaferi ka publikuar dy vepra, "PDSH-ja jo në letër", dhe "Sfidat e Demokracisë në Shtetet Multietnike". Ai drejtoi PDSH-në deri në vitin 2007, kur u pasua nga kryetari i tanishëm Menduh Thaçi. Xhaferi vuante nga sëmundja e Parkinsonit dhe në periudhën e fundit ai gjithnjë është marrë me shkrime dhe opinione, ndërsa nuk ka patur shumë paraqitje publike. (U.H)



Praktika evropiane njeh modele të ndryshme të reformave në sistemin gjyqësor. Mirëpo, ish gjykatësja Caca-Nikolovska, shtron dilemën se sa këto modele mund të zbatohen në vendin tonë, nga vetë fakti se çështja më e rëndësishme është vullneti politik nga njëra anë dhe nga ana tjetër vullneti te vetë gjykatësit, të cilët duhet të angazhohen për krijimin dhe kultivimin e pavarësisë në gjyqësor

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 15 gusht - Nëse ne kemi presion politik dhe gjykatës të cilët e pranojnë këtë presion, atëherë modeli i përkryer i reformave në sistemin gjyqësor të Maqedonisë nuk ekziston. Ky është qëndrimi i ekspertës juridike, Margarita Caca-Nikolovska, e cila njëherit është pjesë e Këshillit për reforma, të cilin javë më parë e formoi ministri i Drejtësisë, Bilent Sali. Ish gjykatësja e Strasburgut, Caca-Nikolova, duke folur për reformat e parajlmëruara në sistemin juridik, thotë se çfarëdo lloj modeli të ishte, nëse gjykatësit dhe politikanët nuk janë për pavarësi të gjyqësorit, atëherë shumë rëndë se mund të ndryshohet diçka në këtë drejtim. Praktika evropiane, sipas Margarita Caca-Nikolovskës, njeh modele të ndryshme të re-

Sistemi juridik të reformohet me ndryshime kushtetuese

Pa vullnetin e opozitës, nuk ka reforma në gjyqësor



formave në sistemin gjyqësor. Mirëpo, pyetja esenciale që e parashtron ish gjykatësja, është nëse vallë sa këto modele të lloj-llojshme mund të zbatohen në vendin tonë, nga vetë fakti se çështja më e rëndësishme është vullneti politik nga njëra anë dhe nga ana tjetër vullneti te vetë gjykatësit, të cilët duhet të angazhohet për krijimin dhe mirëmbajtjen e pavarësisë në gjyqësor. Në kohën kur përmenden reformat në

gjyqësor, ajo shton se integriteti i gjykatësve është tejet i rëndësishëm, respektivisht ajo e ndanë mendimin se shumë reforma duhet të bëhen në pjesën e zgjedhjes së gjykatësve, me çka automatikisht nënkuptohet reformim të Këshillit gjyqësor, përfshi mandatin e tij, kompetencat, aktivitetet dhe në përgjithësi profesionalizmi i anëtarëve. Vetë reforma në gjyqësor varët nga ajo se prej ku do të fillohet. Nëse

bëhet ndonjë reformë në sferën e ndryshimeve kushtetuese, në këtë rast është e qartë se kjo rutë e reformës do të jetë më e rënda, nga vetë fakti se duhet të sigurohen dy të tretat e votave të deputetëve në parlament. Ky parim vlen edhe për një pjesë të Ligjit për Këshillin gjyqësor. Duke i pasur parasysh këto kushte, mendoj se fillimisht duhet të ekzistoj vullneti politik. Ndërkaq, çështja më e rëndësishme sipas meje

është që të gjitha faktorët e mundshëm në shtet që kanë ndikim duhet të bëjnë presion mbi opozitën, për tu pranuar këto reforma në sistemin juridik me qëllim që ta hapet rruga për në Bashkimin Evropian dhe NATO-n. Përderisa opozita deklarohet se është për anëtarësimin e Maqedonisë në këto dy instanca të larta evropiane, ndërkaq nga ana tjetër me veprimet e tyre bëjnë çmos që mos të bëhen disa ndryshime sistematike, atëherë ato bien ndeshë me qëndrimet e tyre. Për shembull pse ato janë kundër shkarkimit të kryeprokurorit, kur janë të bindur se nuk kanë kryer asnjë vepër kriminale”, thotë Caca Nikolovska, për gazetën KOHA. Prokurori aktual i shteti, siç nënvizon ajo, gjatë kohës sa e ushtron detyrën e tij ka treguar një pasivitet të caktuar në bazë të sanksionimit të veprimeve që i ka ndër-marrë pushtetit i atëherëshëm, tashmë opozita. Në komentin e saj lidhur me shkarkimin dhe emërtimin e kryeprokurorit të rij, ajo thotë se kandidati ideal për postin e krye-

prokurori është ai person, i cili është i vetëdijshëm për lëshimet që i ka bërë prokurorit aktual Marko Zvërvlevski, respektivisht ai person tek i cili mbizotëron mendimi që funksionin e tij ta kryen në mënyrë profesionale dhe të ketë njohuri profesionale se si duhet kryer puna e një prokurori publik. Rolin e Këshillit gjyqësor për reformat në gjyqësor është potencuar edhe në rekomandimet e Raportit të Pribes, ku thuhet se anëtarët e këtij këshilli duhet të zgjidhen enkas nga radhës gjykatësve më profesional dhe me tepër përvojë, gjegjësisht nga radhës e juristëve më të dalluar në shtet. Në pjesën e rekomandimeve për reforma në gjyqësor, Raporti i Pribes thekson se në praktikën gjyqësore duhet të zhvillohet terminin statutar “jurist i dalluar”. Ndryshe, rekomandimet e këtij raporti të cilat pritet të harmonizohet në legjislacionin vendas nga Qeveria aktuale, thonë se Këshilli gjyqësor duhet t'i kryen detyrat e veta pa asnjë lloj ndikimi politik nga jashtë (qoftë në mënyrë direkte apo indirekte).

Zjarr në një banesë në Kavadar, nuk ka të lënduar

Kavadar, 15 gusht - Në një banesë në qendrën e re të Kavadarit natën e kaluar rreth mesnatës shpërtheu një zjarr, në të cilin nuk ka persona të lënduar. Komandanti i Njësisë Territoriale Zjarrfikëse nga Kavadari, Ilčo Bogeovski sot në mëngjes informoi se ka intervenuar me dy automjete zjarrfikëse dhe tre zjarrfikës. "Patëm sukses që të mos lejohet zjarri të përhapet edhe në banesat e tjera nga ndërtesa kolektive", tha ai. Apelon që të kihet kujdes që në një prizë të mos vendosen disa aparate elektrike në të njëjtën kohë. Në mënyrë shtesë do të bëhen të ditura arsyet e zjarrit dhe vlera e dëmit material në banesë.

Vrasja e Lekut, “autori i panjohur” ende në arrati

Vrasja e Dilaver Bojkut, njërit prej “të fortëve” të Strugës, fundin e sezonit turistik në këtë qytet e ka vënë nën hije. Përderisa policia ende nuk ka dalë me raport zyrtar se cilat janë motivet e vrasjes, nëpër Çarshinë e Strugës qarkullojnë spekulime të ndryshme

Strugë, 15 gusht - Sektori për punë të brendshme në Ohër dhe Stacioni i policisë në Strugë kanë ndërmarrë masa intensive për gjetjen e autorit të vrasjes së Dilaver Bojkut, që ndodhi të hënën pasdite në restorantin “Akua Blu” në Strugë. Autori akoma është në arrati dhe i pakapshëm për policinë. Nga sektori për Punë të Brendshme në Ohër, konfirmojnë se ngjarja ka ndodhur në terracën e restorantit Akua Blu që është në pronësi të Lekut.

“Në afërsi të tij është afruar, tani për tani një person i panjo-



hur i cili në drejtim të kokës ka shtënë me pistoletë, duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse. Më pas personi në fjalë, me vrap ka braktisur vendin e ngjarjes duke ikur në drejtim të rrugës “Partizanska”. Me qëllim të kapjes së autorit drejt tij janë nisur dy persona, por të njëjtit kanë hequr dorë nga qëllimi pasi kryerësi i vrasjes edhe drejt tyre ka gjuajtur dy plumba”, njoftojnë nga Sektori për Punë të Brend-

shme, Ohër, pa dhënë më shumë hollësi rreth hetimit.

Dilaver Bojku u qëllua të hënën pasdite dhe iu nënshtrua plagëve të marra edhe pse, siç njoftojnë mjekët, në spitalin e Strugës kanë tentuar që ta kthejnë në jetë. Në vendngjarje është kryer ekspertizë nga Prokurori Publik i Prokurorisë Themelore të Strugës nën prezencën edhe të ekipeve policore. Me urdhër të prokurorit publik, mbi trupin e

të ndjerit është kryer obduksion. Vrasja e Dilaver Bojkut, njërit prej “të fortëve” të Strugës, fundin e sezonit turistik në këtë qytet e ka vënë nën hije. Përderisa policia e shteti ende nuk ka dalë me raport zyrtar se cilët kanë qenë motivet e vrasjes, nëpër Çarshinë e Strugës qarkullojnë spekulime se vrasja e Bojkut është bërë për shkaqe të hakmarrjes, ndërsa ekzistojnë zëra që thonë se atentati ndaj tij është bërë me pagesë. Ngelet të vërtetohet nëse vrasja e Dilaver Bojkut është bërë për shkaqe të gjakmarrjes. Vëllai i të ndjerit dhe djali i tij para dy vite ishin të akuzuar për vrasjen e 23 vjeçarit nga fshati Belicë e Poshtme. Për këtë vepër vëllai i Dilaver Bojkut qëndron në paraburgim, ndërsa i biri ende gjendet në arrati. Hetimet për këtë rast, sipas policisë së Strugës janë në dorën e Prokurorisë dhe të njëjtat prite të vërtetohen nëse vrasja është bërë për hakmarrje apo për motive të tjera. I ndjeri Dilaver Bojku më herët ka vuajtur dënim për vepra të ndërlidhura me tregtinë me njerëz. (O.XH)



Qytetarët ankohen për problemet urbane në Komunën e Çairit

Lagja e "Sahat Kullës" në terr

Krahas vozitësve, të cilët e kanë problem të qarkullojnë gjatë natës në rrugën "Petre Gjeorgjiev", problem më i madh ju paraqitet këmbësoreve, gjegjësisht nënave me karroca, të cilët përveç bllokimit të trotuareve - ato hasin edhe në rrugë tërësisht të errësuar

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 15 gusht - Nëse gjatë ditës në rrugën "Petre Gjeorgjiev" në Komunën e Çairit, ballafaqohesh me një kaos të paparë në komunikacion, brenda natës banorët e lagjes së Sahat Kullës dhe atyre që gravitojnë përreth përballen me një errësirë të plotë. Ndonëse në këtë rrugë zyrtarisht funksionojnë disa institucione fetare dhe arsimore, siç janë Bashkësia Fetare Islame dhe shkolla fillore "Kongresi i Manastirit", prapë se prapë kjo nuk është arsye që sistemi i ndriçimit të riparohet. Qytetarët e kësaj ane të Shkupit, e cila llogaritet si një prej lagjeve më të vjetra në kryeqendër, shprehen



të zhgënjyer nga kaosi urban që mbizotëron në lagjen e tyre. Ndrëçimi i vetëm i rrugës "Petre Gjeorgjiev" gjatë orëve të mbrëmjes, sipas rrëfimeve të banorëve, kohëve të fundit bëhet vetëm nga vitrinat e shitoreve. Sistemi jashtëfunktional i ndriçimit, njëherësh ka ndikuar që të shtohen edhe vjedhjet në këtë rrugë. Si pasojë e anarkisë që është prezent në këtë rrugë, banorët thonë se disa herë ka pasur tentime për vjedhjen e dyqaneve përreth, ndërsa më së rën-

di ka pësuar barnatorja e vetme në këtë lagje. Krahas vozitësve, të cilët e kanë problem të qarkullojnë gjatë natës në rrugën "Petre Gjeorgjiev", problemi më i madh ju paraqitet këmbësoreve, gjegjësisht nënave me karroca, të cilët përveç bllokimit të trotuareve, ato hasin edhe në rrugë tërësisht të errësuar. Duke komentuar gjendjen aktuale me ndriçimin, kryetari i Këshillit Komunal në Çair, Zahir Bekteshi, për gazetën KOHA thotë se rrjeti i ndriçimit në Komunën e Çairit në

përgjithësi funksionon mirë, mirëpo nuk përjashtohen mundësitë që në rrugë të caktuara të ketë probleme. "Sistemin e ndriçimit të rrugëve dhe rrugicave në Komunën e Çairit e kemi të dhënë me koncesion. Kështu që besoj se bëhet fjalë për ndonjë problem të vogël, siç janë djegia e ndonjë trafostacioni apo në pyetje është ndërrimi i llambave ndriçuese. Sidoqoftë, ne i mirëpresim reagimet e qytetarëve dhe denoncimet e tyre. Ky problem shprej se brenda një afati të

shkurtër kohor do të zgjidhet. Në këtë mënyrë, ditë më parë problem me ndriçimin pati edhe rruga "Mendeleva" në lagje e Gazi Babës, por me intervenimin e ekipeve të EVN-së kjo pjesë e Çairit përsëri ka ndriçim", thotë Bekteshi. Mes tjerash ai, thekson se angazhimi i tij në komunë është i përditshme dhe në këtë mënyrë apelon që për çdo ankesë - banorët e Çairit t'i drejtohen atij. Jo shumë larg rrugës "Mendeleva", për të cilën autoritetet e Komunës së Çairit thonë se pas de-

noncimeve të qytetarëve e kanë riparuar sistemin e ndriçimit, në lagjen e Gazi Babës gjendet edhe rruga "Stojna Stevkova", e cila e lidhet me rrugën kryesore "Cvetan Dimov" dhe e cila më pas të shpie deri te Qendra për pranimin e emigrantëve. Megjithatë, dy-tre javë të plota edhe kjo rrugë - pas perëndimit të diellit, gjendet në errësirë të plotë. Me këtë rast, Bekteshi premtoi se urgjentisht do të iniciohet procedurë për shqyrtimin dhe zgjidhjen e këtij problemi. Ai, mes tjerash thekson se qytetarët duhet të jenë më aktiv në denoncimin e problemeve të kësaj natyre, respektivisht paraqitjen e defekteve të tilla ta bëjnë në adresë të duhur. Ndryshe, përkundër faktit se Komuna e Çairit është njëra prej komunave më të dendura në rajon dhe më gjerë, zgjidhja e problemeve urbane nuk paraqet utopi, mirëpo fatkeqësisht mungesa e shoqërisë civile dhe aktiviteteve qytetare ka ndikuar që raportet qytetarë-komunë dhe anasjelltas të jenë në një nivel tejet të ulët, për të mos thonë inekzistent.

Publicitet

www.koha.mk
Koha
E përditshme informative


ÇMIMORE PËR PREZANTIM TË PAGUAR POLITIK ZGJEDHJET LOKALE 2017

Faqja e parë (color) 1 cm ²	2 €
Faqja e fundit (color) 1 cm ²	1 €
Faqja e brendshme (color) 1 cm ²	0,8 €
Faqja e brendshme (bardhë e zi) 1 cm ²	0,6 €
1/1 faqja e brendshme (bardhë e zi)	350 €
1/2 faqja e brendshme (bardhë e zi)	196 €
1/4 faqja e brendshme (bardhë e zi)	126 €
1/1 faqja e brendshme (color)	455 €
1/2 faqja e brendshme (color)	266 €
1/4 faqja e brendshme (color)	140 €
1/2 faqja e brendshme portret (bardhë e zi)	280 €
1/2 faqja e brendshme portret (color)	350 €

Dimensionet

1/1	250 x 385 mm
1/2	250 x 190 mm
1/4	122 x 190 mm

Shërbime speciale: - kërkesa e veçantë për pozicionim të reklamës e rrit çmimin për 25%.
Në çmim nuk është llogaritur TVSH-ja.





Punët shtesë vonojnë përfundimin e çatisë në shkollën "Liria" Vonesat rrezikojnë fillimin e vitit shkollor

Ditë më parë kompania Eurovia ka dalë me qëndrim rreth ngecjeve të punëve në ndërtimin e kulmit të shkollës "Liria". Sipas njoftimit të kësaj kompanie, gjatë kryerjes së punëve kanë dalë probleme që nuk kanë qenë të paraparë dhe që kanë paraqitur rrezik për në të ardhmen që kulmi të shembet. Kjo ka ndikuar që kompania të kërkojë që të rishikohet projekti edhe njëherë



si do të vepohet me atë pjesë shtesë. "Momentalisht është duke u punuar në pjesën që ka qenë e paraparë për rikostruim dhe aty punët janë në fazën finale. Por në pjesën tjetër të çatisë e cila poashtu është në rrezik nga shembja nuk kanë filluar akoma punët. Informacione tjera shtesë nuk kam se si do të rrjedhin punët për atë pjesë", tha Shpresa Iseini, drejtoreshë e shkollës Liria në Tetovë. Ditë më parë kompania Eurovia kishte dalur me qëndrim rreth ngecjeve të punëve në ndërtimin e kulmit të kësaj shkolle. Sipas njoftimit të kësaj kompanie gjatë kryerjes së punëve kanë dalur problem që nuk kanë qenë të paraparë dhe që kanë paraqitur rrezik për në të ardhmen që kulmi të shembet dhe kjo ka bërë që kompania që është duke

rikostruar këtë kulm të kërkojë që të rishikohet projekti edhe njëherë. "Përgjatë realizimit të punës, doli një situatë e pa paraparë në lidhje me një pjesë të objektit. Një pjesë e kulmit të objektit është në gjendje të mjerueshme dhe e njëjta paraqiste rrezik për probleme me serioze në të ardhmen. Kjo pjesë e kulmit nuk ishte e paraparë të sanohet sipas Marrëveshjes së parë mes Kompanisë Eurovia dhe Ministrisë së Arsimit dhe e njëjta u parashtrua në kërkesë të posaçme. Ky problem gjithsesi që e ngadalësoi rrjedhën e realizimit të projektit, por nuk paraqet neglizhencë as nga ana e Kompanisë ndërtimit, as nga ana e Ministrisë së Arsimit. Përkundrazi, procedurat rrjedhin, dhe në ditët në vazhdim do të vijohet me aktivitetet, në

Koordinim me Ministrinë e Arsimit. Me përgjegjësi shprehemi që në realizim të punës në shkollën Liria nuk ka asnjë anashkalim dhe puna realizohet sipas afatëve të parapara", thonë nga kompania Eurovia e cila realizon punët për ndërtimin e kulmit të shkollës Liria në Tetovë. Megjithatë edhe përkaj kësaj, afati I fundit ishte që punët të përfundojnë më 13 gusht por edhe më pas ende në këtë shkollë kryhen punët. Nga ana e Sektorit për Arsim në komunën e Tetovës theksuan se ngecjet poashtu janë shënuar edhe për shkak të temperaturave ku nuk është punuar me orar të plotë, por sigurojnë se deri më 1 shtator do të përfundojnë punët në kulmin e shkollës. Përndryshe, në këtë shkollë fillore, që prej 74 vitesh nuk është bërë asnjë investim. Pikërisht nga kjo neglizhencë e Ministrisë së Arsimit, vit më parë, shembja e kulmit, rrezikoi edhe nxënësit që mësonin në katin e dytë, shkaku i të cilës edhe u mbyllën klasat në katin e dytë të shkollës. Nga Ministria e Arsimit ditë më parë theksuan se punët maksimum mund të vonohen dhjetë ditë por pa dhënë afat konkret se a do të filloi në kohë mësimi në këtë shkollë.

Koha | Urim HASIPI

Tetovë, 15 gusht - Ende nuk kanë filluar punët për pjesën shtesë të kulmit të shkollës fillore Liria në Tetovës. Kjo ishte kërkuar nga ana e ndërmarrjes që kryen punët në kulmin e kësaj shkolle pasi që ishte konstatuar se një pjesë e kulmit që nuk ishte pjesë e planit për rikostruim ishte në gjendje të mjerueshme. Mirëpo ende nuk ka ndonjë përgjigje konkrete lidhur me këtë kërkesë dhe punët vazhdojnë të realizohen vetëm për atë pjesën që ishte pjesë e projektit. Disa ditë më radhë në këtë shkollë punët ishin ndërprerë kurse ende nuk ka informacione zyrtare se

Projekt për confirmim të standardeve për menaxhim të mirë në komuna

Shkup, 15 gusht - Katërbëdhjetë organizata qytetare të martën nënshkruan marrëveshje për grante në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian, përmes të cilit do të konfirmohen standardet për menaxhim të mirë në vetëqeverisjet lokale në bazë të së ashtuquajturës SIGMA parime për administratë publike. Projekti "Ndjekje të parimeve të administratës publike në ruajtjen e vlerave të menaxhimit të mirë" e realizon Qendra për menaxhim me ndryshime, në partneritet me Asociacionin për menaxhim konsalting MKA-2000 dhe Qendra për gazetari hulumtuese SKUP

Maqedoni. Për realizim të projektit Bashkimi Evropian ndau 70.000 euro, gjegjësisht nga pesë mijë euro për çdo grantist. Sipas koordinatorit të projektit Martin Dodevski, standardet për menaxhim të mirë në administratën shtetërore qendrore të konfirmuara me SIGMA iniciativën e përbashkët të KE dhe OECD, do të aftësohen në nevojat e vetëqeverisjeve lokale. Siç potencoi Neda Maleska nga Qendra për menaxhim me ndryshime, pas krizës politike në shtet jashtëzakonisht është e rëndësishme që sërish të punohet në reformat në administratën publike, në pajtueshmëri të kërkesave të

BE-së. Mes të tjerash, shpjegoi, do të punohet në përmirësimin e transparencës së pushtetit lokal me informata më të mira dhe të inkuadrimin të qytetarëve në marrjen e vendimeve me ç'rast do të jenë përgjegjës për jetën në bashkësi, si dhe se si të kontribuohet edhe për zhvillimin ekonomik të komunave. Përfaqësuesi i SKUP-it, gazetari Zoran Ivanov, para pjesëmarrësve në projekt theksoi rëndësinë e mbështetjes nga opinioni për efektet nga puna e tyre. "Është shumë e rëndësishme që efektet nga puna e organizatave qytetare të prekin deri te opinioni më i gjerë", tha Ivanov. Me pro-

jektin, shtoi, organizatat qytetare duhet të aftësohen që të inkuadrohen në përfaqësimin e politikave dhe ndikimit ndaj aktorëve të cilët marrin vendime që të mund t'i realizojnë dhe t'i identifikojnë lëshimet gjatë zbatimit të modelit për menaxhim të mirë nga ana e BE-së, nxitje të transparencës, llogaridhënies dhe administratës së orientuar servise. Aktivitetet do të realizohen gjatë vitit të kaluar për çka do të iniciohet bashkëpunim me Ministrinë e vetëqeverisjes Lokale me qëllim që standardet të bëhen praktikë e konfirmuar përmes politikave të këtij resori.

"Beton" rikonstruon rrugën Ropalcë-Mateç-Likovë

Shkup, 15 gusht - Është pranuar oferta nga data 3 korrik e këtij viti e kompanisë ndërtimore Beton sh.a. Shkup për rikonstruimin e rrugës shtetërore P2133, aksi Ropalcë-Mateç-Likovë, kumtoi u.d. drejtori i Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore (NPRRS) Zoran Kitanov, përmes shërbimit qeveritar për informim. Çmimi i dakorduar me TVSH të përfshirë arrin 106.490.436, 51 denarë. "Kryerësi obligohet pas lidhjes së marrëveshjes t'i kryejë punët e ndërtimit, si dhe t'i evitohet të gjitha mangësitë e aksit të paraparë për rikonstruim. Periudha kohore të cilën e përfshin marrëveshja është 40 muaj nga dita e nënshkrimit të saj, duke përfshirë edhe shkurtime apo vazhdime të mundshme në pajtim me kushtet e veçanta dhe të përgjithshme të Marrëveshjes", thuhet në kumtesë.



Ndjekje e dërgesave postare përmes sistemit

Shkup, 15 gusht - Posta e Maqedonisë ka realizuar risinë e paralajmëruar në punën e saj ku dërgesat nga porositë përmes internetit të cilat do të arrijnë në Postën e Maqedonisë transformohen në letër - si dërgesa me rekomandim. Këto dërgesa, siç citohet në njoftimin nga Drejtoria e Postës së Maqedonisë, me ngjitjen e një bar-kodi të veçantë futen në sistemin për ndjekje të dërgesave të Postës së Maqedonisë, edhe përkrah asaj që asnjë direktivë e Lidhjes Botërore Postare nuk na obligon për atë. Të gjithë qytetarët të cilët blejnë nga shitës të huaj, arritja e dërgesave të tyre në Postën e Maqedonisë dhe realizimin e dorëzimit tashmë mund ta ndjekin përmes sistemit për ndjekje të dërgesave të Postës së Maqedonisë, vendosur në faqen e internetit www.posta.com.mk. Me këtë eliminohen të gjitha dyshimet për humbjen e qëllimshme ose të pa qëllimshme të dërgesave nga porositë përmes internetit në Postën e Maqedonisë, informojnë nga Posta e Maqedonisë. "Qëndrojmë edhe më tej në anën e klientëve tanë dhe i inkurajojmë që për të gjitha dilemat dhe pakënaqësitë të na kontaktojnë drejtpërdrejt ose përmes dorëzimit të ankesave online në faqen e internetit të Postës së Maqedonisë", thuhet në njoftim.

Gjendje më e volitshme në industrinë e përpunimit

Shkup, 15 gusht - Vlerësim më të volitshëm për gjendjen e firmave në industrinë e përpunimit në korrik në krahasim me qershorin e këtij viti dhe në krahasim me korrikun e vitit të kaluar kanë dhënë udhëheqësit e firmave. Pritet që numri i të punësuarve të rritet, bëri të ditur Enti Shtetëror për Statistikë. Indikator i

besimit në industrinë e përpunimit, sipas vlerësimit të udhëheqësve, në korrik në krahasim me qershorin e këtij viti është më i lartë për 0,4 për qind, ndërsa në krahasim me qershorin e vitit të kaluar për dy për qind. Situata e sigurisë e prodhimit me porosi në korrik në krahasim me qershorin e këtij viti është

më e volitshme, pritjet për vëllimin e prodhimit në tre muajt e ardhshëm janë më të volitshme në krahasim me muajin paraprak, ndërsa rezervat e prodhimeve të gatshme janë rritur në krahasim me qershorin e këtij viti. Shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve të subjekteve afariste, muajin e kaluar ka arritur 65,3 për qind

nga shfrytëzimi normal. Ndikim më të madh ndaj kufizimit të vëllimit të prodhimit kanë: konsumi i pamjaftueshëm i huaj me 20 për qind, mungesa e fuqisë së kualifikuar të punës me 19,2 për qind, konsumi i pamjaftueshëm vendor me 17,9 për qind dhe mjedisi i pacaktuar ekonomik me 12,4 për qind.





Në krye të forcës më të frikshme luftarake të botës, Aleksandri i Madh krijoi një perandori madhështore nëpërmjet shpatës, dhe është quajtur hero, tiran dhe perëndi

ALEKSANDRI I MADH

Mbreti që u bë Perëndi!

Pasardhësit e kanë veshur me një aureolë djaloshare dhe një entuziazëm tipik helen djalin e Filipit II të Maqedonisë. Është heroi më i madh aventurier i historisë dhe iu përket atyre figurave të privileguara, të pajisura me një rini të përrjetshme. Një figurë e admirueshme ushtarake përgjatë historisë, tek i cili inteligjenca dhe forca e vullnetit harmonizoheshin në mënyrë perfekte. Aleksandri ndërtoi një perandori me një sipërfaqe prej 5.4 milionë km katror, dhe këtë e bëri brenda një periudhe kohore jashtëzakonisht të shkurtër. Ndikimi i krijimit të perandorisë së tij do të shumë herë më i madhe se vetë krijimi i saj. Sepse Aleksandri ngrihti bazat e qytetërimit grek deri në Azinë Qendrore dhe Indi. Pushtimet e tij krijuan "botën helene" një përzjerje e mrekullueshme e kulturës greke me aziatike. Prindërit e tij ishin Filipi II i Maqedonisë dhe nëna quhej Olimpia, një princeshë e Epirit me të njëjtin gjak të shqiptarëve të sotëm. Traditat si dhe ritet e saj e lodhën shumë së fundi bashkëshortin mbretëror. I cili më vonë u bind nga një femër maqedonase që ta linte Olimpia. Por nga kjo rezultoi një grindje e fortë midis babait dhe të birit por nga ana tjetër karriera ushtarake e Aleksandrit begatoi gjatë mbretërimit të babait të tij. Aleksandri ishte vetëm 18 vjeç kur ai mbante gradën gjeneral gjatë betejës së Keronës të zhvilluar në 338 pr.K. Në këtë betejë, që bënte pjesë në fushatën e Filipit për të nënshtruar qytetshitetet e Athinës dhe Tebës, Filipi ia besoi djalit krahun sulmues. Aleksandri e përballi sulmin vendimtar duke i shkatërruar linjat athinase. Pa këtë karakter pasionant, të trashëguar nga e ëma, Aleksandri nuk do të ishte gjeniu që njihet dhe arritjet e shkëlqyera në teatrin e historisë do të kishin qenë të pashpjegueshme. Arsimimi i Aleksandrit është një tjetër pikë e fortë e figurës së tij historike.

Filipi i dha trashëgimtarit edukimin më të mirë të kohës. Për ta futur Aleksandrin e ri në rrugën e kulturës helenike, Filipi zgjodhi Aristotelin. Filozofi e frymëzoi nxënësin më një dashuri të tillë ndaj poezisë greke, veçanërisht ndaj Homerit. Si pasojë e arsimimit të tij ai e donte shumë "Iliadën" dhe gjithnjë mbante një kopje të saj më vete. E ëma i kujtonte vazhdimisht se ishte pasardhës i Akilit dhe Herakliut, dhe se synimi i tij në jetë duhet të ishte: të jetonte sipas famës së heronjve të Luftës së Trojës. Këto ide Aleksandri i



ruajti për gjithë jetën. Përpara se të bëhej mbret historianët mbajnë mend një ngjarje të hidhur në raportin babë-bir midis Aleksandrit dhe Filipit. Njëri nga të afërmit e njerëzës së Aleksandrit u

shpreh gjatë një festë se martesë e re mund t'i jepte një trashëgimtar legjitim fronit të Maqedonisë. Aleksandri brofi: "Ti më quan mua bastard!". Filipit i kërcyen nervat; nxori kordhën dhe u hodh

mbi djalin e vetëm. Por pas disa hapash u shemb i mposhtur nga pija, gjë që i shpëtoi jetën edhe Aleksandrit. Skena mbaroi me disa fjalë të hidhura të princit të ri: "Ja njeriu që përgatitet të kalojë nga Europa në Azi, por s'mund të ecë nga njëra tryezë tek tjetra pa u rrëzuar!" Disa kohë më vonë Filipi u vra (është menduar se Aleksandri mund të kishte gisht), Aleksandri bëri një punë të mirë duke ekzekutuar çdo kënd që pretendonte fronin dhe gjithashtu vazhdoi ekspeditën e planifikuar të të atit për të ndëshkuar persët në dëmin që u kishin shkakuar grekëve në konfliktin greko-pers.

Në 334 pr.K Aleksandri kaloi Helespotin duke filluar kështu marshimi drejt një udhëtimi vetëm vajtjeje sepse ai nuk do të kthehej i gjallë në Maqedoninë e tij të dashur. Balalafaqimi i parë midis ushtrisë maqedonase dhe perse do të zhvillohej në lumin Granik. Pas fitores së bindshme Aleksandri

rifilloi marshin drejt brigjeve perëndimore të Anadollit për të çliruar qytetshitet greke, ai e devijoi rrugën dhe u drejtua për nga veriu dhe hyri në qytetin e Gordiumit, ishte viti 333 pr.K në një vit ai kishte çliruar plot 30 qytete grek. Pasi hyri në Gordium ai kreu një nga aktet më të famshme të tij. Në Gordium gjendej një litar nyje i quajtur nyja e Gordiumit shumë kishin provuar për ta zgjidhur por të gjithë kishin dështuar. Aleksandri vetëm me shpatën e tij e ndau në dysh duke e zgjidhur nyjen, legjenda thoshte se ai që do ta zgjidhe atë do të bëhej Zot i Azisë. Dari III ndërkohë, perandori i Persisë, kishte filluar të mobilizonte vetë ushtrinë dhe u ndesh me Aleksandrin në Isus në vitin 333 pr.K. Aleksandri e fitoi betejën duke përqendruar forcat maqedonase në momentin më kulminant të betejës. Dari ia mbathi duke lënë ushtrinë e tij të vdekur në brigjet e lumit Isus, gruan, vajzat dhe nënën si dhe disa xhevahire persiane që Aleksandri e ekspozoi për athinasit. Ai nuk i keqtrajtoi familjen e Darit dhe e trajtoi çdo individ të saj me respektin më të lartë.

Fushata tjetër e Aleksandrit të madh do të ishte Egjipti. Egjiptasit e pritën krahë hapur çlirimtarin e tyre. çdo qytet e mirëpriti Aleksandrin. Ai rindëroi tempujt dhe qytetarët e thjeshtë do ta dokumentonin bujarinë e tij. Mund të thuhet se i gjithë karakteri shkëlqimtar i Aleksandrit i ishte trashëguar nga e ëma, Olimpia. Në Egjipt, Aleksandri vizitoi tempullin e perëndisë Amon, në Oazën Sivah. Aleksandri u bë kult për egjiptianët dhe e shikonin Iskandarin (i njohur nga njerëzit e lindjes) si një perëndi, bir i Zeusit. Atje në Sivah Aleksandri i Madh pyeti kryepriestit: "Si ta qeveris botën?" dhe kryepriestiu iu përgjigj: "Duhet ta qeverisë me drejtësi, me përkujdesja dhe respekt për të gjithë ata që i nënshtrohen pushtetit tënd dhe duhet të mbash mend ti nuk je një i vdekshëm i zakonit ti je një Zot, I mban mend faraonët tanë? Ti je një Zot në tokë. Mos e harro këtë". Aleksandri solli ndërmend faktet ai kishte shkatërruar një ushtri shumë më të madhe se e tija dhe kishte pushtuar hapësira të gjëra tokësore në një kohë me të vërtetë të shkurtër. Në vend që të priste Darin Aleksandri u hodh në sulm. Ai u largua nga Egjipti në pranverën e vitit 331 pr.K dhe mbërriti në Gaugamelë në tetor të

atij viti. Beteja më epike e Aleksandrit dhe Darit në këtë copë tokë të Irakut të sotëm. Beteja shpalsi të gjitha cilësitë ushtarake të Aleksandrit. Ai e fitoi betejën dhe Dari ia mbathi sërish ai u vra disa vjet më vonë në një nga strehimet e tij në Kaukaz, nga një shërbëtor i Aleksandrit, ky i fundit do të ekzekutohej vetë nga Aleksandri. Trupi u trajtua me respekt nga Aleksandri dhe u nderua me nderimet e fundit. Pas fitores së Gaugamelës Aleksandri marshoi drejt Persepolisit dhe qyteteve të tjera të rëndësishme perse ku mori veshje dhe plaçka dhe filloi ti përshpallte me kulturën greke që po përhapte. Për të forcuar lidhjet me shumë mes kulturës helene dhe asaj perse në vitin 327 pr.K Aleksandri martohet me një vajzë 16 vjeçare perse, princeshën baktriane, Roksanën. Gjithashtu ai martoi të gjithë gjeneralët e tij me gra perse.

Në 326 pr.K Aleksandri filloi pushtimin e Indisë duke kaluar kështu nga historia në legjendë. Ai fitoi një triumf mbresëlënës në betejën e Hydapasis kundër mbretit Porus. Ashtu siç kishte treguar dhembshuri me çdo qytet që i kishte hapur derën edhe këtu ai tregon një dhembshuri të veçantë. Aleksandri i kapi dorën mbretit Porus dhe i tha: "A do të bëhesh miku im?". Aleksandri donte të mbushte një kupë që nuk kishte fund por burrat dhe gjeneralët e tij ishin të lodhur dhe kërkonin të ktheheshin. Aleksandri e ndali avancimin e tij në lumenjtë Puncxhab dhe Beas. Asnjë nga fitoret vendimtare të betejave të luftuara kundër perseve nuk ia kishin shuar okskin e pangopur për pushtet dhe dominim. Ai kishte ndërmend të bënte një ekspeditë tjetër, kësaj here kundër Kartagenës, por gjatë rrugës së kthimit atë e zunë ethet dhe vdiq me 10 qershor 323 pr.K në moshën 32 vjeçare. Trashëgimia që la pas Aleksandri i Madh ishte e madhe, më gjigande se vetë titulli i tij hyjnor. Hapi kulturën greke, krijoi një perandori ku njerëzit gjykoreshin përmes zemrës dhe jo ngjyrës apo etnicitetit. Me përjashtim të Jezu Krishtit pothuajse nuk ka figurë më të njohur të Antikitetit në historinë perëndimore se sa Aleksandri i Madh. Veprimet e tij i përkasin një legjende. Frymëzoi shumë vepra letrare, piktura, skulptura si dhe filma. Dhe pavarësisht se kanë kaluar më shumë se dy mijëvjeçarë nga vdekja e këtij sundimtari legjendar, fitoret e tij mbi persët si ajo e vitit 331 pr.K qëndrojnë edhe sot si një shembull suprem i lidershit ushtarak. Jul Qezari i krahasoi fitoret e tij me arritjet e sundimtari maqedonas kurse Napoleoni u përpoq të ishte një Aleksandër i ri, ai shkoi aq larg me këtë fiksim saqë pushtoi edhe Egjiptin si një hije e paraardhësit të tij.






Ishte 39 vjeç kur u vra ndërkohë që shihte një shfaqje në Audubon ballroom të Harlemit. Kush qëlloi dhe kush e dha urdhrin? Investigimi i detajuar i Marable rindërton një të vërtetë të ndryshme: ishte një komando prej pesë keqbërësish që firmosën ekzekutimin. Ai që qëlloi i pari, që dha goditjen vdekjeprurëse nuk është trazuar asnjëherë nga drejtësia. Sot jeton në Newark

Amerikës i është dashur të presë një president me ngjyrë që di t'i flasë Islamit, i rritur që fëmijë nën hijen e minareve të Xhakartës, më pas yll i Harvardit, i pastruar nga çdo lloj "akcenti zezakësh", lingvistik dhe ideologjik, statisti që guxon të mendojë një shoqëri të paqësuar dhe post-racore. Vetëm në epokën e Barak Obamës bëhet e mundur të rihapet një tabu e madhe, një faqe e grisur e historisë. Është çështja Malcolm X. Sot do të ishte 90 vjeç, dhe vdiq kur ishte 39, i qëlluar për vdekje ndërkohë që mbante një fjalim pasionant para turmës në Audubon Ballroom të Harlemit. Në atë 21 shkurt të vitit 1965, ditën e një vdekjeje të dhunshme që ai vetë e kish parashikuar dhe paralajmëruar, Malcolm X mori me vete në varr shumë sekrete: duke nisur nga identiteti i vrasësve dhe porositësve të tyre. Për më shumë se 40 vite, një intelektual i madh me ngjyrë, historiani Manning Marable ka punuar për të dalë në krye të misterit. Marable, themelues i departamentit të studimeve afroamerikane në Columbia University, ndërroi jetë 4 vjet më parë. Ka dalë pas vdekjes, vepra e tij monumentale: "Malcolm X: A Life of Reinvention". Një veper që të ndihmon të kuptosh arsyen e shumë heshjtëve dhe omerta-ve. Një tjetër historian, Stephen Howe, kujton se çfarë e bëri Malcolm X, heroin e një brezi të tërë: "Orator i jashtëzakonshëm, u shndërrua në ekranin ku miliona njerëz me ngjyrë projektuan shpresat e tyre. Kishte shumë prej improvizuesve të muzikës xhaz, u parapriu repistëve të së ardhmes. Mishëronte legjendën e të jashtëligjshmit hakmarrës, në një shoqëri ku zezakët s'kishin të drejta".

Artist i ribërjes së vetvetes, Marable e përshkruan si një ndërtim të "maskës së shumëfishtë": nga një i pagdhendur province, në keqbërës, nga njeri i spektaklit në intelektual autodidakt, ekspanent radikal i nacionalizmit të njerëzve me ngjyrë, predikues fetar, mysliman ortodoks. Një rival i ashpër i Martin Luther King, por nga fundi ishte në prag të pajtimit me të: duke firmosur kështu dënimin e tij me vdekje. Pas vrasjes së Mal-

Banditi i shfrenuar, që u bë predikues i "Kombit të Islamit"



colm X, tre burra u arrestuan, gjykuan dhe dënuan me shpejtësi. Dy

prej tyre u liruan në vitet tetëdhjetë dhe nuk kanë pushuar asnjëherë së



deklaruar i pafajshëm. vetëm i treti, Talmadge Hayer, i dalë nga burgu vitin që kaloi, ka rrëfyer fajësinë e tij. Ishte vetëm ai që qëlloi atë ditë? Investigimi i detajuar i Marable rindërton një të vërtetë të ndryshme: ishte një komando prej pesë keqbërësish që firmosën ekzekutimin. Ai që qëlloi i pari, që dha goditjen vdekjeprurëse nuk është trazuar asnjëherë nga drejtësia. Është 76 vjeç, sot jeton në Newark, nën emrin William Bradley. Është një ish kampion basketbolli.

Pista e porositësve hapet në dy drejtime, drejt forcave kundërshtarë mes tyre por njësoj të interesuara për të eliminuar Malcolm X dhe më pas për ta varrosur atë në harresë. Nga njëra anë është FBI, e cila interceptonte në mënyrë sistematike telefonatat e tij, që injoroi kërcënimet për vdekje që shumëfishoheshin dhe që bëri të pamundurën që atentati të ndodhte i pazuar. Nga ana tjetër është radikalizmi me ngjyrë, duke filluar nga Kombi i Islamit dhe një udhëheqës si Louis Farrakhan, i cili i ka rrëfyer Marable: "Mund të më nxjerrin para një jurie të madhe edhe sot, nuk ka recetë për vrasjet". Provat e grumbulluara nga autori

janë shokuese, Michael Eric Dyson i Georgetown University është i bindur: "Ky libër imponon rihapjen e hetimeve". Peter Goldman, gazetari që e ka intervistuar më shumë Malcolm X, është i bindur që një gjë e tillë nuk do të ndodhë: "Të bësh drejtësi sot, duke u ringjitur në shkallën e komandës? Të godasësh atë që dha urdhrin për ta qëlluar? Askush nuk e do". Ringjallja e fundit interesante e çështjes i përket fundit të viteve nëntëdhjetë: sharmi i Malcolm X bëri për vete regjisorin Spike Lee që bëri një film për jetën e tij duke ia besuar rolin Denzel Washingtonit. Në vitin 1999, postat i dedikuan një pullë postare. Por pastaj erdhi 11 shtatori: në epokën e luftës globale kundër terrorizmit, ishte telash të kujtoje që një Islam radikal dhe i dhunshëm ka hedhur rrënjë prej kohësh në shoqërinë amerikane, mes zezakëve, dhe jo si fenomen i importuar nga bota arabe. Tek Islami, i riu Malcolm Little nga Omaha, Nebraska mbërriti pas disa rimishërimeve, të shoqëruara me ndryshime identiteti: Jack Carlton, Detroit Red, Satan, El-Hajj malik El-Shabazz. Në fund ajo X, simbol i rebelimit ndaj mbiemrave që u viheshin skllëvërve me ngjyrë. Bir i një pastori baptist ndoshta edhe ai vetë i vrarë nga të bardhët, Malcolm rritet në një familje kaq të varfër sa që shpesh herë për darkë e ëma mund të ziente vetëm barëra që mbliidhte në rrugë. Bëhet shpërndarës droge, më pas kapo i një bande hajdutësh në Detroit dhe në Harlem. Nga 1946 deri në 1952 e kalon kohën në burg për grabitje, në Norfolk Prison Colony, Massachusetts. Këtu konvertohet në Islam, braktis duhanin dhe lojërat e fatit, studion historinë e afroamerikanëve dhe bashkë me të Herodotin, Kantin, Niçen. I ndodh kalimi mes dy roleve po aq popullorë në mitologjinë e zezakëve: banditi i shfrenuar hakmarrës për të shtypurit, dhe predikuesi i thirrur për të shpëtuar shpirtërat e tyre. Rikrijimi i imazhit të tij vazhdon deri tek e famshmjia Autobiografia e Malcolm X: kjo iu besua një ghost-writeri shumë të mdoeruar, gazetari me ngjyrë Alex Haley, i cili më pas do të bëhej i famshëm me "Rrënjët". Në atë autobiografi, burim i filmit të Spike Lee, ekzagjerohet kurrikulum i kriminal i Malcolm X, për ta bërë edhe më spektakolar shndërrimin e tij në besimtar.

Në kulmin e famës së tij Malcolm X bëhet zëd-

hënës i Kombit të Islamit dhe kontribuon në zgjerimin e radhëve deri në 500.000 të regjistruar. Kur gjatë një aksidenti ajror vdesin 62 pasanikë të bardhë nga Atlanta, kjo është prova për të që "Zoti ekziston". Reagan ndaj vrasjes së John F. Kennedy duke thënë që e kish merituar. Rekruton në burgje, duke krijuar kështu një përzjerje mes militantëve politikë dhe kriminelëve. Bën thirrje për luftë të armatosur, mbron terrorizmin kundër policisë, bëhet pararendësi teorik i Panterave të Zeza. Imagjnon një "komb me ngjyrë" që bën ndarjen brenda Amerikës, madje shkon deri atje sa takohet me ekspanentë të Ku Klux Klan për të projektuar "ndarjen e dy racave". Me Malcolm X, shpjegon Howe, Kombi i Islamit u shndërrua në një "përzjerje bizare teologjike, fantashkence, fanatizmi racor. Ai teorizonte ligësinë e racës së bardhë e në veçanti hebrenjve, si dhe inferioritetin e grave". Divorci vjen papritur. Për arsye edhe personale: udhëheqësi shpirtëror i Kombit të Islamit, Elijah Muhammad lë shtatzënë gruan me të cilën Malcolm kishte patur një marrëdhënie të gjatë. Më pas vjen udhëtimi në Mekë, takimi me një Islam të moderuar dhe shumëaracor. Një tjetër konvertim: në besimin sunit. Është "tradhtia" që armatos vrasësit e tij. Pikërisht në momentin kur Malcolm nis të rekuerojë dialogun me Martin Luther King, deri atëherë i quajtur një lloj dajë Tomi, një shërbyes i të bardhëve. "Ka gjëra më të rëndësishme se sa e drejta të ulësh bashkë me të bardhët në një restorant", kish thënë Malcolm X me një ton shpërfillës ndaj Martin Luther King.

Për poetin me ngjyrë Amiri Baraka, Malcolm X dhe trashëgimia e tij është më pak negative nga sa duket: "Sensi i identitetit, pavarësia, me këto vlera vija e ashpër e lëvizjes së njerëzve me ngjyrë pati një impakt shumë të madh në shoqërinë amerikane. Pa të nuk do të kishim patur Obamën". Edhe në këtë pikë zezakët vazhdojnë të jenë të ndarë. Mes atyre që shohin tek Malcolm një mbrojtës të krenarisë së racës, dhe atyre që shohin tek ai burimin e viktimitimit të përjetshëm: etiketa e "zezakut të zemëruar" që Obama ka arritur ta heqë me një mundim të madh, duke duruar me stoicizëm akuzat për kombësinë e tij keniane apo fenë e tij islamike. Dhe kur në korrik të vitit 2009 ky president mori në mbrojtje një profesor me ngjyrë të Harvard, Henry Louis Gates, viktimit e një dhune të tepruar nga policia, Amerika e bardhë dhe konservatore iu hodh "në fyt" Obamës. Duke shpresuar që do të reagoonte me nerv. Duke ëndërruar që do të gjenin si kundërshtar një Malcolm X: një Satana.

(Focus)

Skicë për mbrothësinë e përbashkët



Arbën XHAFERI

Dijetari dhe publicisti, Arbën Xhaferri, në vitin 2007 publikoi një platformë të posaçme mbi mënyrën e bashkëpunimit mes Kosovës, Shqipërisë dhe trevave shqiptare. Ai e ka titulluar shkrimin "Skicë për mbrothësinë e përbashkët". Gazeta KOHA, në pesëvjetorin e vdekjes së tij po boton të plotë këtë shkrim

Objektivat kryesorë janë:

- Çështjet e identitetit; Unifikimi i standardeve kombëtare,
- Demokracia,
- Ekonomia,
- Arsimi,
- Barazia gjinore,
- Shekularizmi,
- Të drejtat njerëzore,
- Gjyqësori,
- Sporti,
- Ndërveprimi,
- Rinia

-Qëllimi parësor i këtij projekti duhet të jetë shndërrimi i handicapit në përparësi

-Pa standardizim nuk mund të mbrohet asnjë vlerë, veçmas ato që kanë të bëjnë me identitetin kombëtar

-Nëse nuk do të gjendet një rrugë e lejueshme, qytetëruese që do t'i bashkonte të gjitha kapacitetet e shqiptarëve në kuadër të një intence, eskatoni të përbashkët kombëtar, atëherë këto kapacitete do të shfrytëzoheshin nga të tjerët

-Popujt e qytetëruar siç janë francezët apo britanikët në vijë të afirmimit të interesave kombëtare, madje kanë formuar organizma mbinacionale vullnetare siç është projekti i Frankofonisë apo Commonwealthi

Platforma

Tashmë është bërë e pamundur që të zhvillohet një debat racional për nacionalizmin. Pas zhvillimeve tragjike gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë, pas konflikteve të ndryshme etnike, kulturore, religjioze etj., anekënd botës është anatenuar nacionalizmi si faktor luftënxitës, atavist dhe jo human. Krahas këtij perceptioni negativ të fenomenit të nacionalizmit nuk mungojnë deklaratat mbi interesin nacional si vlerë parësore. Bie fjala rusët apo kinezët thonë se në Kosovë mbrohet interesi i tyre nacional, prandaj kanë qëndrim refuzues për pavarësinë e saj. Nëse kosovarët do të thoshin se në Kosovë mbrohen interesat e shqiptarëve, atëherë ky përcaktim, pa dyshim do të anatemohej si nacionalizëm, si një ideologji retrograde, ataviste që

duhet të çrrënjoset. Shpeshherë si kontrapunkt i nacionalizmit të popujve të vegjël, që bëjnë rezistencë kundër trajtimit të tyre kolonial, ose asimilimit jepet shembulli evropian, ai i tolerancës, mendësisë inkluzive, kozmopolite. Gjatë përdorimit të këtyre argumenteve, megjithatë harrohet një fakt i pamohueshëm: vendlindja e nacionalizmit është Europa. Në kuadër të qytetërimit evropian konfliktet etnike janë tejkaluar falë zgjidhjes përfundimtare të çështjeve etnike, përkatësisht në sajë të arritjes së kongruencës ndërmjet përmbajtjes etnike dhe kufijve politik të shteteve. Aty ku mungon kongruenca, përkundër mirëqenies ekonomike, ende shfaqen fërkime mbi baza etnike. Sociologu amerikan, Benedikt Anderson, me të drejtë konstaton se nacionalizmi u shfaq në skenën historike europiane në shekullin XVI kur popujt e Europës humbën besimin në librat e shenjtë, përkatësisht në të "vërtetat" e shenja që dolën se ishin lajthitje. Rrënim i besimit në religjion shtoi kërkesën që të gjendet një ideologji kompensuese. Së këndejmi kompensimi u gjet te nacionalizmi, te zëvendësimi i hyjnore me njerëzoren. Kështu edhe në sferën e politikës depërtoi fryma e Renesansës dhe e Humanizmit.

Çdo njeri ashtu si edhe çdo shoqëri ka nevojë inhereente për siguri, për përkatësi ndaj një grupi, për adhurim, për krenari, si dhe për manifestime të fisnikërisë, të devotshmërisë ndaj një ideali. Zëvendësimi i hyjnore me njerëzoren ishte produkt evropian që ndikoi në formimin e shteteve kombëtare. Ky proces kulmoi në Francë ku nacionalizmi kishte rol emancipues, përkatësisht

çlirues: duke krijuar shtetin komb, shtetin nacional, njëkohësisht u arrit barazia në mes të qytetarëve, pa marrë parasysh dallimet e ndryshme ndërmjet tyre. Qytetari më nuk ishte pronë e monarkëve, por individ i cili ishte i barabartë me të gjithë të tjerët. Shpërbërja e Jugosllavisë hapi një kapitull të ri në zgjidhjen e çështjeve etnike. Në Jugosllavi, sipas modelit rus, funksiononte ideja e kombit që ka të drejtë të udhëheqë me shoqërinë, prandaj bëheshin kategorizime të ndryshme, komb, kombësi, pakicë. Ky gradacion ishte shpeshherë në kontrast me realitetin. Kombësitë apo pakicat shpeshherë ishin më të mëdha sesa kombet. Bie fjala shqiptarët në ish-Jugosllavi, për kah numri, përqindja ishin në vendin e tretë, pas serbëve dhe kroatëve, por ata trajtoheshin si kombësi apo pakicë, ndërkaq malaziasit, maqedonasit, numerikisht shumë më të vegjël se shqiptarët trajtoheshin si kombe. Ky kategorizim natyrisht nuk buronte nga realiteti, por nga teoritë hegjemoniste, nacionaliste apo raciale. Kjo padrejtësi krijonte hapësirë për fërkime ndëretnike që përfundimisht ndikuan në shpërbërjen e Jugosllavisë. Këto fërkime janë imamente për shoqëritë heterogjene, multietnike. Ash-tu si u shpërbë Perandoria Osmane, Austro-Hungareze, apo Rusia cariste u shpërbë edhe Jugosllavia, Çekosllovakia. Sociologu zviceran, Urs Altermatt, në librin e tij "Etnonacionalizmi evropian" me të drejtë konstaton se nacionalizmi në Europë pat dy lloj funksionesh kontradiktore: - ndikoi në shpërbërjen e shteteve, perandorive, formacioneve multietnike shoqërore, siç ishte Austro-Hungaria dhe ndikoi në bashkimin e shteteve të vogla feudale në një shtet kombëtar të popujve me origjinë të njëjtë siç ishin gjermanët apo italianët. Sot, askush nuk mohan rolin pozitiv të nacionalizmit në krijimin e shteteve moderne. Populli shqiptar, pas shturjes së Perandorisë Osmane u fragmentarizua, u nda në disa shtete: në Shqipëri, në Greqi, në Jugosllavi dhe brenda saj në shumë republika. Aktualisht, pas pavarësimit të Kosovës, pas miratimit të Planit të Ahtisaarit, shqiptarët janë ndarë në disa shtete të pavarura: në Shqipëri, në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoni dhe në Luginën e Preshevës. Me këtë rast, me keqard-

hje mund të themi se në Greqi, pas një politike shkombëtarizuese anti-shqiptare është ngulatur kauza shqiptare. Fragmentarizimi i shqiptarëve, detyrimi që ata të jetojnë jashtë shtetit amë krijon një varg problemesh dhe statusesh të shqiptarëve brenda këtyre shteteve. Në Shqipëri bie fjala ata kanë liri dhe të drejta të palimituara nga aspekti kombëtar, në Kosovë shqiptarët kanë liri, por jo edhe mëvetësi në qeverisje, ngaqë sovraniteti do ta ndajnë një kohë të gjatë me faktorët mbikëqyrës, në Maqedoni edhe një kohë të gjatë do të zhvillohet procesi konfliktual i përcaktimit të statusit të shqiptarëve, ndërkaq në Luginën e Preshevës dhe në Mal të Zi shqiptarët definitivisht do ta kenë statusin e pakicës kombëtare. Këtë situatë vetë shqiptarët nuk mund ta ndryshojnë, prandaj paraqitet nevoja që të gjënjë rrugë të tjera për t'i tejkaluar pengesat që objektivistet e ngulatin zhvillimin ekonomik, kulturor, arsimor dhe sigurinë e tyre. Nëse merret parasysh roli vazhdimisht kompensues i nacionalizmit, pas humbjes së besimit në të "vërtetat" fetare, në hierarkinë shoqërore, të dhënë nga Zoti dhe në barasvlerësimin e kohës kozmike me atë historike, ashtu si pohon Andersoni, atëherë duhet shfrytëzuar forcën ngjeshëse, kohezive të nacionalizmit për ta ngritur mirëqenien e qytetarëve, pjesëtarëve të një kombi, prodhimin e vlerave kulturore dhe mbi të gjitha instalimin e standardeve kombëtare, gjithnjë në vijë të tejkalimit të pasojave rrënuese, zvetënuese të pasojave nga fragmentarizimi i indit kombëtar.

Kombet e formuara, ato që kanë krijuar shtetet e tyre kombëtare kanë aritur që të instalojnë si ide prijatë, intencën kombëtare apo eskatonin kombëtar që i fokuson të gjitha kapacitetet, burimet njerëzore dhe natyrore, në një drejtim, në atë të zhvillimit, të mbrothësisë kombëtare. Kjo intencë është përcaktim i çdo populli të qytetëruar, madje për aritje të interesave kombëtare janë zhvilluar dhe luftëra për zgjerim të territorit, gjithnjë në vijë të interesit ekonomik, të mirëqenies, së sigurisë së përbashkët kombëtare. Nocioni i interesit gjeostrategjik është eufemizëm që përdoret për ta zëvendësuar nocionin e profanizuar të nacionalizmit. Nëse nuk do të gjen-

det një rrugë e lejueshme, qytetëruese që do t'i bashkonte të gjitha kapacitetet e shqiptarëve në kuadër të një intence, eskatoni të përbashkët kombëtar, atëherë këto kapacitete do të shfrytëzoheshin nga të tjerët. Popujt e qytetëruar siç janë francezët apo britanikët në vijë të afirmimit të interesave kombëtare, madje kanë formuar organizma mbinacionale vullnetare siç është projekti i Frankofonisë apo Commonwealthit. Projekti i parë krijon relacione kohezive me popujt e ndryshëm mbi bazë të zgjerimit të përdorimit të gjuhës frënge, ndërkaq ky i dyti mbi baza të mirëqenies së përbashkët. Edhe shqiptarët të fragmentarizuar në disa shtete duhet ta përkufizojnë intencën, eskatonin kombëtar në vijë të shfrytëzimit racional të të gjitha kapaciteteve dhe burimeve. Nëse kjo nuk do të ndodhë atëherë do të kemi zhvillime shoqërore që do të shkërmoqin identitetin unik kombëtar dhe ndasi mbi interesa të kota. Duke marrë si shembull Commonwealth-in britanik, imponohet një ide e ngjashme, ajo, bie fjala e Mbrothësisë së Përbashkët Kombëtare. Qëllimi parësor i këtij projekti duhet të jetë shndërrimi i handicapit në përparësi, përkatësisht i fragmentarizimit molisës në begati, ose në vend që të shfrytëzohen kapacitetet e shqiptarëve nga të tjerë, të gjenden modalitete qytetëruese të organizimit shoqëror, gjithnjë në vijë të intencës kombëtare, që do të jenë në interes, jo vetëm të shqiptarëve, por edhe të popujve me të cilët ata bashkëjetojnë. Popujt më të qytetëruar të botës tashmë kanë përkufizuar dhe instaluar standardet kombëtare në çdo fushë, duke filluar prej çështjes së abortit e deri tek ajo e ushqimeve gjenetikisht të modifikuara, prej çështjes së demokracisë e deri te manifestimet sportive. Shoqëritë shqiptare janë të pastandardizuara, sidomos nga aspekti i vlerave kombëtare. Kjo mungesë ndikon që standardet dhe vlerat e popujve të tjerë të depërtojnë lehtas, madje edhe të bëhen barrierë për pranimin e standardeve moderne perëndimore. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në marrëveshje me faktorët relevantë botërorë, mbyllet një proces i dhembshëm historik dhe hapet një dilemë e nivelit tjetër: çka dhe si më tutje? Nga kjo periudhë shqiptarët dolën me imazh të rrënuar, me ekonomi jo

kompatibile me sistemet moderne shoqërore, me dilema qytetëruese, me identitet ende të pastabilizuar kombëtar, me dallime të rrezikshme kulturore, në varësi nga sistemet shoqërore ku janë formuar botëkuptimet e tyre, me sistemin e vjetruar arsimor, me koncepte dhe standarde labiale demokratike, me thellim të korrupsionit, nepotizmit, krimit të organizuar që nënkupton suspendimin e parimeve të shtetit ligjor, me shkapërderdhjen e bashkëkombësve në shumë shtete të botës si pasojë e krizës ekonomike, etj. Pa krijuar standarde unike kombëtare, pa bashkërenditje të kapaciteteve, të sinergjisë kombëtare nuk mund të tejkalohen vetvetiu këto probleme. Pa standardizim nuk mund të mbrohet asnjë vlerë, veçmas ato që kanë të bëjnë me identitetin kombëtar. Në vazhdim parashtrohet një skicë e mundshme për krijimin e një institucioni, organizate e Mbrothësisë së Përbashkët, punuar sipas projekteve të ngjashme në botë, veçmas Commonwealthit britanik.

Mbrothësia e Përbashkët

I Përkufizimi

Mbrothësia e Përbashkët është organizatë jopolitike vullnetare. Në këtë projekt do të përfshihen shtetet, përkatësisht bashkësitë shqiptare që jetojnë në shtete të ndryshme të botës.

II Qëllimet e theme-limit

"Mbrothësia e Përbashkët" është organizatë ndërkombëtare në të cilën do të marrin pjesë bashkësitë shqiptare, mundësisht edhe shtetet ku ata jetojnë pa marrë parasysh nivelin e zhvillimit shoqëror, politik dhe ekonomik. Baza mbi të cilën do të ndërliiden interesat e përbashkëta ka të bëjë me afirmimin e demokracisë, të drejtave të njeriut, qeverisjen e mirë, sundimin e ligjit, të drejtat individuale, barazinë, tregtinë e lirë, multilateralizmin dhe paqen në botë.

III Udhëheqja

Udhëheqja e Mbrothësisë duhet të jetë e emëruar (dominuar) me marrëveshje konsensuale ndërmjet anëtarëve të organizatës. Nominimi, pavarësia nga elektorati krijon kushte për marrje të vendimeve të guximshme dhe eliminon vetinë, shpeshherë bllokuese të vardisjes së politikanëve

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi



Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovajja loka.14 - përdhese, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtyp: "Sloboden pečat" - rr. 852 nr.62, Kompleks Gazela-Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 15 gusht | Numri i parë i gazetës do të më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Besim ILJAZI | Zëvendës kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor: Shkëlzen HALIMI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirrollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

ndaj elektoratit dhe opinionit në përgjithësi. Mbrothësia udhëhiqet nga sekretariati i përgjithshëm që ka ingerenca edhe ekzekutive. Sipas shembullit të Commonwealthit, ku udhëheqja simbolike i takon mbretëreshës, si kod bashkues, mund të ofrohet një rol i këtillë edhe oborrit mbretëror shqiptar.

IV Anëtarësimi

Kriteret për anëtarësim në Mbrothësi janë të bazuara në një sërë dokumentesh të veçanta.

V Objektivat dhe aktivitetet

“Mbrothësia...” karakterizohet si organizatë ndërkombëtare që synon t'i zgjidhë problemet me të cilat tash e tutje do të ballafaqohen bashkësitë shqiptare të shkapërdhura në shumë shtete.

Objektivat kryesorë janë: Çështjet e identitetit; Unifikimi i standardeve kombëtare: demokracia, ekonomia, arsimit, barazia gjinore,

Shekularizmi, të drejtat njerëzore, gjyqësori, sporti, ndërvëprimi, rinia.

VI Struktura udhëheqëse

Sekretariati i “Mbrothësisë” vendoset në Tiranë, ndërkaj degët në kryeqendrat ku jetojnë shqiptarët. Sekretariati organizon konferenca, takime të ministrave, takime konsultative teknike, e ndihmon zhvillimin e politikave dhe jep këshilla politike, profesionale, harton projekte për tejkalim të vështirësive në përputhje me objektivat e paracaktuara. Sekretariati udhëhiqet nga sekretari i përgjithshëm i “Mbrothësisë”. Ai mund të ketë vetëm dy mandate me nga 4 v.

Sekretari i Përgjithshëm dhe dy zëvendësit e tij i udhëheqin seksionet e sekretariatit. Subjektet anëtare të “Mbrothësisë” krijojnë edhe shumë lidhje sekondare në lëmin e sportit, të arsimit, të bamirësisë etj. Asociacioni i universiteteve të “Mbrothësisë” shërben si mjet për lidhjet (komunikim) akademik(e). Po ashtu, ekzistojnë edhe shoqata të tjera jozyrtare, të cilat ndihmojnë individë që punojnë në fushën e gjyqësorit dhe në institucionet e tjera qeveritare, siç janë, shoqata e juristëve dhe shoqata e parlamentaristëve të “Mbrothësisë”. Në të parë ideja duket sa e guximshme po aq edhe e porealizueshme, por rrugëdalje tjetër nuk ka nëse dëshirojmë t'i vëmë në kontroll proceset që i degjenerojnë kapacitetet ona kombëtare dhe shoqërore në përgjithësi. Nëse ky propozim të paktën do të nxisë përsiatjen për nevojën e gjetjes së një shtegu të ri që do të na shpijë në nivel më të lartë të organizmit shoqëror, atëherë guximi do të jetë i arsyeshëm.



Henry KISSINGER

Për më shumë se 30 vjet, përgjigja e botës ndaj programit bërthamor të Koresë së Veriut, ka kombinuar dënimin me zvarritjen. Sjellja kokëkrisur e Phenianit është qortuar. Janë lëshuar paralajmërime se evolucion i tij drejt armatimit, do të jetë i paprueshëm. Megjithatë, programi i tij bërthamor vetëm sa është përsheptuar. Rezoluta e sanksioneve e 5 gushtit, miratuar njëzëri nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara shënoi një hap të madh përpara. Megjithatë, një objektivi i miratuar nga të gjithë mbetet të vendoset. Por sukcesi i Koresë së Veriut në testimin e një prototipi rakete balistike interkontinentale, eliminon hapësirën për ekuivok të mëtejshëm. Nëse Kim Jong Un e vazhdon programin bërthamor, edhe përkundër kundërshtimit të Kinës dhe SHBA, si dhe një rezolute unanime të Këshillit të Sigurimit, ai do të ndryshojë marrëdhënien gjeostrategjike midis aktorëve kryesorë. Nëse Pheniani zhvillon një kapacitet të plotë bërthamor, ndërkohë që bota dridhet, ai do të zvogëlojë seriozisht kredibilitetin e ombrellës bërthamore amerikane në Azi, veçanërisht për aleatët tanë në Tokio dhe Seul.

Sfida afatgjatë shkon përtej kërcënimit ndaj territorit amerikan, deri në perspektivën e kaosit bërthamor. Një arsenal operacional raketash interkontinentale i Koresë së Veriut është ende larg në kohë, po të kemi parasysh nevojën për të miniaturizuar kokat me mbushje, montimin e tyre tek raketat dhe prodhimin e tyre në numra të mëdhenj. Por vendet e Azisë janë tashmë të kërcënuara nga raketat ekzistuese të Koresë së Veriut, me rreze të të shkurtër dhe të mesme. Ndërsa këto kërcënime akumulohen, nxitja për vende si Vietnam, Koreja e Jugut dhe Japonia për t'u mbrojtur me armët e tyre bërthamore do të rritet në mënyrë dramatike – një kthesë ogurzeze për rajonin dhe botën. Zhbërja e progresit që Pheniani ka bërë tashmë, është po aq e rëndësishme sa parandalimi i avancimit të mëtejshëm të tij.

Diplomacia amerikane, ashtu si edhe ajo multilaterale në Korenë e Veriut ka qenë e pasuksesshme, për shkak të pamundësisë për të bashkuar objektivat kryesore të aktorëve kyç – veçanërisht ato të Kinës dhe SHBA – në një konsensus operacional. Kërkesat amerikane për t'i

Si të zgjidhet kriza e Koresë së Veriut

Pheniani nuk duhet të lihet me përshtypjen se mund të shkëmbejë kohë me procedura dhe të fshehtë qëllimin mes taktikave, si një mënyrë për të ngecur, e si pasojë, përmëshur aspiratat e veta të kahershme. Një proces negociatash mund t'ia vlejë të konsiderohet, por vetëm nëse redukton në mënyrë thelbësore kapacitetet bërthamore të Koresë së Veriut si dhe programin e saj kërkimor, në një të ardhme të afërt

dhënë fund programit bërthamor të Koresë së Veriut kanë rezultuar të pavlefshme. Udhëheqësit e SHBA, duke përfshirë edhe ushtrinë, kanë ngurruar të përdorin forcën; Sekretari i Mbrojtjes Jim Mattis e ka përshkruar perspektivën e një lufte me Korenë si “katastrofike”. Mijëra tuba të artillerisë të vendosura brenda zonës së kryeqytetit të Koresë së Jugut, tregojnë strategjinë e Phenianit për të mbajtur peng popullsinë 30-milionëshe të Seulit.

Vëprimi ushtarak parandalues i njëanshëm nga SHBA, do të përfshinte një rrezik konflikti me Kinën. Pekini, edhe pse përkohësisht pranoi, nuk do t'i qëndronte gjatë një strategjie amerikane për të përcaktuar vetë atë që do të ndodhë, në skajin e tokës kineze, siç e tregoi ndërhyrja amerikane Luftën Koreane të viteve 1950. Përdorimi i forcës ushtarake duhet të analizohet me kujdes, dhe fjalori duhet të përmbahet. Por ajo nuk mund të përjashtohet.

Konsiderata si këto kanë sjellë përpjekjet e administratës për të futur edhe Kinën, në një përpjekje diplomatike për të shtyrë Korenë drejt denuklearizimit. Këto përpjekje deri më tani kanë pasur vetëm sukses të pjesshëm. Kina ndan shqetësimin amerikan lidhur me përhapjen bërthamore. Në fakt është vendi më i prekur menjëherë prej saj. Por, ndërsa Amerika ka qenë e qartë për qëllimin, ajo ka qenë më pak e gatshme të përballet me pasurjat politike. Duke pasur parasysh shpërndarjen e madhe dhe joproportionale të burimeve kombëtare të Koresë së Veriut në programin e saj të armëve bërthamore, braktisja ose zvogëlimi thelbësor i saj do të prodhonte një

përmbyse politike, ndoshta edhe ndryshim të regjimit.

Kina me siguri e kupton këtë. Prandaj, një ngjarjet më të spikatura të diplomacisë aktuale është mbështetja e Pekinit në parim, për denuklearizimin e Koresë së Veriut. Në të njëjtën kohë, perspektiva e shpërbërjes ose kaosit në Korenë e Veriut ngjall të paktën dy shqetësime të mëdha në Kinë. I pari ka të bëjë me efektet politike dhe sociale të një krize të brendshme të Koresë së Veriut brenda vetë Kinës, duke risjellë në skenë ngjarje të njohura nga mijëvjeçarë të tërë të historisë kineze. I dyti përfshin sigurinë në Azinë Verilindore. Nxitja e Kinës për të ndihmuar zbatimin e denuklearizimit, do të jetë që të imponojë kufizime të krahasueshme në të gjithë Korenë. Sigurisht, Koreja e Jugut nuk ka ndonjë program bërthamor të dukshëm ose plane të shpallura për të, por një përplasje ndërkombëtare është çështje tjetër.

Kina do të ketë gjithashtu një rol në evolucionin politik të Koresë së Veriut pas denuklearizimit, qoftë një zgjidhje me dy shtete apo një ribashkim, si dhe në kufizimet për vendosjen e trupave ushtarake në Korenë e Veriut. Deri më tani, administrata i ka kërkuar Kinës që të bëjë presion mbi Korenë e Veriut, si një lloj nënkontraktori, për të arritur objektivat amerikane. Qasja më e mirë – ndoshta e vetjam e mundshme – është të bashkojë të dy përpjekjet dhe të zhvillojë një qëndrim të përbashkët, të ndjekur bashkërisht me vendet e tjera të përfshira.

Deklaratat që e përcaktojnë objektivin e SHBA, si atë të afrimit të Koresë së Veriut në tryezën e negociatave reflektojnë supozimin se negociatat janë objektivi i tyre, duke vepruar pra sipas vrullit të tyre, të ndara nga presionet që i bënë të mundura ato dhe që nevojiten për t'i vazhduar. Por diplomacia amerikane, në fund do të gjykohet nga rezultati dhe jo nga procesi. Garancitë e përsëritura se SHBA nuk kërkon avantazh të njëanshëm nuk janë të mjaftueshme për vendet që mendojnë se struktura e sigurisë aziatike është në rrezik.

Atëherë cilat palë duhet të negociojnë, dhe për çfarë? Një kuptim mes Uashingtonit dhe Pekinit është parakusht thelbësor për denuklearizimin e Ko-

resë. Për shkak të një evolucioni ironik, në këtë fazë Kina mund të ketë një interes më të madh se sa SHBA, në pengimin e nuklearizimit të Azisë. Pekini ka riskun e përkeqësimit të marrëdhënive me Amerikën, nëse fajësohet se nuk ka ushtruar presion të mjaftueshëm ndaj Phenianit. Duke qenë se denuklearizimi kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm, ai nuk mund të arrihet me presion ekonomik. Ai kërkon një mirëkuptim themelor Kinë-SHBA për atë që do të ndodhë më pas, sidomos për evolucionin politik të Koresë së Veriut dhe kufizimet për dërgime trupash në territorin e saj. Një mirëkuptim i tillë nuk duhet të ndryshojë marrëdhëniet aktuale të aleancave.

Sado paradoksale mund të duket në dritën e një historie gjysmëshekullore, një mirëkuptim i tillë është ndoshta mënyra më e mirë për të dalë nga qorrrokaku korean. Një deklaratë e përbashkët e objektivave dhe veprimeve dhe veprimeve që do të kryhen, do të sjellë izolimin e Phenianit dhe ofrojë një bazë për garancinë ndërkombëtare, që është thelbësore për të ruajtur rezultatin.

Seuli dhe Tokio duhet të luajnë një rol kyç në këtë proces. Asnjë vend nuk është më i përfshirë në mënyrë organike, sesa Koreja e Jugut. Duhet të ketë, prej gjeografisë dhe marrëdhënies së aleancave, një zë vendimtar në rezultatin politik. Do të ishte më drejtpërdrejtë e prekurr nga një zgjidhje diplomatike dhe më e jekur bashkërisht me vendet e tjera të përfshira.

Ngjashëm, historia e Japonisë ka qenë e lidhur me Korenë për mijëvjeçarë të tërë. Koncepti i sigurisë së Tokios nuk do të tolerojë për një kohë të pacaktuar, një Kore bërthamore, pa ngritur një aftësi bërthamore të vetën. Vlerësimi prej Japonisë i aleancës me amerikanët, do të ndikohet më së shumti nga shkalla në të cilën administrata e SHBA merr në konsideratë shqetësimet japoneze për krizën.

Rruga alternative e një negociimi të drejtpërdrejtë me Shtetet e Bashkuara

me Phenianin, i tundon disa. Por kjo do të na linte një partner, që mund të ketë vetëm një interes minimal për zbatimin dhe një interes maksimal për të vënë Kinën dhe SHBA kundër njëra-tjetrës. Një mirëkuptim me Kinën është i nevojshëm për presion maksimal dhe garanci të realizueshme. Në vend të kësaj, Pheniani mund të përfaqësohet më së miri, në një konferencë ndërkombëtare kulmore.

Ka pasur sugjerime se një ngrirje e testimeve, mund të sigurojë një zgjidhje të përkohshme që çon me kalimin e kohës drejt një denuklearizimi. Kjo do të përsëriste gabimin e marrëveshjes iraniane: kërkimin e zgjidhjes së një problemi gjeostrategjik, duke u kufizuar vetëm në anën teknike. Do të ofronte pretekste të pafundme për zvarritje, ndërsa do të përcaktohej ç'do me thënë “ngrirje” dhe zhvilloheshin mekanizmat e inspektimit.

Pheniani nuk duhet të lihet me përshtypjen se mund të shkëmbejë kohë me procedura dhe të fshehtë qëllimin mes taktikave, si një mënyrë për të ngecur, e si pasojë, përmëshur aspiratat e veta të kahershme. Një proces negociatash mund t'ia vlejë të konsiderohet, por vetëm nëse redukton në mënyrë thelbësore kapacitetet bërthamore të Koresë së Veriut si dhe programin e saj kërkimor, në një të ardhme të afërt.

Një Kore e Veriut që ruan një kapacitet të përkohshëm armësh, do të institucionalizonte rrezikë të përhershme:

* që Pheniani i varfër të shesë teknologji bërthamore;

* që përpjekjet amerikane mund të perceptohen si të përqëndruara në mbrojtjen e territorit të vet, ndërkohë që të pjesën tjetër të Azisë të ekspozuar ndaj shantazhit bërthamor;

* që vende të tjera mund të ndjekin programe bërthamore kundër Phenianit, njëri-tjetrit apo me kalimin e kohës, SHBA;

* që irritimi me rezultatin të marrë formën e konfliktit me Kinën;

* që përhapja bërthamore të përsheptohet në rajone të tjera;

* që debati i brendshëm në SHBA të bëhet më përçarës.

Progresi thelbësor drejt denuklearizimit – dhe aritja e tij në një periudhë të shkurtër – është kursi më i matur.

(The Wall Street Journal)



Hani pesë herë në ditë që të dobësoheni

Kur flasim për dietat shpesh kemi dëgjuar të na thonë që të hamë me shpesh dhe më pak. E dieta e nutricionistes Angela Dowden, fokusohet në konsumimin e ushqimit pesë herë në ditë. Gjithashtu në qendër të saj janë pesë racione fruta dhe perime në ditë. Nga kjo dietë pritet të humbim në dy kilogramë në 2 javë. Dieta përqendrohet në konsumimin e ushqimit në intervale të rregullta pesë herë gjatë gjithë ditës. Gjithashtu, ushqimi që hani duhet të përbëhet nga 80 g fruta dhe perime në ditë, veçanërisht zarravate që janë të larta në fibra dhe të ulëta me karbohidrate. Kjo dietë mund të përfshijë një pjesë të vogël boronica, 1 kivi dhe kos pa yndyrë për mëngjes. Zieni pa lëvizje një fileto salmoni me sallatë perimesh për drekë dhe një rizo-to me perime për darkë. Pas mëngjesit konsumoni banane dhe 1 ose 2 orë pas drekës një pjesë të vogël të arra dhe rrush të thatë. Kjo dietë funksionon edhe nëse konsumoni një dietë të kufizuar për tre ditë të javës, para se të ndiqni një dietë të rregullt për katër ditët e tjera. Një ditë e zakonshme në planin tre-ditore përfshin një vezë, një fetë e proshutë dhe një gjysmë banane për mëngjes, e ndjekur nga një filxhan gjizë, një vezë të zier fort dhe ëmbëlsirë me oriz për drekë, proshutë 200g, një filxhan brokoli, 1/2 e një filxhani karota, 1/2 e një banane dhe 1/2 e një filxhan akullore me vanilje për darkë. Kjo arrin dietë arin rreth 1000 kalori dhe nuk është e dëmshme për shëndetin tuaj.



12 fakte interesante që nuk i dini për picën

Pica e ka prejardhjen prej qytetit Napoli. Për të flet edhe Alexandre Dumas (babai) në librin e tij të kuzhinës (1835). Në vitin 1889, Raffaele Esposito dhe bashkëshortja e tij Rosa Brandi, pronarë të një picerie, për t'i bërë homazh Mbretëreshës Margherita, gruas së Mbretit Umberto I, përgatitën një picë trengjyreshë me domate, borzilok dhe djathë mozzarella. Në këtë mënyrë lindi zyrtarisht pica Margherita.

- Pica dhe amerikanët. Gabon kushdo që beson se amerikanët e zbuluan picën shumë vite pas italianëve. Madje disa prej tyre e kanë 2njohur edhe më përpara. Ndërkohë që piceria e parë në Nju Jork i hapi dyert e saj në vitin 1905, nga nja ide e emigrantit Gennaro Lombardi. Kishin kaluar vetëm 15 vite nga krijimi i Margherita-s. Suksesit që i menjëhershëm. Sot pica më popullore në SHBA është pica Pepperoni (me sallam pikant).

- Pica dhe Google. Në mes të viteve '90, përpara se të krijonte Google, Sergey Brin ngriti në këmbë një shërbim që të lejonte të porosisje pica me internet duke shfrytëzuar fax-in e restoranteve. Ishte një dështim i madh, sepse siç ka



treguar ai vetë, kjo i mësoi se njerëzit jo gjithnjë i respektojnë vendimet e marra. E nëse do të kishte sukses, sot ndoshta nuk do të kishim Google.

- Pica më e shtrenjtë. Të porosisësh një picë dhe ta paguash me bitcoin? (monedhë virtuale, me anë të së cilës mund të kryesh transaksione, si me paranë e vërtetë). Bitcoin është një formë e re paraje, një monedhë digjitale e decentralizuar, që nuk kontrollohet nga askush, nuk e nxjerr asnjë bankë qendrore dhe mund të përdoret nga të gjithë. E ka bërë në vitin 1009 programuesi Laszlo Hanyecz, që pagoi për dy pica 10 mijë bitcoin. Që sot vjen më shumë se tre milion euro.

- Pica e ngrirë. Deri pak vite më parë piceria "Airport Pizza: në qytetin Nome, në Alaska, dërgonte pica me avionë në fshatrat përreth, të cilët nuk kishin piceri. Për udhëtimin nevojiteshin të porosiseshin të paktën 30 pica (10 dollarë njëra).

- Pica e parë nëpërmjet ueb-it. Në vitin 1994 një piceri e zinxhirit 6të picerive "Pizza Hut" në Santa Kruz në Kaliforni hapi një sit ueb ku ishte e mundur të porosisje picën online, duke krijuar në fakt shembullin e e-commerce në botë.

- Printeri 3D për të bërë picën. NASA i dha kompanisë "Anjan Contractor" të Austin, Teksas, 125.000 dollarë për të zhvilluar prototipin e një prin-

teri 3D që të jetë në gradë të bëjë një picë duke përzierë disa ushqime në pluhur dhe ujë. Nëse do të funksionojë, do të merret nga astronautët në rrugëtimet gjata hapësinore.

- Më të shpejtët. Në qershor të 2014-ës në Las Vegas u mbajt gara e picajollëve më të shpejtë: fitoi anglezi Pali Grewal, që u tregua i aftë të gatuar dhe të piqu 3 pica në vetëm 32 sekonda e 28 të qindtat.

- Çfarë është efekti pica. Në sociologji flitet për një efekt pice kur një fenomen lokal ka sukses përpara jashtë vendit të origjinës, dhe kthehet protagonist në një moment të dytë. I pari që foli për këtë term ishte antropologu Aghananda Bharati kur në vitin 1970 kur gjatë studimi tha se popullariteti i jogës dhe i disiplinave orientale u bënë të famshme fillimisht në perëndim për t'u bërë të njohura më pas edhe në atdhe. Sipas tij, edhe pica pati të njëjtin fat, u bë e famshme fillimisht në SHBA, për t'u bërë më pas në Itali.

- Pica më e preferuar e kosovarëve "pica e shpisë".

- Në Shqipëri, kamerieri Gentian B. është therrë me thikë për vdekje vetëm pse ia kishte vonuar picën klientit.

Filizi i grurit, çfarë është dhe çfarë vlera ka?

Kemi mësuar tashmë gjithçka për bukën e brumërat, pasi për to është folur pa masë, por filizit të grurit pak ia njohin vlerën. Çfarë është ai? Flitet për kokrrën e grurit të mbuluar me ujë për një ose dy ditë derisa nga filizi të çelin gjethezat. Nga kokrrat e mbira gjenerohet embrioni i grurit, i pasur me shumë vitamina, shumë minerale, shumë proteina, elementë më të dobishëm se sa mund të gjenden tek ushqimet e tjera, përfshirë mishin apo peshkun. Është i njohur fakti që gjimnastët e përdorin shpesh me qëllim zhvillimin e muskujve të tyre në mënyrë natyrale. Por e veçanta e filizit të grurit është se ai përmban oligoelementë tepër të rrallë, si magnez, aq i rëndësishëm për një ushqim të shëndetshëm dhe natyral.

SI PËRGATITET DHE SI PËRDORET: Në një tas të gjerë e të cekët hidhni pak ujë të vakët, shtoni një grusht kokrra gruri dhe mbulojeni me një kapak. Pas 36 orësh gruri ka çelur. Përdoreni në sallata ose thajeni për t'ia hedhur qumështit si muesli.



Ja përfitimet që na ofron konsumimi i djathit

- Djathi ju ndihmon të qëndroni në formë. Kjo ndodh falë substancave të quajtura "butyrate", që gjenden në shumë lloje djathërash. Studiuesit këshillojnë konsumin e djathit pasi ai ndihmon në forcimin e metabolizmit. Djathërat që kanë sasi shumë të larta të kësaj substance nxisin stomakun të prodhojë sasi të tjera të substancës, pra kemi përfitim të dyfishtë prej djathit në këtë rast.

- Djathi mund të ndalojë në parandalimin e shfaqjes së kancerit. Nga një studim ka dalë se pikërisht sasia e butyrate-t që gjendet në djathë mund të mbrojë zorrën e trashë nga shfaqja e kancerit, dhe gjithashtu



redukon inflamacionin që dëmton zorrën e trashë me kalimin e kohës.

- Djathi ndihmon në formimin e masës musku-

lore. Djathi, shumë i pasur në proteina, është një zgjedhje e shkëlqyer për të formuar muskuj. Kjo pasi proteinat janë të përbëra

prej aminoacideve, që janë elementët që ndërtojnë indet e muskujve.

- Djathi është i shëndetshëm për kockat. Duke

qenë se djathi bëhet nga qumështi, ai është shumë i pasur me kalcium, gjë që bën që ai të jetë shumë i shëndetshëm për kockat tuaja. Dietologët thonë se konsumi i vetëm 28 gramë djathë përmixhan ju jep 336 miligramë kalcium, dhe kjo është një sasi e mjaftueshme e sasisë së nevojshme ditore që trupi ka për kalcium. Të meshkujt e rritur sasia e nevojshme e kalciumit është 1000 miligramë në ditë.

- Djathi është i shëndetshëm për dhëmbët. Kjo është falë përmbajtjes së kalciumit dhe fosforit. Këto dy minerale luftojnë acidin laktik që gjendet në gojën tonë, dhe e pengojnë atë që të dëmtojë smaltin, i cili shërben që ne të mos

ndiejmë dhimbje gjatë ngrënies dhe pengon prishjen e dhëmbëve.

- Djathi mund të parandalojë shfaqjen e diabetit. Ekspertët besojnë se kjo ndodh për arsye se substanca "butyrate" ndihmon që trupi të përdorë insulinën në mënyrë sa më efektive, kjo për sa i përket kontrollit të nivelit të sheqerit në gjak. Edhe personat që janë alergjikë ndaj nënprodukteve të qumështit mund të konsumojnë disa lloje djathërash. Kjo është e mundur pasi në prodhimin e disa llojeve të djathit, si përmixhimi dhe mocarella, e gjithë laktoza e qumështit hiqet plotësisht, dhe djathi mund të konsumohet pa problem nga të gjithë personat.

Kështu u shpik telefoni më i përdorur i momentit - iPhone



Iphone, për pak mund të mos kishte ekzistuar fare. Krijimi i versionit origjinal të tij ka qenë një sipërmarrje e rrethuar nga një fshehtësi, që mbërrinte deri në paranojë. Kur smartphone i "Apple" doli në shitje 29 qershorin e vitit 2007, bota dominohej nga "Blackberry"-t me tastierë të vogël, "iPod"-ët për muzikë, "Palm Pilot"-ët për kalendare e aparatet fotografike digjitale. Ti bëje bashkë të gjitha këto gjëra në një gjë, e cila do të rrinte mirë në xhepin tënd, asokohe dukej çmenduri. Të

mungonte pastaj edhe tastiera ishte fare e paimagjinueshme. Vetëm tani, 10 vite më vonë, kanë dalë në dritë detajet e nismës, e cila çoi në krijimin e smartphone-it, që do të ndryshonte botën. CNN thotë se iPhone ekziston sot vetëm sepse Steve Jobs nuk duronte dot një të punësuar të "Microsoft"-it. Ky i fundit ishte martuar me mikeshën e bashkëshortes së Jobs, dhe të dy ndesheshin shpesh me njëri-tjetrin nëpër shfaqje sociale. Ai gjithmonë i mburrej Jobsit sesi "Microsoft" do të sun-

donte botën me tabletët e vet të reja, e Steve nuk duroi dot më. Një ditë shkoi në zyre e u tha kolegëve: le t'ua tregojmë si bëhet vërtet kjo punë! Ai ngriti një grup që do të merrej vetëm me një tablet, ku të mund të aplikohet teknologjia "touchscreen", e kur u arrit një gjë e tillë u kalua te telefoni. Ishin kohë të vështira, - tregon punonjësi i Apple, Andy Grignon, - sepse Steve arrinte e bëhej shumë nervoz dhe iu ulërinte të gjithëve, por në fund ia dolëm. Ai dinte si të nxirrte më të mirën prej nesh.

Ja si ndikon në gjumë ndarja e shtratit me dikë

Sipas një studimi, cilësia e gjumit është më e mirë, kur ndahet shtrati me dikë. Kjo anipse, nata e parë me partnerin e ri mund të mos jetë e lehtë. Sidoqoftë pas një kohe trupi do të fillojë ngadalë të mësohet me trupin e tjetrit. Në studimin e bërë me çifte, ata kanë thënë se kanë pasur gjumë më të mirë,

kur kanë fjetur me dikë, sesa vetëm. Ndarja e shtratit me dikë redukon citokinën, e përfshirë në inflamacione dhe rrit oksitocinën - hormonin e ashtuquajtur, hormoni i dashurisë që njihet për lehtësimin e ankthit dhe që prodhohet në pjesën e njëjtë të trurit që është përgjegjëse për ciklin e fjetjes-zgjuarjes.



Në cilën moshë zbulohet talenti i fëmijës?

Të gjithë prindërit duan që fëmijet e tyre të jenë të talentuar, por jo të gjithë dinë si t'i zbulojnë aftësitë e tyre.

Nëse fëmija është talent i lindur, ai do ta shfaqë këtë që në moshë të herët.

- Kur fillon fëmija të shfaqë talentet e tij? Nga moshën 2 deri në moshën 7 vjeç fëmija shfaq interesim të veçantë për një fushë të caktuar dhe kjo është koha e duhur që talentin ta kanalizoni në mënyrë të duhur.

- Si mund t'i ndihmoni vogëlushët e talentuar? Prindërit luajnë një rol të rëndësishëm në edukimin e fëmijëve, sidomos nëse fëmija ka një prirje të veçantë. Fëmijët kanë nevojë për përkrahje dhe



mirëkuptim, andaj asnjëherë mos lejoni që ambiciet tuaja të jenë para interesave të fëmijës. Më e rëndësishme është që fëmija në çdo moment të ndjejë përkrahjen tuaj.

KËSHILLA PËR

PRINDËRIT E FËMIJËVE TË TALENTUAR

- Kurset dhe mësimet private janë gjithmonë një ide e mirë.

- Duhet të keni pritshmëri realiste dhe të mos i vendosni në presion.

- Inkurajojini dhe mos përçmoni aftësitë e tyre. Për çdo përparim të vogël, bëjini të ditur që jeni krenar për të apo shpërblejini dhe i thuajini që të gjithë njerëzit ndonjëherë gabojnë.

Kjo është lulja që mund të shpëtojë jetën njeriut

Lulja e fuqishme e quajtur **Buganvilia**, në vende të tjera është gjithashtu e njohur, si **Santa Rita**, **Veranera**, **Ne** e përdorim për të dekoruar shtëpitë tona, por ajo që nuk dimë është se mund të na shpëtojë jetët



Buganvilia është një lule e bukur e cila rritet në çdo tokë kur përshtatet me të gjitha llojet e klimës. Ajo mund të arrijë deri në 12 metra lartësi. Në Meksikën Qendrore, përfitimet e kësaj luleje janë shfrytëzuar me kohë, çka do të thotë që ajo ka efekte pozitive në organizëm. Ja disa prej tyre:

- Zvogëlon kollën e thatë. Ndhmon në heqjen e

muzokës nga sistemi i frymëmarrjes (në faring, laring etj)

- Ul ethet. Përmirëson sistemin e frymëmarrjes. Ai kontribuon në funksionimin e duhur të mushkërive dhe aftësinë e tyre për të oksigjenuar trupin.

- Ndhmon në bal-

ancimin e sistemit të tretjes. Në rastin e rrënjëve, këto kanë një efekt laksativ, ndërsa gjethet shkaktojnë kapsllëk. Në varësi të gjendjes, ne mund të zgjedhim një opSION ose tjetrin.

- Promovon kujdesin e lëkurës. Bugambilia njihet për vetitë e saj antiseptike,

sidomos në lëkurë, kështu që ndihmon në luftimin e akneve, infeksioneve dhe zhdukjes. Nëse keni puçrra fytyre ose keni një lëkurë të nxehtë që zakonisht ka baktere, me efektin antiseptik të bougainvillea, ju mund ta mbani atë të pastër dhe larg nga bakteret.

- Shërben si detoksifikues, sidomos për mëlçinë.

SI TA PËRDORIM? Marrim disa gjethë nga kjo lule dhe i lajmë me ujë të bollshëm për ti hequr papastërtitë. Më pas i ziejmë në një tenxhere dhe i heqim atëherë kur të kenë ndryshuar ngjyrën e ujit. Sipas dëshirës mund të hedhim edhe një lugë mjaltë. Ky lëng këshillohet të pihet i nxehtë ose të aplikohet në zonën ku doni të përmirësoni gjendjen!



Koha apo paraja? Do të jeni më të lumtur nëse zgjidhni kohën

Është një debat klasik: Koha apo paraja? Paraja apo koha? Ndonëse të dyja nuk janë të ndërkëmbyeshme, mund të duket sikur nuk mund të kesh njërin, nëse ke tjetrin. Atëherë, kë duhet të zgjidhni? Sipas studimeve, nëse do të jesh i lumtur, duhet të zgjedhësh kohën, përpara parësë. (Po a nuk do të ishte më e kollajtë nëse do t'i kishim të dyja?) Në një studim të botuar në "Social Psychological and Personality Science" në maj të këtij viti, shumica e pjesëmarrësve ishin në favor të të paturit të më shumë parave, në vend të kohës. Megjithatë, zgjedhja e më shumë kohe lidhej gjithmonë me nivele më të larta të lumturisë dhe kënaqësisë nga jeta. Por, ju mund të mendoni, po sikur ata që zgjedhin kohën para parësë, të kenë tashmë shumë parë? Studimi kontrolloi edhe nivelet ekzistuese të parave dhe kohës. Ndërkohë që vlera e parësë është e lehtë të kuantifikohet, vlera e kohës është pak më e vështirë. Atëherë kë do të zgjidhni ju?





FAZ analizon, se Daçiç e shikon të vetmen zgjidhje realiste për Kosovën në atë "që territoret ku jetojnë serbë, të bashkohen me Serbinë, dhe pjesët e tjera ku jetojnë shqiptarët të pavarësohen"

Idetë e Daçiçit

Shqipëria e Madhe zonë influence e perëndimit



"Pika që gërryen Fushë-Kosovën" - Gazeta gjermane "Frankfurter Allgemeine Zeitung" i kushton vëmendje ideve të hedhura nga ministri i Jashtëm serb, Ivica Daçiç në median serbe

Në artikullin e së përditshmes "Frankfurter Allgemeine Zeitung" mbi debatin aktual në Serbi për më shumë realizëm ndaj çështjes së Kosovës, nënvizohet, se pas presidentit Vuçiç është ministri i Jashtëm serb, Ivica Daçiç, ai që hedh ide për Kosovën. "Serbia gjithmonë ka humbur përmes një politike jorealiste

dhe utopike 'gjihtëka ka aritur me gjak', shkruan Daçiç në një tekst me pasazhe luftarake, të botuar të hënën në gazetën "Novosti". Sipas Daçiç qëllimi i shqiptarëve është krijimi i Shqipërisë së Madhe. "Kjo Shqipëri e madhe kërcënon të jetë shteti më vital i Ballkanit dhe një instrument i ndikimit perëndimor në rajon". Daçiç vazh-

don me paralajmërimet, se shqiptarët kanë në plan të bashkojnë veriun e Kosovës me Sanxhakun për të 'rigjallëuar territorin historik-osman'. "Një lidhje e 'Kosovës së islamizuar' me Sanxhakun, sipas Daçiç do të ishte një dështim më i madh për popullin serb, më i madh se të gjitha dështimet e popullit serb në shekullin e 20-

të". Propozimi i Daçiçit për zgjidhjen e problemeve të Serbisë nuk është edhe aq i ri - ndarja e Kosovës e bashkimi de jure i veriut të Kosovës me Serbinë. "Përveç kësaj manastiret serbe dhe kishat e Fushë-Kosovës duhet të marrin statusin autonom. FAZ analizon, se Daçiç e shikon të vetmen zgjidhje realiste për Kosovën në atë "që territoret ku jetojnë serbë, të bashkohen me Serbinë, dhe pjesët e tjera ku jetojnë shqiptarët të pavarësohen". Me sa duket Beogradi ndjek planin, se pika që pikon pandërprerë do të jetë ajo që do ta gërryete Fushë-Kosovën", shkruan FAZ.

Prodhuesit kosovarë reagojnë: Shqipëria po e dëmton shtetësinë e Kosovës

Klubi i Prodhuesve të Kosovës (KPK) shprehë shqetësimin për trajtimin e prodhimeve 'Made in Kosova' në tregun e Shqipërisë. Sektori i prodhimit në Kosovë është gjenerator kryesor i zhvillimit ekonomik dhe punësimit, si i tillë është sektori më strategjik që do ta fuqizon shtetësinë e Kosovës. Andaj, mosrespektimi i marrëveshjeve ndërshtetërore si dhe bllokimi i produkteve 'Made in Kosova' në tregjet e Shqipërisë është dëmton i shtetësisë së Kosovës. Klubi i Prodhuesve të Kosovës është organizatë që në vazhdimësi punon në avancimin dhe rritjen e shkëmbimit tregtarë në mes dy vendeve. Qëllimi kryesor i KPK-së është të promovon prodhimet 'Made in Kosova'. "Duke marrë parasysh që KPK-ja punon në mbrojtjen e interesit të prodhuesve të Kosovës, ne publikisht kërkojmë që të ndalet bllokimi i prodhimeve të Kosovës në tregun shqiptarë. Është e pakuptimtë që disa vite me radhë gjatë sezonit të bllokohet patatja përmes tarifave të padrejta, është e pakuptimtë që në pikun e sezonit turistik të akuzohet birra e Kosovës për evazion fiskal. Këto veprime janë thjesht mjet presioni për të zvogëluar eksportin e Kosovës në Shqipëri", theksohet në komunikatën e KPK-së. "Ne besojmë që institucionet e Shqipërisë kanë shënuar progres dhe deri në një masë janë duke i zbatuar ligjet dhe rregullat në fuqi, mirëpo ka ende raste ku prodhuesit kosovarë po dëmtohen për shkak të neglizhencës apo bllokimit nga grupet e ndryshme të interesit. Ne fuqimisht besojmë në funksionimin e tregut të lirë, ku mbi të gjitha konsumatori vendos në bazë të kualitetit dhe çmimit. Nuk mund të dëmtohet konkurrenca duke shkelur mbi rregullat e tregut të lirë, me shpifje dhe fabrikim të fakteve". Klubi i Prodhuesve të Kosovës apelon tek institucionet e Shqipërisë që të trajtojnë prodhimet e Kosovës konform rregullave dhe të aplikohen procedurat preferenciale duke marrë parasysh interesin strategjik dhe kombëtar që ka shkëmbimi tregtarë në mes të dy vendeve.

Shqipëria në udhëkryq

Në fjalën përshëndetëse në hapjen e aktivitetit të të rinjve të LSI-së në Jalë, kryetarja e kësaj force politike, Monika Kryemadhi deklaroi se Shqipëria ndodhet në udhëkryq. "Sot Shqipëria gjendet në një udhëkryq, ku shumë nga ne nuk dinë se si do të veprojnë. Sot Shqipëria është në mes të një udhëkryqi, pa një orientim të caktuar. Kemi një qeveri që nuk e dimë se çfarë është, ka edhe ministria të LSI-së, ka edhe ministria të Partisë Demokratike,



ka edhe ministria të Partisë Socialiste. Kemi një Parlament që do të mblidhet pas disa javësh dhe një situatë

ekonomike dhe politike tejet të rëndë", tha Kryemadhi. Sipas saj, në Shqipëri e majta e vërtetë po zbehet dhe vendi po shkon drejt diktaturës. "Dhe po mbulohet nga pluhuri i oligarkëve, nga pluhuri i një politike e cila gjithmonë e më shumë kërkon pushtet pa limit dhe çdo ditë e më shumë po e venit të majtën në Shqipëri, duke e kthyer vendin në një demokraci hibride dhe ndërkohë po shkojmë drejt diktaturës dhe çdo ditë e më shumë", shtoi ajo.

Nis zbatimi i urdhrin të ri për zonat Schengen

55 shqiptarë kthehen mbrapsht

Sipas burimeve nga policia, të kthyerit nuk përmbushnin kriteret e përcaktuara në urdhrin e drejtorit të përgjithshëm të policisë së shtetit dhe me dyshimin se mund të kërkojnë azil në vendet e BE



55 udhëtarë shqiptarë që kanë dashur të kalojnë kufirin për të udhëtuar jashtë vendit, janë kthyer nga autoritetet kufitare. 39 ndër ta janë kthyer në Rinas ndërsa të tjerët në pikat tokësore kufitare. Sipas burimeve nga policia, të kthyerit nuk përmbushnin kriteret e përcaktuara në urdhrin e drejtorit të përgjithshëm të policisë së shtetit dhe me dyshimin se mund të kërkojnë azil në vendet e BE. "Shtetasit janë refuzuar bazuar në masat

shtesë të përcaktuara në urdhrin e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, urdhër i dalë në fillim të muajit gusht", - tha Policia e Shtetit. Burimet thanë se do t'iu refuzohet kalimi i kufirit të gjithë shtetasve shqip-

tarë që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara nën urdhrin e Haki Çakos, për të udhëtuar drejt vendeve të BE-së, pra nëse nuk kanë adresë të saktë akomodimi apo destinacioni, nuk kanë ftesë pritëse, si dhe mjete të mjaftueshme

financiare. Urdhri që ashpëron kriteret dhe masat në kufi është firmosur më datën 1 gusht 2017 nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Haki Çako dhe mban nr. 805, me numër protokolli 5792. Mësohet se urdhri

në fjalë është lëshuar pas ultimatumave të zyrarëve të qeverisë franceze ndaj qeverisë shqiptare, por edhe pas mesazheve e shqetësimeve që ambasadorja e Francës i përcolli direkt Drejtorit të Policisë së Shtetit gjatë takimeve me të në muajin korrik. Kështu, sipas urdhrin të Drejtorit të Policisë, çdo shqiptar që kalon kufirin duhet t'i tregojë policit shqiptar adresën e saktë të akomodimit në vendin e destinacionit ku do të shkojë. Kriteri i dytë është ftesa që pritësit në vendin e destinacionit ku kërkohet që kjo ftesë të përmbajë kontaktet e pritësit. Kriteri i tretë është bileta apo rezervimi i biletës për kthim në Shqipëri në momentin e paraqitjes apo të nisjes për të dalë jashtë shtetit. Pika

e fundit në katër kriteret e vendosura është ajo e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve për kohën e qëndrimit. Kjo pikë ndonëse e papërcaktuar në urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, sipas një dokumenti zyrtar të ministrisë së Jashtme ka një vlerë konkrete. "Po sa është kjo shumë? Vende të ndryshme kanë përcaktuar shuma të ndryshme. Përafërsisht kjo shumë nuk e kalon 50 euro dita, kur shtetasi ka një rezervim hoteli", thuhet nga Ministria e Jashtme. Ndërkohë, mësohet se në rastet kur nuk paraqitet rezervimi i hotelit, qytetarit mund t'i kërkohej të ketë me vete shuma deri në 100 euro për çdo ditë qëndrimi në zonën Schengen. (BW)



Luftë? SHBA paralajmëron Korenë e Veriut



Tonet mes Uashingtonit dhe Phenianit po ashpërsohen gjithnjë e më shumë. Ministri amerikan i Mbrojtjes, James Mattis në një paralajmërim ndaj udhëheqjes komuniste bëri fjalë madje për luftë

Ministri amerikan i Mbrojtjes, James Mattis ka paralajmëruar Korenë e Veriut të mos nisë një luftë kundër vendit të tij. "Nëse ata do të godasin Shtetet e Bashkuara, kjo mund të kulminojë shumë shpejt drejt luftës", tha Mattis para gazetarëve. Uashingtoni dhe Pheniani i kanë ashpërsuar gjithnjë e më shumë tonet së fundmi. Presidenti amerikan kishte paralajmëruar se SHBA do të reagojnë me "zjarr dhe zemërim" ndaj testeve të tjera me raketa. Koreja e Veriut kërcënoi pas kësaj me sulm ndaj ishullit Guam, ku SHBA mban një bazë ushtarake. Mattis u shpreh, se nëse raketa do të marrë drejtimin e Guamit, "ne do ta asgjësojmë atë". Kreu i Pentagonit, Mattis bashkë me kreun e Departamentit të Shtetit, Rex Tillerson, të ftuar në një artikull me për "Wall Street Journal", kishin përdorur një gjuhë tjetër. Tillerson ishte treguar i përbajtur ndaj zgjidhjes ushtarake. Në artikull thek-

sohet se qeveria amerikane nuk ka ndonjë interes të rrezikshme të rrëzohet pushtetmbajtësin Kim Jong Un. Uashingtoni nuk ndjek as ndonjë strategji për bashkim të shpejtë të dy Kореve. "Nuk kemi asnjë nevojë që të dëmtojmë popullin koreanoverior që vuan prej kohësh, e që dallon nga regjimi i tij". Edhe ditët e ardhshme përmbajnë potencial konflikti mes Uashingtonit e Phenianit. Të martën të dy shtetet koreane përkujtojnë fitoren kundër trupave japoneze në përfundim të Luftës së Dytë Botërore. Qeveria e Phenianit mund ta përdorë këtë për një demonstrim të ri force. Kreu i shtetit koreanoverior, Kim Jong Un i është drejtuar SHBA-së me thirrjen që të lenë "provokimet arrogante" dhe "kërkesat e njëanshme". Gjatë vizitës në një shtab ushtarak ai e theksoi edhe njëherë gatishmërinë për të sulmuar ishullin Guam. Kina që konsiderohet si fuqia mbrojtëse e Koresë së Veriut rriti së fundmi presionin ndaj Phenianit. Ajo

reagoi me ndalimin e importit të hekurit, qymyrit dhe frutave të detit nga shteti i izoluar ndërkombëtarisht. Ndërkohë, Agjencia shtetërore e lajmeve e Koresë së Veriut, KCNA, tha se udhëheqësi i vendit, Kim Jong Un, mori raportet e ushtrisë së tij për planet e një sulmi përreth Guamit, një territor amerikan në perëndim të Oqeanit Paqësor. Kim tha se do të ndjek për një kohë më të gjatë veprimet e Shteteve të Bashkuara para se të marrë një vendim. Udhëheqësi i Koresë së Veriut urdhëroi ushtrinë që të jetë në gjendje gatishmërie nëse ai merr një vendim për të vepruar, thuhet në raportin e KCNA-së. "Shtetet e Bashkuara, që ishin të parat që kanë nisur një numër të pajisjeve bërthamore afër nesh, duhet të marrin vendimin e duhur dhe të dëshmojnë përmes veprimeve se kanë vullnet për uljen e tensioneve në gadishullin korean, në mënyrë që të shmangët ndonjë përplasje ushtarake



Irani kërcënon me largim nga marrëveshja bërthamore

Irani mund ta braktisë marrëveshjen bërthamore me fuqitë botërore, brenda orëve, në rast se Shtetet e Bashkuara vazhdojnë me politikën e tyre "të sanksioneve dhe shtrëngimit", ka thënë presidenti iranian, Hassan Rohani. Rohani u ka thënë ligjvënësve gjatë një fjalimi në Parlament, që është transmetuar në televizion, se "përvoja e dështuar e sanksioneve dhe shtrëngimeve e ka sjellë në tavolinën e bisedimeve regjimin e kaluar". "Në rast se ata dëshirojnë të kthehen prapë tek ajo përvojë, ne mund të kthehemi më të fuqishëm në situatën e mëparshme, jo brenda javëve apo muajve, por brenda orëve". Rohani ka thënë se administrata e presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, i ka treguar botës se ajo nuk ka qenë "partnere e mirë", duke kërcënuar prishjen e marrëveshjes bërthamore të vitit 2015. "Gjatë muajve të fundit, bota ka qenë dëshmitare se si SHBA-ja, duke thyer vazhdimisht premtimet e marrëveshjes bërthamore, ka injoruar edhe disa marrëveshje të tjera globale, dhe iu treguar aleatëve të saj se nuk është partnere e mirë dhe e besueshme", ka thënë Rohani para Parlamentit. Trump e ka përsëritur edhe një herë gjatë këtij muaji se Irani nuk është duke "jetësuar shpirtin" e marrëveshjes bërthamore, të cilën e ka cilësuar si "të tmerrshme". Sipas këtij pakti, fuqitë botërore i premtuan Iranit, lehtësimin e sanksioneve ndërkombëtare në këmbim të zvogëlimit të aktivitetit bërthamor. SHBA-ja dhe Kombet e Bashkuara, që vazhdojnë paktin, kanë thënë se Irani është duke iu përbajtur marrëveshjes. SHBA-ja i ka vënë Iranit sanksione të ndryshme për shkak të lansimit të raketave. Irani ka thënë se lansimi i tyre është bërë për qëllime të vetëmbrojtjes dhe ato nuk e rrezikojnë aspak marrëveshjen.

Makina futet në një piceri afër Parisit duke vrarë një 12 vjeçare



Autoritetet franceze thanë se një makinë u fut në një piceri në qytezën Sept-Sorts në lindje të Parisit, duke lënë të vdekur një vajzë 12 vjeçare dhe duke plagosur disa të tjerë. Zëdhënësi i ministrisë së Brendshme, Pierre-Henry Brandet, tha se shoferi qëllimisht goditi darkuesit, por shenjat e para nuk lënë të kuptohet se bëhet fjalë për një akt terrorizmi. Policia e arrestoi shoferin. "Nuk

mund t'ju them se terrorizmi është përjashtuar, por nuk është linja kryesore e hetimit aktualisht. Dëshmitë e para nuk flasin për terrorizëm", i tha ai televizionit BFM. Ai më pas i tha agjencisë së lajmeve Reuters, se burri ishte një 32 vjeçar në depresion. Oficerët e xhandarmërisë kombëtare bllokuan vendin e ngjarjes dhe u bënë thirrje qytetarëve që të mos pengojnë operacionin. Një fotografi e

publikuar në rrjetet sociale tregon një makinë të tipit BMW ngjyrë hiri të rrethuar nga tryeza të përmbysura para restorantit. Zëdhënësi Brandet tha se pesë të plagosur po trajtohen në spital me plagë të rënda. Tetë të tjerë pësuan plakë të lehta. "Të gjithë që ishin në tarracën e restorantit u goditën", i tha televizionit BFM një dëshmitar. Një burim i policisë tha se shoferi jetonte në një fshat afër Sept-Sorts, rreth 41 kilometra në lindje të Parisit dhe të shtunën kishte provuar të kryej vetëvrasje. Incidenti ndodhi më pak se një javë pasi që një algerian u arrestua nën dyshimet se qëllimisht goditi me makinë një grup ushtarësh në Paris duke plagosur gjashtë syresh.

Shpërthim në stacionin e trenave, panik në Londër

Stacioni i nëntokësor i trenave Holborn, në Londrën Perëndimore është evakuuar pasi tymi nisi të mbushte platformën. Pasagjerët thanë se kishin dëgjuar një shpërthim të madh në stacion rreth orës 9 të mëng-

jesit të së martës. Videot dhe imazhet e postuara online tregonin tymin që mbushte platformën dhe shërbimet e emergjencave jashtë stacionit. Zyrtarët thanë se stacioni ishte mbyllur dhe ishin në veprim skuadrat e

zjarrfikësve që kishin reaguar pas një alarmi për zjarr. Por, pas panikut të fillimit u tha se gjithçka kishte ndodhur si pasojë e një problemi me një tren dhe shërbimet e emergjencave po hetonin ngjarjen

Merkel nis fushatën, sondazhet e favorizojnë

Angela Merkel filloi zyrtarisht fushatën zgjedhore dhe takimin e parë elektoral zgjedhjeve të saj, Dortmundi. Pikërisht në këtë qytet, ku socialdemokratët mposhtin kristiandemokratët, kancelarja gjermane nisi rrugëtimin e takimeve për të kërkuar mandatin e katërt në krye të ekonomisë më të fuqishme të Evropës. Rreth 800 vetë ndodheshin në takimin e organizuar në Dortmund,

ku Merkel foli për punën e bërë në luftën kundër papunësisë dhe objektivit të përgjysmimit të të papunëve për mandatin e ardhshëm. Merkel u bëri thirrje kristiandemokratëve të bëjnë një fushatë zgjedhore aktive. "Ne duhet t'i bëjmë njerëzit për vete, duhet të luftojmë, duhet të angazhohemi për çështjet tona", tha Merkel. Ndërkohë, socialdemokratët kanë ashpërsuar tonet ndaj kancelares. Kreu i grupit parlamentar të

tyre në Bundestag, Thomas Oppermann tha se koha e Merkel ka marrë fund. Ai deklaroi se prej vitesh, Angela Merkel po gëzon sukseset e reformave ekonomike të nisura nga kancelari i fundit socialdemokrat, Gerhard Schröder. Megjithatë akuzat e socialdemokratëve, sondazhet e deritanishme flasin për një avantazh të dukshëm të Angela Merkel përballë Martin Schulz. Gjermanët do të votojnë më 24 shtator.



Prëfimi i jashtëzakonshëm për një dinasti që ka një vend të padiskutueshëm në historinë e Evropës. Bankierët që u pasuruan me bekimin dhe Vatikanit dhe e bënë Firencen një qytet me të pangjashëm në të gjithë kontinentin

Historia e një familjeje, e mbushur me suksese, por edhe me shumë komplete, vrasje (edhe brenda Katedraleve) dhe hakmarrje. Një familje që nxori Papë, dhe që u bë mbrojtësja e artistëve dhe dijetarëve më të mëdhenj të Rilindjes, nga Mikelanxhelo tek Boticeli, nga Leonardo Da Vinçi, tek Galileo Galilei, dhe që frymëzoi "Princin" e jashtëzakonshëm të Makiavelit

Evropë, viti 1400: Një kontinent i rrënuar prej luftës dhe murtajës, dominohet nga autoriteti i Kishës Katolike. Në qytete dhe qendra banimi, tregtarë e sipërmarrës ndiejnë se bota e tyre po ndryshon. Me rritjen e tregtisë dhe pasurisë, zhvillohet edhe një etje për më shumë dije. Duke mos qenë më të neglizhuar në hijet e Kishës, filozofia klasike, poezia, arti dhe skulptura nisin të arrijnë një audiencë të re. Kjo është veçanërisht e vërtetë në qytete kozmopolitane si Firenze, vendlindja e Kozimo de Medicit. Firenze në 1400 është si asnjë qytet tjetër në Evropë. Një qendër e madhe tregtie në zemër të Toskanës, ajo është një republikë ku familje të fuqishme konkurrojnë për kontrollin politik. Që nga një rrugë anësore në sheshin kryesor, i ati i Kozimos, Xhovani de Medici menaxhon bankën de Medici. Në një lëvizje mendjemprehtë, Medicit, babë e bir "vënë bast" në zgjedhjet papnore dhe fitojnë. Shpërblimi për besnikërinë e tyre është e gjithë llogaria bankare papnore. Duke u mbështetur në këtë kontratë, banka Medici zgjerohet në të gjithë Evropën, duke e ngjitur familjen në elitën e Firences.

KUBEJA

Familjet kryesore të Firences kanë si obsesion një dështim poshtërues. Për më shumë se një shekull, një katedrale shumë e madhe ka qëndruar mbi kryet e qytetit. Nuk ka çati apo kube dhe është krejt e hapur. Ata që e kishin planifikuar, ndërtuan një hapësirë qendrore shumë të madhe për t'u mbuluar. Kushdo që do t'i jepte qytetit kubën e tij, do të fitonte famën e përjetshme. Një burrë besonte se dinte si ta ndërtonte atë kube. Filippo Brunelleski, arpunues dhe inxhinier kishte studiuar teknikat e ndërtimit si dhe materialet e Romës së lashtë, dhe ai besonte se ishte në gjendje të rishkruante rregullat e arkitekturës moderne. Tani, me ndihmën e një veze, ai bindi autoritetet e katedrales që ta lejonin të ofronte shfaqjen më gjigande në qytet. Ndërkohë, teksa pasuria e Medicit rritej, e njëjta gjë ndodhte

De Medici, familja që i dha shkëlqim historisë së Italisë



edhe me egërsinë e rivalëve. Sapo Xhovani vdes, familja Albizi nis një luftë kundër trashëgimtarëve të tij, de Medici. Firenze nuk është e madhe sa duhet për të patur vend për të dy familjet, dhe në 7 shtator 1433, Kozimo de Medici arresto-

het dhe akuzohet për tradhti. Kozimo shfrytëzon pasurinë për të korrupuar dhe dalë pa lagur nga burgu, por Medicit shpallen të jashtëligjshëm dhe Albizit triumfojnë. Tashmë, asnjë mik i Kozimos nuk është i sigurt. Edhe Bruneleskin e flakin në

qeli, duke bërë kështu të ndalet puna për kubën. Jeta pa Medicit nuk është e lehtë. Në Firenze, biznesi shteron, dhe brenda një viti zemërimi drejtohet kundër familjes Albizi. Me ndërhyrjen e Papës, Kozimo siguron rikthimin në Firenze, dhe rimerr pozi-



në dinastinë Medici. Në punishtet e Firences, biznesi nuk ka ecur kurrë më mirë. Nën patronazhin e Medicit, artistë si Sandro Boticeli punojnë dhe i japin në përcaktim të ri vetë Rilindjes. Për momentin, "Adhurimi i misterit" i Boticelit konfirmon pozicionin e tij në qendër të pushtetit të Medicit.

NJË LIDER I RI

Në moshën 20-vjeçare, Lorenzo bëhet Kapo i familjes Medici. Kumbari i ri u hap dyert njerëzve të zakonshëm të Toskanës. Në këmbim të çfarëdolloj gjëje që ata mund të lejojnë vetes, Lorenzo ofron ndihmë dhe mbrojtje. Ky rrjet favoresh të ndërsjellë quhet amici degli amici - "miqtë e miqve". Pritjet e rregullta brenda Pallatit Medici bëjnë bashkë më të diturit e Firences, ajkën e tyre. I frymëzuar, Boticeli krijon një zhanër krejt të ri të artit. Në një botë të dominuar nga Kisha, Lorenzo injekton një frymë lirie laike, e megjithatë, njëkohësisht ai është duke bërë shumë armiq, dhe me shumë shpejtësi. Familja Paci janë xhelozë për pushtetin e jashtëzakonshëm të Lorencos. Me mbështetjen e Papës, ata komplotojnë për të vrarë Lorencon dhe vëllanë e tij.

VRASJE NË KATEDRALE

E diel Pashkësh, 26 Prill 1478: Mijëra vetë ndodhen brenda katedrales së madhe të Firences. Mes tyre, Lorenzo, i vëllai dhe familja Paci. Në kulmin e ceremonisë, vrasës të paguar hyjnë dhe u afrohen vëllezërve Medici. Xhuliano qëllohet 19 herë me thikë dhe vdes përpara familjes së tij të tmerruar. Lorenzo zhduket. Qyteti zhytet në kaos. Fjala për vrasjen përhapet si erë, dhe familja Paci përpiqet të marrë kontrollin. Krejt papritur, në dritaret e pallatit të tij shfaqet Lorenzo, i mbytur në gjak, por i gjallë. Qyteti kthehet kundër familjes Paci dhe hakmarrja është brutale. Vrasja e Xhulianos trondit Italinë. Aleatë të familjes Paci dëshirojnë të përfundojnë punën që ata nisën, dhe i shpallin luftë Firences. Lorenzo udhëton i vetëm, për të negociuar me kumbarët e jugut. "Ndoshta Zoti dëshiron që kjo luftë, e cila nisi me gjakun e tim vëllai dhe gjakun tim, të përfundojë me mjetet e mia".

cionin e tij si lider jozyrtar i qytetit. Hakmarrja është e ëmbël.

TRIUMF?

Me një shije për artin dhe plot talent, Kozimo autorizon tashmë zanatçinjtë më të mirë të epokës së tij. Që nga Donatelo e Lipi deri tek Mikelozo dhe Gozoli, vepra të mrekullueshme prodhohen në emër të Kumbarit. Deri në 1436, kuberja më në fund është përfunduar, dhe meritën e merr Kozimo. Ai fton mikun e tij, Papën, që të kryejë shenjtërimin. Në vitin 1439, Kozimo nuk lejon t'i shpëtojë rasti për të bashkuar kulturat e lindjes dhe perëndimit, në Këshillin e mrekullueshëm të Firences. Është kulmi i suksesit të tij, e megjithatë Kozimo ka frikë për të ardhmen e dinastisë së tij. Biri i tij i preferuar dhe nipi vdesin përpara tij. "E njoh humorin e qytetit tim, para se të kenë kaluar 50 vite do të na kenë përzënë, por ndërtesat e mia do të mbeten". Me vdekjen e tij në 1464, Kozimo nderohet me titullin Pater Patriae - Baba i Atdheut - por, kush do të udhëheqë Medicit dhe Firencen? Kush do të zërë vendin e Kumbarit të Rilindjes?

Firence, gusht 1466: Lorenzo de Medici, trashëgimtari 17-vjeçar i dinastisë, zbulon dhe pengon një komplot për vrasjen e të atit dhe shpëton familjen nga një coup d'état. Medicit ende e dominojnë Firencen, por tani marrin masa mbrojtëse shtesë, duke përzgjedhur një nuse të dobishme për Lorencon. Klaris Orsini, një bijë baroni dhe mbesë kardinali sjell lidhje, klasë, si dhe muskuj ushtarakë

Ai rikthehet në Firenze triumfues, pasi i ka ofruar rryshfet Mbretit të Napolit dhe sprapsur Papën. Pasi ka marrë nofkën Il Mag-




nifico "I Mrekullueshmi" nga qyteti i tij mirënjohës, Lorenzo eleminon gjithë kundërshtarët. Ai adopton djalin e jashtëligjshëm të vëllait të vdekur dhe vendos të gjithë qeverinë nën kontrollin e tij personal. Lorenzo është tashmë një diktator. Rilindja vazhdon të lulëzojë. Boticelli autorizohet të pikturojë një dhuratë martesë për kushëririn e Kumbarit, "Lindjen e Venusit". Ndërkohë, zbulohet Leonardo Da Vinçi dhe ai futet në vathën e Medicit. Në shkollën e parë të artit në botë, Lorenzo zbulon një gjeni, Mikelanxhelo Buonarotin dhe e adopton edhe atë në familjen e tij.

PROFETI I FATKE-QËSISË

Etja e Lorencos për kulturë materiale dhe shija e tij për jetesë me standarde të lartë ofendon një murg të ri dhe shumë të zellshëm. Xhirolamo Savonarola beson se Lorenzo po udhëqej Firencen në një shteg dekadent shkatërrimi. Ai nis të predikojë kundër Medicit, "Shkoni dhe i thoni Lorencos që të pendohet për mëkatet, sepse Zoti do të ndëshkojë atë dhe familjen e tij". Në vitin 1492, Lorenzo sëmuret. Parashikimet e Savonarolës po realizohen, dhe mbështetja për të në Firencë rritet. Pasuria e bankës Medici pëson rënie të menjëhershme dhe rrjeti i influencës së familjes nis të shpërbëhet. Lorenzo vdes. Savonarola përhap llojin e tij të fundamentalizmit në të gjithë Firencen. Të gjithë gjurmët e ekstravagancës konsumohen në zjarrin e madh të kotësive. Prostitutat rrihen, homoseksualët digjen të gjallë. Medicit shpallen të jashtëligjshëm. Firence, në kërkim të shpëtimit, është shndërruar në një vizion të ferrit. Firence, 1501: 26 vjeçari Mikelanxhelo realizon një kryevepërgigande, e cila do të simbolizojë betejën e tij kundër një familjeje që dikur e adhuronte. I rritur në moshë të re pranë trashëgimtarëve Medici, ai pa se si ata u dëbuan dhe mbi kokën e tyre u vendos një shpërblim. Tani, janë vënë në kërkim të një rruge që do t'i kthejë në pushtet.

26 Janar, 1504: Mikelanxhelo zbulon Davidin përpara syve të të gjithë botës. Përshëndetet si një triumf i vrtetë. Mikelanxhelo ka krijuar simbolin më të fundit të rezistencës ndaj familjes së përmysur Medici. Xhulio de Medici është paracaktuar prift dhe kryemurg. Kushëririn e tij, Xhovani është tashmë kardinal, por lidhjet e tyre klerikale kanë shumë pak rëndësi, pa Firencen.

Papa Julius II, edhe ai nga një familje e fuqishme, është në mbështetje të përpjekjeve të tyre. Me ndihmën e tij, kushërinjtë mbledhin një ushtri dhe nisen për Firence. Ndërkohë, Firence pa Medicit është duke lulëzuar. Përkundër dëshirave të Kishës,



Leonardo Da Vinçi hap trupat e kufomave për studime private anatomike. Me qytetin nën rrezikun e pushtimit, ai dhe Mikelanxhelo ftohen që të prodhojnë afreske të betejave të famshme fiorentinase. Është një konkurrencë intriguese. Në 1512, mijëra trupa janë duke marshuar drejt Toskanës. Firence i kërkon Nikolo Makiavelit, gjenisë politik, që të përgatisë mbrojtjen e saj. Ushtarët që ai stërvit janë shumë pak për ushtrinë e Medicit. Prato, një vend jashtë Firencës, shndërrohet në një kasaphanë gjigande. Xhovani shpall masakrën një veprim kundër atyre që do të përpiqen t'i rezistojnë. Ka të drejtë, liderët e Firences dorëzohen. Përmes

dhunës dhe terrorit, Medicit rimarrin kontrollin e qytetit, por jo besnikërinë e popullit të Firences.

PAPA LEONI

Me vdekjen e Papa Juliusit, kardinalët mblidhen në Romë. Ata harxhojnë një kohë shumë për zgjedhjen e një Pape të ri, sa që vaktet e tyre reduktohen në një pjatë aspak ndjellëse. Xhovani de Medici shpallet fitues dhe nga ky moment, ai do të njihet si Papa Leoni X. Ndërkohë, Mikelanxhelo është trembur për të ardhmen e tij. A mundet që suksesi i tij i kohëve të fundit brenda Kapelës Sistinë ta shpëtojë nga zemërimi i Medicit? Kushërinjtë i bëjnë artistit një ofertë që ai nuk mund ta refuzojë, kur i kërkojnë

të ndërtojë varret e baballarëve të tyre të vdekur, Lorenzo i Mrekullueshmi dhe Xhuliano de Medici. Tani, edhe vetë Makiaveli është vënë në kërkim të një pune në regjimin e Leonit. Por plani i tij shkakton kundërplasje dhe, i shtrënguar në mërgim, ai harton një manifest për diktatorët e pamëshirshëm.

Papa Leoni X ndërton një reputacion për bollëk dhe luks të tepruar, me dashurinë e tij për bankete me 65 pjata si dhe festa ekstravagante. Dëshpërimisht në kërkim të parave kesh, ai nis të përdorë mjetin më të fundit për të bërë para, shitjen e indulgjencave. Agjentë të Papës Leo X shesin indulgjenca papnore në të gjithë Evropën, duke shkaktuar në këtë mënyrë zemërimin e shumëkujt, përfshirë atë të një murgu gjerman. Në vitin 1517, Martin Luteri publikoi "95 tezat" duke i dhënë kështu shkëndijën një revolucioni fetar. Leoni përpriqet të heshtë heretikët, por zhytet në një ngricë dimërore. Kushëririn e tij, Xhulio kurorëzohet pas tij si Papa Klementi VII dhe atij i duhet të përmirësojë imazhin. Një detyrë e vështirë. Pasojat e reformimit të Luterit sjellin ushtri të xhindosura në dyert e Romës. Shumë prej tyre janë Luteranë dhe ata e urrejnë Papën. Në 7 maj 1527, ushtarë gjermanë dynden në Romë. Klementi i shpëton masakrës, por grabitja e Romës shndërrohet në momentin më të errët të Rilindjes.

GJYKIMI I FUNDIT

Klementi, në çastet e fundit të jetës thërret Mikelanxhelon që të përfundojë veprën e tij në Kapelën Sistinë. E jashtëzakonshme "Gjykimi i Fundit" do të jetë edhe kthesa e fundit në marrëdhënien e Mikelanxhelos me Medicit. Por, Klementi nuk do të jetojë për ta parë të përfunduar. Në vitin 1534, i lodhur e dërrmur tashmë nga trazirat e vetë mbretërimit të tij, ai vdes. Pushteti shkatërrimtar i Papëve Medici ka marrë fund. Firence, 1537: Alesandro de Medici, Duka i Firences prehet i vrarë në shtratin e tij. Kushëririn e tij nxirret që nga hijet për të udhëhequr Firencen. Është vetëm 17 vjeç. Rivalët e tij mendojnë se është janë kukull, por pavarësisht moshës, Kozimo de Medici, duka i ri i Firences është shumë ambicioz.

NJË NJERI I RILINDUR

Kozimo bën një marrëveshje me Xhorxhio Vasarin, një artist i gjithanshëm që beson se Duka i ri ka potencial. Në moshë të re, Vasari kish qenë shpëtimtari i krahut të thyer të Davidit të Mikelanxhelos. Tani, me miratimin e Kozimos, ai është vënë të mbikëqyrë riparimin e tij. Firence është një qytet i rrezikshëm, dhe e fundit gjë që Kozimo dëshiron është të përfundojë si kushëririn e tij. Kështu që, ai detyrohet të nisë një regjim shumë rigoroz stërvitjeje për t'u ruajtur nga atentatet. Martesa e tij e mençur me një princeshë spanjolle sjell një ushtri të tërë si prikë. Me të, ai nis të mendojë pushtimin e fqinjëve. Republika e Sienës bie, dhe shumë shpejt edhe pjesa tjetër e Toskanës kapitulon përballë Medicit. Kozimo nuk vonon të publicizojë suksesin e tij. Nëpër muret e ndërtesës së vjetër të qeverisë, ai porositi realizimin e afreskeve monumentale nga Vasari. Një ushtri punëtorësh mbush muret e pallatit mesjetar me legjenda kurajoze dhe arritjesh. Kozimo sigurohet që çdo brez i familjes së tij të ketë vendin e vet, duke e shndërruar qendrën e republikës së vjetër në një tempull të paturp për dinastinë Medici.

Gjithsesi, as kjo nuk mjafton për të kënaqur

Dukeshën e tij. E etur për madhësi, Eleonora paguan 9000 florina për Pallatin Pitti, një fortesë shumë e madhe në pjesën jugore të Arnosit. Siguria është e mirëpritur. Në Firence ende ziejnë komplotet për vrasje, dhe Kozimo nuk shkon askund pa thika poshtë pantallonave, si dhe parzmore nën veshje. Por tashmë, i fiksuari pas kontrollit ka një tjetër problem. Ai është zot i një administrate komplekse, e menaxhuar nga zyra të panumërta të shpërndara në të gjithë qytetin. Vasari i kërkohet të ofrojë ndërtesa për një administratë të centralizuar. Ndërtesat e tij ngrihen në të dy anët e një rruge me një korridor që lidh të dy krahët. Fushatës kulturore të Kozimos i vihet kapaku me një libër të shkruajtur nga Vasari, i cili i vë vulën reputacionit të Medicit një herë e përgjithmonë. "Jeta e artistëve" është e para vepër mbi historinë e artit.

TRIUMF


Kozimo është më në fund i sigurt. "Jam një sundimtar që nuk pranon autoritetin e askujt, përveç Zotit", thotë ai. As edhe dalja në skenë e inkuizicionit të tmerrshëm roman nuk mund të zbehtë suksesin e tij. Ai organizon një ceremoni publike për dëgjie librash, për të kënaqur urdhrat e tyre të censurës. Në këmbim, ai kurorëzohet Kozimo I, Dukë i Madh i Toskanës nga vetë Papa. Me Kozimo I, de Medici kanë mbërritur tashmë në shkallët më të larta të mbretërive ndërkombëtare. Duken të pakundërshtueshëm. Pas mbretërimit të Kozimos, shkenca nis të përplaset gjithnjë e më shumë me doktrinën katolike, një proces që shfaqet e mishërohet tek shkencëtarit më i madh i kohës, Galileo Galilei. Për tre breza, Galilei u jep mësim Dukëve të Mëdhenj të Medicit, duke informuar njëkohësisht botën për astronominë, gravitetin, shpejtësinë, pluskimin dhe kohën. Por, në momentin që guxon të thotë se Toka rrotullohet përreth Diellit, tashmë Papës i ka ardhur në majë të hundës. Galileo thërret përpara Inkuizicionit në Romë dhe kërcënohet me torturë. Medicit tashmë detyrohen që të zgjedhin, mes besnikërisë së tyre ndaj Kishës dhe besnikërisë ndaj vlerave të Rilindjes. Ata zgjedhin rrugën që kërkon më pak rezistencë, duke tradhtuar Galileon. Me sa duket, nuk kanë arritur të ruajnë tek vetja atë çfarë i ka bërë të dallohen nga rivalët për breza të tërë. Rilindja në Itali merr fund. Ndonëse tashmë mbretërimi i Medicit ka marrë fund, lëvizja që ata kanë nisur afron më pranë iluminimin, Epokën e Arsyes dhe Botën Moderne. Shumë padronë do të përpriqeshin të ecnin në gjurmët e tyre, por asnjëri nuk do të ishte në gjendje të ngrihej në nivelin e trashëgimisë së Medicit, Kumbarëve të Rilindjes. (konika.al)





Nepali i jep fund traditës shekullore që dëbonte femrat

Ligjvënësit në Nepal miratuan një ligj që e kthen në krim, praktikën e dëbimit të femrave nga shtëpitë e tyre gjatë ciklit menstrual. Sipas ligjit të ri, kushdo që detyron një femër të respektojë këtë traditë të vjetër përballë me 3 muaj burg dhe një gjobë prej 30 dollarësh. Kjo praktikë, që në Nepal njihet si "Chhaupadi" dhe që respektohet në zonat rurale prej shekujsh, u kritikua ashpër së fundmi, pasi dy ferma ndërruan jetë ndërsa qëndronin në kasollet e ndërtuara enkas pranë banesave, ku kalonin ditët e ciklit menstrual. Autoritetet në Nepal thanë se ligji do të hyjë në fuqi pas një viti, kohë gjatë së cilës do të zhvillohet një fushatë sensibilizuese në zonat rurale, për t'i informuar banorët mbi ndëshkimin që do të pësojnë nëse i detyrojnë femrat të respektojnë këtë traditë të turpshme. Sipas praktikës së lashtë hindu, femrat që po kalojnë periodat apo që sapa kanë lindur shihen si të papastrat apo që sjellin fat të keq. Për këtë arsye dëbohen nga shtëpitë për ato ditë dhe nuk lejohen të prekin bagëtinë, meshkujt apo të konsumojnë disa lloje ushqimi. Aktivistët në Nepal e përshëndetën ligjin e ri që ndalon këtë praktikë, por thanë se autoritetet duhet ta zbatojnë atë, përndryshe s'ka asnjë kuptim.





Torte: Me Milanin japim gjithçka për prezantim dinjitoz



Me tre pikë nga ndeshja e parë e sezonit të ri garues 2017/2018 kur u mund 2:0 Vardari në Tetovë, skuadra e Shkëndijës tani më ka kthyer vëmendjen kah sfida historike me Milanin në San Siro. Paraqitja bindëse përballë rivalit nga Shkupi ka përmirësuar edhe ashtu atmosferën e shkëlqyeshme në skuadër që vjen si pasojë e një ecurie të bukur në UEFA Europa League. Ekipi për të dytin vit me radhë gjendet në fazën e play offit, shkalla e fundit para grupeve. Për të hyrë aty Shkëndija ka para vetes pengesë shumë serioze, pasi përballlet me 7 herë fituesin e Ligës së Kampionëve, Milanin.

“Prej kur shorti caktoi që kundërshtari ynë të jetë Milani është folur shumë për këto ndeshje

MILAN — SHKËNDIJA, ÇAKTOHEN GJYQTARËT

UEFA ka caktuar gjyqtarët për ndeshjen e parë mes Milanit dhe Shkëndijës së Tetovës. Drejtësinë në ndeshjen mes Milanit dhe Shkëndijës së Tetovës do ta ndajë gjyqtari austriak, Harald Lechner. Kurse, ndihmës të Lechner do të jenë: Andreas Heidenreich Maximilian Kolbitsch, derisa gjyqtari i kapterët është Julian Weinberger. Ky takim do të luhet të enjten në San Siro nga ora 20:45, në kuadër të Play Off-it të Europa Leagues.

dhe kjo është krejt normale. Ne jemi të kënaqur që edhe një herë kemi mundur të dalim me paraqitje të bukura në Europë, duke arritur në play off. Tani për Milanin nuk duhet të harxhojmë fjalë. Të gjithë e njohin këtë skuadër dhe cilësinë e tyre, pa marrë parasysh se viteve të fundit nuk kanë qenë në nivelin e pritur. Për ne kjo është një sfidë e re, mundësi e mad-

he për tu përballur me një ekip të fortë kundër të cilëve do të dalim për të dhënë më të mirën nga vetja. Fundi do të tregojë nëse kjo do të jetë e mjaftueshme për të bërë befasinë e radhës”, shprehet mesfushori i talentuar, Ennur Totre, i cili ishte ndër më të mirët në teren të shtunën kundër Vardarit.

“Bëmë një ndeshje të madhe dhe ai duhet të jetë

Pas startit të suksesshëm të sezonit të ri në LPFM dhe paraqitjes bindëse kundër Vardarit, futbollistët e Shkëndijës tani më kthejnë vëmendjen kah sfida e parë e play offit të UEFA Europa League përballë Milanit në San Siro. “Kuqezinjtë” të hënën u lanë të lirë nga trajneri Osmani, ndërsa të martën pas stërvitjes së mëngjesit ekipi udhëtoi drejt Milanos

modeli si duhet të luajmë në çdo takim. Ishte me rëndësi të nisim me tre pikë, posaçërisht pasi bëhej fjalë për ndeshje derbi dhe jemi të kënaqur pasi demonstruam cilësi dhe kualitet përballë Vardarit që në fund rezultoi me fat për humbjen prej vetëm 2:0. Ne jemi futbollistë dhe bëjmë punën tonë, por kënaqësia është e madhe kur shikon aq njerëz të lumtur nga paraqitja e treguar. Kjo na bën të japim gjithçka nga vetja dhe ashtu do të jetë gjithmonë, edhe kundër Milanit të enjten”, përfundoi Totre. Pas ndeshjes me Vardarin skuadra të dielën kishte rikuperim, ndërsa trajneri Osmani të hënën i la futbollistët të lirë. Dje ekipi ushtroi paradite në Tetovë, ndërsa pas dite udhëtoi drejt Milanos.



Behrami nesër zyrtarizohet te skuadra e re

Valon Behrami nesër do të zyrtarizohet te skuadra e re. Mesfushori me prejardhje nga Kosova, ka lënë Watfordin për t'u rikthyer në Serie A, te skuadra e Udineses. 32 vjeçari sipas medieve në

Itali, ka mbërritur në Friuli ku ka kryer edhe testet mjekësore, derisa nesër do të vije zyrtarizimi. Ai pritet të jetë gati për ndeshjen e parë hapëse të Serie A, ku Udinese në shtëpi pret Chievon.

Daja nuk nënvlerëson Dinamon



Dita e revanshit po afrohet teksa Skënderbeu do të udhëtojë drejt Zagrebit me misionin për të tentuar fazën e grupeve ndaj gjigandit të futbollit kroat, Dinamo. Shorti nuk u tregua shumë bujar edhe pse skuadra më e famshme në kroaci ka humbur shkëlqimin e dy viteve më parë, kur eliminonte Skënderbeun nga faza Play-Off në Champions League. Trajneri Ilir Daja po pregatit skuadrën me idetë e tij për t'u kundërpërgjigjur në fushë kundërshtarit. Në konferencën për shtyp natyrishtëm kërkohen paralelizmat midis dy periudhave, dicka që trajneri i kroatëve e eviton me diplomaci. “Nuk jam unë njeriu

i duhur për të bërë krahasimet pasi nuk kam qenë trajneri në atë periudhë. Ne do bëjmë shumë gabim nëse mendojmë se Dinamo e tanishme është më e dobët se ajo e para dy viteve.” Megjithatë jo të gjithë kanë të njëjtin mendim, pasi mbrojtësi Marko Radas, një produkt i shkollës së Dinamos së Zagrebit tregohet më i drejtpërdrejt përse i përket krahasimit të kundërshtarit me atë të dy viteve më parë. “Mendoj se ishte më i fortë përpara dy viteve. Por këto dy javë ata kanë ngritur shumë formën e tyre madje duke moshtur edhe Rijekën dhe mendoj që janë sërish të fortë.” Nga Skënderbeu është larguar mesfushori Afrim Taku, teksa është i gatshëm sulmuesi Soue. Trajneri Ilir Daja eviton të zbulojë drejtpërdrejt formacionin por duke konfirmuar Souen në majën e sulmit. “Lojtarët e dijnë se kush luan nga fillimi pasi kemi punuar taktikisht gjatë kësaj kohe. Besoj që Soue do ta nisë titullar pasi është përshtatur menjëherë me grupin.”

Arbitër italian për ndeshjen Vardar-Fenerbahçe

Në deklaratën e publikuar nga UEFA, konfirmohet se arbitri i ndeshjes që do të luhet në Shkup më 17 gusht, është Luca Banti nga Federata e Futbollit të Italisë. Arbitri i ndeshjes mes Vardar-it të Shkupit dhe Fenerbahçes në kuadër të raundit “play-off” të UEFA Ligës së Evropës që do të zhvillohet në Shkup më 17 gusht të

enjten, është Luca Banti nga Federata e Futbollit të Italisë. Në deklaratën e publikuar nga UEFA, konfirmohet se arbitri i ndeshjes që do të luhet në Shkup në stadiumin “Filipi i II” në orën 20.00, është Banti. Ndihmësit e Banti do të jenë Matteo Passeri, Fabionao Preti, arbitri i katërt Marco Guida po ashtu nga Italia.



Pritet lista “Panucci”, kuqezinjtë mblidhen më 28 gusht



Në një kohë që shumë prej përfaqësuesve europianë kanë nisur të formalizojnë listat e futbollistëve të grumbulluar për kualifikueset, kombëtarja kuqezi pritet ta bëjë këtë javën e ardhshme. Trajneri Christian Panucci ka lëvizur jo pak në këto javë për të vëzhguar ata që mendohen si kontigjent për ndeshjet kualifikuese të Botërorit 2018.

Polemikat për rastin e Taulant Xhakës pritet të marrin dhe përgjigjen

zyrtare të trajnerit italian. Mesfushori ishte autor i një goli shumë të bukur në Kupën e Zvicrës me Bazelin, duke dhënë një sinjal të qartë se është në formë për të qenë në kualifikuese. Por më shumë se përgatitja, problem për futbollistin është karakteri i tij. Nëse do të përzgjidhet nga Panucci për dy ndeshjet e radhës, atëherë ajo që shpresojnë tifozët, tejkalimi i përplasjeve, do të jetë formalizuar.

Strakosha dhe Berisha do të jenë me të gjitha gjasat në listë, por mbetet për t'u parë se kush do të mbrrojë portën, talenti i Lacios që po spikat këto ditë, apo gardiani i Atalantës që ka shkëlqyer në miqësore.

Kombëtarja shqiptare e futbollit do të mblidhet në datën 28 gusht nën urdhrat e trajnerit, 4 ditë para sfidës së parë të vlefshme për kualifikueset e Botërorit. Më 2 shtator, kuqezinjtë do të presin Li-

htenshtajn në “Elbasan Arena” dhe 3 ditë më vonë përballen me Maqedoninë në Strumicë.

Këto dy takime do të shërbejnë më shumë për trajnerin e ri që të njihet me skuadrën, por gjithashtu për të mbajtur pozicionin në FIFA. Shqipëria ndodhet në grupin G të kualifikuesve për Botërorin 2018, e treta me 9 pikë, po aq sa Izraeli, ndërkohë që grupi kryesohet nga Italia dhe Spanja.



“Ne bëmë çmos që Azra të arrijë deri në Kampionatin Botëror, për këtë investuam shumë, deri në 10 mijë euro. Mirëpo, për fat të keq edhe pse ishte kampione në kampionatin shtetëror të fundit ajo u refuzuar të merr pjesë në Spanjë kinse nuk u plotësuan disa kushte. Ata e bënë rregulloren si deshën vetë”

Zidane i acaruar me vendimin për Ronaldon

Skualifikimi i Cristiano Ronaldos me 5 ndeshje nuk është pritur aspak mirë nga trajneri i Realit të Madridit Zinedine Zidane, i cili në konferencën për shtyp përpara El Clasicos së kthimit për Superkupën e Spanjës përdori tonet ashpra ndaj komisionit të disiplinës në ligën spanjolle të futbollit, kur u pyet për dënimin e yllit portugez. “Jam i acaruar. Nuk dua të merrem me arbitrat, por kur shikon atë që ka ndodhur, të vjen keq. Të mendosh që Cristiano do ti mungojë skuadrës në 5 ndeshjet e ardhshme, këtu dicka po ndodh dhe jam shumë i mërzitur për këtë. E gjithë bota është e acaruar me vendimin që është marrë, sepse ai ka bërë shumë pak për të munguar për aq shumë kohë. Nuk dua të flas për episodin e Suarez-it. Ajo që mund t'iu them është se Ronaldo është i mërzitur sepse dëshiron dhe kur nuk



luan ai nuk është i kënaqur”. Krenar për skuadrën që ai drejton por në të njëjtën kohë, Zidane kërkon përqendrim maksimal për sfidën e kthimit ndaj Barcës sepse pavarisisht fitores 3-1 në Camp Nou janë edhe 90 minuta të tjera për tu luajtur dhe sipas trajnerit francez Superkupa e Spanjës nuk

është ende pronë e Los Blancos. “Jam krenar për të gjitha ato që kemi arritur gjatë kësaj periudhe. Nuk ka qenë e lehtë për ne për të arritur në këtë pikë ku jemi sot. Kemi një skuadër shumë të talentuar, por të gjithë kanë bërë një punë të madhe. Në futboll asgjë nuk është e sigurtë. Është edhe një

ndeshje e kthimit të cilën duhet ta luajmë mirë, sepse Barcelona është një skuadër e madhe dhe mund të na vendosë në vështirësi në cdo moment. Në ndeshjen e parë, ata krijuan shumë raste kështu që ne duhet ta luajmë këtë sfidë për ta fituar nëse duam të bëjmë tonin trofeun e Superkupës”.

Azra Curri braktis karatenë, fajtor Federata e Maqedonisë

Gjëra të çuditshme po ndodhin kohën e fundit në Federatën e karatesë së Maqedonisë edhe atë në prag të Kampionatit Botërorë për kadetë, junior dhe junior deri në 21 vjeç, që do të mbahet në Tenerife të Spanjës (25 deri 29 tetor). Ky institucion sportiv pas mbledhjes së fundit, ka marrë vendime befasuese ku kampionia, Azra Curri, është lënë jashtë KB, dhe kjo ka bërë që prindi i saj të frustrohet aq shumë saqë ka vendos madje edhe që vajza e tij të tërhiqet nga karateja.



“Ne bëmë çmos që Azra të arrijë deri në Kampionatin Botëror, për këtë investuam shumë, deri në 10 mijë euro. Mirëpo, për fat të keq edhe pse ishte kampione në kampionatin shtetëror të fundit ajo u refuzuar të merr pjesë në Spanjë kinse nuk u plotësuan disa kushte. Ata e bënë rregulloren si deshën vetë”, tha i ati, Muhamet Curri.

Nga ana tjetër, ka reaguar edhe trajneri i saj, Elvir Kurtoviq “Edhe pse është kampione e Maqedonisë dhe më e mira në kategorinë e saj, Federata e Karatesë së Maqedonisë zgjodhi kushte selektive dhe në praktikë duket si i palogjikshëm. Mohimi i pjesëmarrjes në Kampionatin Botëror në Spanjë është një nga shumë dëshmitë se Azra dhe familja e saj vendosën që pas 12 vitesh karrierë, stërvitje aktive dhe sfida të shumta brenda dhe jashtë Maqedonisë, të largohet nga ky sport”, tha Kurtoviq.

Publicitet

Bolt, nuk hidhërohem për tërheqjen time



Usain Bolt i jep fund karrierës nën ritmet e muzikës regaton. Kampioni xhajmak iu rezervua një lamtumirë e bukur me Bolt që në pamundësi për të marrë në stafetën 4*100 metra për arsye dëmtimi, doli në pistë vetëm për tu përshendetur me tifozët të cilën bënë gjithçka që 30-vjecari të ndihej mirë dhe ti jepte fund karrierës në një atmosferë festive. Rekordmeni i Botës në garat e 100 dhe 200 metrave, fillimisht falenderoi fansat për mbështetjen dhe ngrohtësinë që i kanë dhënë gjatë gjithë këtyre viteve dhe në këto momente të vështira. Bolt i dha fund karrirës në një moshë fare të re duke shokuar të gjithë Botën. 14 janë medaljet e fituara nga atleti xhamajkan në kampionatet Botërorë. Në

konferencën e lamutmirës Bolt shpjegoi disa prej arsyeve që i dha fund karrierës, ndërsa zbuloi edhe disa nga planet e tij për të ardhmen.

” Për mua ishte dicka brilante. Mbështetja e tifozëve nuk ka ndryshuar as pas vendimit tim për tu tërhequr nga sporti. E prisja këtë lloj entuziasmi nga ana e tyre dua ti falenderoj për gjithçka sepse më kanë bërë të ndihem shkëlqyeshëm. Nuk mendoj se disfata që pësova në garën e 100 metrave në Botëororin e Londrës mund të hedhë të gjitha sukseset e mëdha që kam arritur në karrierë. Edhe Muhamedd Ali humbi në përballjen e tij të fundit, kështu që nuk jam i stresuar për këtë fakt. Tani do të jem më i qetë. Kam që në moshën 10-vjecare

që merrem me sport dhe mendoj se kishte ardhur momenti për të thënë stop, për tu relaksuar disi dhe për të shijuar jetën. E ardhmja ime? Menaxheri po bisedon me presidentin e federatës ndërkombëtare të atletikës Sebastian Coe për të gjetur një mënyrë sesi unë të mund të ndihmoj në rritjen dhe zhvillimin e sportit. Ndërkohë që trajneri im më ka kërkuar që unë të jem asistenti i tij”.

Sido që të rrjedhin gjërat në sportin e atletikës emri i Bolt do të jetë i shkruar gjithmonë gërma të arta pasi dy rekordet e vendosura nga xhamajkani 9,58 në garën e 100 metrave dhe 19,19 në garën e 200 metrave vështirë se do të thyhen një ditë.



Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor e Republikës së Maqedonisë

SHPALL

Kërkesë për dhënie të Lejes për lëshuarje në ujë prej stacionit për pastrim rreth fshatit Dabilje, Komuna e Strumicës

Në përputhje me nenin 30 paragrafi 1 nga Ligji për ujërat („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14, 146/15 и 52/16), te Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor është dorëzuar kërkesë për dhënie të Lejes për lëshimin e ujërave të zeza nga stacioni i pastrimit e locuar 2 komuna katastarike edhe atë PK nr. 2875, 2876/1, 2876/2, 2876/3, 2876/4, 2877, 2879, 2880, 2881, 2883, 2874 и 2873, KK Dabilja dhe PK nr. 1483 KK Gr. Balldovci, komuna e Strumicës me УП1-11/5-1072/2017 me datë 19.07.2017.

**Dorëzues i kërkesës:
Komuna e Strumicës
Rr. “Sando Masev” nr.1
2400 Strumicë**

Koordinatat e pikës së lëshimit në lumin Tërkanja dhe koordinatat e stacionit të pompës hyrëse sipas sistemit koordinativ shtetëror janë:

- Pika e lëshimit:
P1 Y = 7 640 753.80 ; X = 4 589 144.07
- Stacioni i pompës:
P1 Y = 7 640 766 ; X = 4 589 245;

Informacione në lidhje me kërkesën, publiku i interesuar mund të merr në Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor në e-mail: S.Martulkova@moepp.gov.mk.

Pala në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes së kërkesës, ka të drejtë të dorëzon mendime dhe komente në formë të shkruar te Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor bulevari “Goce Dellçev” nr. 18 ndërtesa e RTM (kati i 10), 1000 Shkup.



Nasser: Erdha te Kukësi për të fituar trofe

Ai u transferua me shumë bujë te Kukësi në merkaton e kësaj vere, madje u cilësua nga menaxheri i klubit verilindor Naim Halili si i huaji më i mirë që ka ardhur ndonjëherë në kampionatin shqiptar. Por edhe pse nuk arriti të linte shenjën e tij në 2 ndeshjet ndaj Sherifit të Tiraspolit në turin e dytë të Champions-it, Siraj Nasser tashmë është ambientur sic duhet dhe është gati për të ndihmuar Kukësin të arrijë objektivat sezonale. "Kam rreth 1 muaj që jam pjesë e Kukësit, më pëlqen ambienti që kam gjetur këtu, më pëlqen skuadra. Shokët e ekipit më kanë ndihmuar të përshtatem sa më shpejt me klubin tim të ri si dhe të njoh Tiranën si qytet. Mendoj se do të zhvillojmë një sezon pozitiv. Është e vërtetë që nga skuadra janë larguar disa futbollistë cilësorë, por lojtarë të tjerë shumë të rëndësishëm janë bërë pjesë e Kukësit. Me mua por edhe me futbollistët e tjerë që i janë bashkuar ekipit besoj se Kukësi do të luftojë për të fituar trofe edhe në sezonin e ri". Me një të shkuar në klube të rëndësishme në Izrael si Hapoel Beer Sheva, Hapoel Tel Aviv dhe Bnei Sankhin, mesfushori 26-vjeçar nuk i trembet aspak konkurrencës te Kukësi, ndërkohë që i pëlqen



mënyra sesi e stërvit skuadrën trajneri i ri Mladen Milinkovic. "Konkurenca është dicka shumë e rëndësishme në futboll. Në cdo skuadër duhet të vuash konkurrencën. Unë jam një futbollist profesionist dhe duhet të jem i përgatitur për të përballuar me sukses konkurrencën në ekip. Mendoj se jam gati për të luftuar për një vend në formacion dhe nëse do ta meritoj mendoj se do të jem një titullar fiks te Kukësi. Edhe pse ka vetëm pak që e njoh, Milinkovic është një trajner i mirë. Ai punon fort dhe me të, të gjitha seancat stërvitore janë shumë in-

tensive. Me trajnerin e ri besoj se do të përmirësohemi dhe kam bindjen që ai do të bëjë një punë të mirë te Kukësi". Nasser ka ardhur te Kukësi me një objektiv të qartë të fitojë titullin kampion por edhe Kupën e Shqipërisë me verilindorët.

"Objektivi kryesor i Kukësit jo vetëm këtë vit por në cdo sezon është të luftojë për të gjithë trofetë e mundshëm. Unë kam ardhur pikërisht për të fituar sa më shumë tituj me Kukësin. Nuk e njoh mirë kampionatin shqiptar dhe nuk e di sesi në çfarë gjëndjeje janë rivalët tanë, por

e sigurtë është që kundërshtarët nuk janë më të fortë se ne dhe për mendimin tim Kukësi është gati për të konkurruar për cdo trofë". Në fund futbollisti izraelit bëri edhe një krahasim mes futbollit që luhet në Izrael dhe atij në Shqipëri. "Unë kam luajtur në Izrael gjatë gjithë karrierës time, atje luhet një futboll i shpejtë dhe i fortë. Por me aq sa kam kuptuar edhe në Shqipëri luhet një futboll i fortë dhe i ashpër dhe duhet të jesh i qëndrueshëm gjatë gjithë sezonit dhe të ruash të njëjtën performancë për të prentuar që të fitosh trofë".

Hamilton: Kur të lë F1, largohem edhe nga Mercedes

Lewis Hamilton i premtonte besnikëri Mercedesit. Piloti anglez edhe pse është shumë i kërkuar në merkato do ta vazhdojë karrierën te skuadra gjermane. "Të lë Mercedesin? Do ta bëj këtë vetëm kur t'i jap lamtumirë Formula 1-shit", deklaroi fillimisht Hamilton në një intervistë. 3-herë kampioni i Botës është shumë i lumtur dhe ka gjetur ambientin perfekt te Mercedesi. Kjo është një nga arsytet që Hamilton nuk e mendon aspak largimin nga skuadra gjermane.

Në muajt e fundit është përfolur shumë për një kalim të Hamilton te Ferrari duke patur parasysh faktin që 32-vjeçari është në skadencë kontrate me shigetat e argjendta. Williams është një tjetër skuadër që e stiumulon jo pak britanikun por vetë Hamilton ka larguar zërat e merkatos. "Nëse do të vendosja të largohesha një ditë nga Mercedes do të më duhej ta filloja gjithcka nga zero dhe nuk e di nëse do tia vlenë barra qeranë edhe pse Williams është një skuadër të cilën e admiroj dhe do më pëlqente që një ditë të isha pjesë e Williams dhe t'i riktheja ata në nivelet më të larta"- deklaroi, Lewis Hamilton.



Pas Granadës edhe Las Palmas do Manajin

Pas Granadës dhe një tjetër skuadër spanjolle interesohet për Rey Manajin. Sipas asaj që raportohet nga mediat ndërkombëtare, klubi i La Ligas po kërkon shërbimet e sulmuesit shqiptar, pas refuzimit që mori nga zikaltërit për Gabigol. Las Palmas kërkon të përforcojë repartin e sulmit dhe Manaj shihet si një alternativë e mirë për të qenë më produktivë në fazën e avancuar.

Aktualisht mësohet se klubi nga Ishujt Kanarie ka kontaktuar dhe me Interin, që mban kartonin e Rey Manajin, me të cilët sulmuesi ka një kontratë deri në vitin 2020 dhe po shihet mundësia e një kalimi të mundshëm të lojtarit në Primera. Pak ditë më parë një tjetër skuadër spanjolle, Granada shfaqti gjithashtu interes për Manajin, që në karrierën e tij ka veshur përveç fanellës së Interit, dhe atë të Cremonesës, Pisës dhe Pescarës. Primera Division mund të jetë një mundësi e mirë për Manajin për të vazhduar karrierën e tij pasi te Las Palmas mund të ketë një fanellë titullari të garantuar.



Nadal, në krye të klasifikimit ATP pas 3 viteve

Pas dicka më shumë se 3 viteve, Rafael Nadal do të jetë sërish numri 1 i Botës në tenis. 21 Gusht 2017-të, është kjo data në të cilën spanjolli do të ngjitet përsëri në majën më të lartë të klasifikimit Botëror, Atp, aty ku mungon që nga 6 Korriku i vitit 2014. Përgjashtë ndonjë surprizë do të jënë Rafa Nadal dhe Roger Federer dy tenistët që do të luftojnë për vendin e parë të renditjes deri në fund të këtij viti kalendarik, kjo edhe për faktin se britaniku Andy Murray po has shumë probleme ndërsa serbi Novak Djokovic ka komunikuar tërheqjen e



parakohshme nga ky sezon. Pas një sezoni fantastik deri tani të cilin e ka kurorëzuar me suksesin në Roland Garros, Nadal do të jetë sër-

ish numri 1 me shpresën për të mos e humbur me këtë pozicion edhe pse Roger Federer është aty i aftë për ta vënë në

vështirësi tenistin nga Mallorca dhe për ti rrëmbyer kreun. Zvicerani tashmë 36-vjeçar ka ndërrmarrë një pauzë të shkurtër dhe pas finales së humbur ndaj Zverev në Montreal, Roger Federer ka vendosur të tërhiqet nga Mastersi 1000 pikësh i Cincinattit. Një stop i detyruar ky për tenistin helvet i cili vuan ende disa probleme në shpinë. Periudha e pushimit do ta ndihmojë Federer-in të rikuperohet plotësisht dhe të jetë 100% gati për grand-slam-in e fundit të vitit, Us Open, turne që do të zhvillohet në fund të këtij muaji në Neë York.

Këta janë tre kandidatët për lojtarin më të mirë të Evropës

UEFA ka publikuar listën e tre kandidatëve për lojtarin më të mirë të vitit në Evropë. Ylli i Real Madridit, Cristiano Ronaldo, ai i Barcelonës, Leo Messi dhe portieri i Juventusit, Gianluigi Buffon janë tre kandidatët që luftojnë për lojtarin më të mirë të Evropës. Lajmi është bërë i ditur nga

faqja zyrtare e UEFA-s, e cila njofton se njëri nga këta do të jetë më i miri i vitit. Favorit prej këtyre treve është Cristiano Ronaldo, i cili me Real Madridin fitoi Ligën e Kampionëve, Superkupën e Evropës dhe La Ligan spanjolle. Fituesi do të bëhet i ditur me 24 gusht.





“Shpresoj të bëjë te Milan atë që Pirlo bëri tek Juventus, — ka thënë mbrojtësi kuqezi. — Në harkun e katër viteve shpresoj të fitoj Champions League. Dua të fitoj gjithçka”.

Do të jem Pirlo i Milanit, brenda 3-4 vitesh dua Championsin

“Juventus dhe Allegri kanë bërë disa zgjedhje të qarta gjatë vitit në disa situata të caktuara, unë kam bërë të miat në varësi të atyre zgjedhjeve”. Leonardo Bonucci është kthyer të flasë për largimin nga bardhezinjtë dhe për aventurën e tij të re: “Shpresoj të bëjë te Milan atë që Pirlo bëri tek Juventus, — ka thënë mbrojtësi kuqezi. — Në harkun e katër viteve shpresoj të fitoj Champions League. Dua të fitoj gjithçka”.

“Ambienti te Milan më pëlqen shumë, — ka vazhduar Bonucci. — Herën e parë që kam ardhur këtu jam ndier si në shtëpi. Është njësoj si të jesh pjesë e një familje të madhe. Pse kam zgjedhur Milan? Sepse ka një projekt më ambicioz. Më pëlqejnë sfidat dhe kjo është një sfidë e re, një faqe e re në karrierën time. Që nga fillimi drejtori Fassone, Mirabelli dhe trajnerit më kanë bërë të ndihem i rëndësishëm. Ka qenë kjo arsyeja pse kam zgjedhur Milan, bashkë me entuziazmin e tifozëve. Entuzi-



azëm që më ka befasuar dhe që më shtyn të jap akoma më shumë”.

“Shiriti i kapitenit? Është një zgjedhje në mirëkuptim me klubin, trajnerin dhe ekipin. Unë mund të vë në dispozicion të ekipit personalitetin, cilësitë e mia si lider dhe eksperiencën time pas 7 vitesh të kaluar me Juventus ku kam fituar kryesisht në Itali. Montolivo? Me atë kam folur që në fillim për atë që mund

të ndodhte. Askush nuk do të krijojë probleme për tjetrin. Nëse fitohet, nuk fiton vetëm kapiteni, por skuadra. Po, ka qenë një operacion i shpejtë. Dashuritë ose lindin menjëherë ose nuk lindin kurrë. Tek Juventus jam ndër mirë, kemi bërë një sezon të bukur, por që më ka ardhur keq që nuk e kemi mbyllur me fitore në Champions. Ajo që dua tani është të nis një aventurë të madhe me Milan

dhe të shkoj shumë lart. Allegri? Juventus është e kaluara dhe e falënderoj për atë që më ka dhënë”.

“Montella? Është mjaft i qetë, por i ka idetë e qarta. Më pëlqen mënyra se si ai e interpreton futbollin. Do të bëhet një trajner i madh. Kam folur me të, është shumë i zgjuar”. Më pas, në lidhje me merkaton: “Një sulmues i madh i bën gjërat më të lehta, do të ishte mbyllja perfekte e merkatos”.

Carlos Bacca huazohet te Villarreal

Carlos Bacca i thotë lamtumirë Milan. Dje, sulmuesi kolumbian që mbërriti me 4 orë vonë në Milanello u duk shumë pranë rikthimit në La Liga. Sot, lajmi u konfirmua dhe Bacca do të vazhdojë karrierën te Villarreal. Ai do të huazohet për 3 milionë euro me të drejtë blerje në fund të sezonit, nga “nëndetësja e verdhë”. Kjo ishte e vetmja pikë e marrëveshjes që nuk ishte arritur sepse Milan kërkonte ta bënte si të detyrueshme blerjen e Bacca, por në qershorin e ardhshëm do të jetë Villarreal që do të vendosë.



Ish-numri 70 i Milan ka përsëndetur disa nga shokët e skuadrës dhe është larguar për në Spanjë ku do të kryejë vizitat mjekësore dhe nesër

do të prezantohet si qendërsulmuesi i ri i Villarreal, që nëse do të vendosë ta blejë në vitin 2018 do të paguajë 20 milionë euro. Largimi i Bacca i hap rrugën kalimit te Milan të Nikola Kalinic, i cili prej kohësh ka shprehur dëshirën për t'u larguar nga Fiorentina. Nga momenti në moment pritet zyrtarizimi i transferimit të sulmuesit kroat nën urdhrat e Montella.

Shkëmbimi Sanchez-Benzema, ideja e çmendur e kësaj vere



Florentino Perez duket se është gati për goditjen galaktike të Real Madridit. Sipas raporteve nga “Don Balon”, presidenti i Merengues do të bëjë pjesë të skuadrës së tij sulmuesin e Arsenalit, Alexis Sanchez.

Kiliani bëhet objekt i parë i “Los Blancos” ngaqë dështoi në blerjen e Kylian Mbappe. Arsenali ndodhet në një situatë të vështirë me futbollistin në fjalë, sepse ai nuk ka rinovuar, ndërsa vitin tjetër rrezikon të largohet si transferim i lirë. Gjatë kësaj vere kanë shfaqur interes për

Sanchez Manchester City dhe PSG, por pa sukses. Në fakt, sipas “Don Balon”, Wenger do jo vetëm të holla për futbollistin e tij më të talentuar, por do ta mendonte edhe ndonjë shkëmbim, megjithatë, vështirë të pranojë Zidane. Ideja është që “topçinjtë” të japin Sanchez për Real Madridin dhe t'i marrin këtij të fundit Karim Benzema. “Fantamercato” është një zgjidhje që nuk u pëlqen Merengues-ve, të rregulluar me një shpenzim prej 70 milionë eurosh për Niño Maravilla.

Tevez kthehet në Argentinë, por me një kusht



Sulmuesi i mirënjohur, Carlos Tevez, ka marrë leje të veçantë për të shkuar në Argentinë, por vetëm pasi ka firmosur një kontratë që e detyron atë që të kthehet te skuadra kineze e Shanghai

Shenhua, para datës 30 gusht. Ka pasur zëra se 33-vjeçari, i cili kaloi nga Boca Juniors te Shanghai në muajin dhjetor, dëshiron të largohet nga klubi kinez, pavarësisht se është futbollisti më i paguar i planetit, por lajmet e fundit nga Azia tregojnë të kundërtën. “Në bazë të kërkesës së Tevez, klubi ynë, pas një diskutimi të gjatë, vendosi të aprovojë lejen për ta lënë 15 ditë në Argentinë, por ai ka firmosur një dokument që e detyron të kthehet në klub brenda datës 30 gusht,” — lexohej në komunikatën për shtyp të klubit kinez. Duket se kinezët kanë marrë masa që të mos përsëritet viti 2011, kur Tevez u largua për pak ditë nga City për në Argentinë, por nuk u kthye më kurrë si pasojë e problemeve me trajnerin Mancini. Atëherë, City e gjobiti me rreth 10 milionë euro, paga e tij vjetore.

Inter heq dorë nga Mor

Skuadra italiane, Inter nuk do të transferojë anësorin turk të Borussia Dortmund, Emre Mor. Fillimisht ishte arritur marrëveshja që Inter të paguante 3 milionë euro për huazimin një vjeçar dhe të transferonte verën tjetër. Por, shkaku tashmë ata kanë hequr dorë, shkaku i shumës që kërkonte agjenti i lojtarit për këtë transferim, shkruan Sport Italia. Inter tashmë duhet të shikojë alternativa tjera, para se të mbyllet afati kalimtar me 31 gusht.



Juventus ofron 20 milionë për Matuidi, pret edhe Keitan

Juventus, ashtu siç ishte parashikuar të hënën në mbledhje, ka vendosur për të nisur sulmin vendimtar ndaj Blaise Matuidi të PSG-së. Në sajë të punës së Mino Raiola, agjentit të lojtarit, nga kërkesa fillestare prej 30 milionë euro, bardhezinjtë janë në gjendje ta mbyllin operacionin për një shifër prej rreth 15 milionë eurosh, plus bonuse, dmth

20 milionë euro gjithsej. Lojtari në dy ndeshjet e para të Ligue 1 u aktivizua 88 minuta kundër Guingamp. Dhe për t'i bërë gjërat edhe më keq, parizienët kanë një negociatë të vazhdueshme me Monako për të marrë Fabinho. Të gjithë këto elementë sugjerojnë mbylljen e marrëveshjes me Matuidi dhe ardhjen e lojtarit në Itali të enjten, ose të premten.

Emri i Matuidit është kthyer në modë, pas përpjekjeve (të kota) të Marotta dhe Guild për të marrë Emre Can, Kovacic dhe Strootman. Sipas edicionit të sotëm të “Gazzetta dello Sport” nuk është e pamundur që të bëhet një goditje e mëtejshme në mes të fushës. Emrat janë ato të Andre Gomes, N’Zonzi dhe Wilshere. Tjetër kapitull është Keita. Juven-

tusi, që i ka vënë në pjetë 20 milionë euro për të, ndodhet përpara një tjetër sulmi për lojtarin e Lazios. Aktualisht po testohet situata e brendshme në mes presidentit Lotito dhe lojtarit. Lazio duhet të mendojë për faktin se lojtari do ta përfundojë kontratën në vitin 2018 dhe për këtë arsye ka rrezik të madh ta humbasë si një transferim të lirë.



DASHI (20/III-20/IV)



Dita e sotme do të nisë me Hënën që është shumë stimuluese, për sa i përket ambientit familjar. Në punë mundohuni të prisni deri nesër për sqaruar një keqkuptim me një koleg. Paraqiten marrëdhënie të mira me miqtë dhe partnerin, ku nuk do të mungojë shkëmbimi i ideve të ndryshme.

DEMI (21/IV-20/V)



Ndonjëherë është e nevojshme të frenoni entuziazmin tuaj, për të mos rrezikuar të bëni shumë konfuzion. Sot falë ndikimit hënor do të keni mundësi të zbuloni situata interesante dhe t'i jepni jetë diçkaje që do t'i rezistojë kohës.

BINJAKËT (21/V-20/VI)



Hëna dinamike ju jep energji, ndjeshmëri, ekuilibër dhe dëshirë për ndryshim. Do të rikthehet një klimë e qetë në shumë aspekte. Edhe disa tensione që keni pasur kohët e fundit në sferën sentimentale do të zhduken duke ja lënë vendin mirëkuptimit.

GAFORRJA (21/VI-22/VII)



Falë cilësive tuaja, si guximi, perfeksioni dhe pjekuria do të arrini të bëni hapa të rëndësishëm në jetën tuaj pa u trembur se mund të gaboni. Përveç se do hapet një periudhë e shkëlqyer për sa i përket dashurisë, konfi gurimi i ditëve që do të vinë do ju ndihmojë të kaloni pengesa.

LUANI (23/VII-22/VIII)



Mund të jetë një moment me të vërtetë i rëndësishëm ky. Shumë situata do të kthehen në favorin tuaj, sidomos nga pikëpamja ekonomike. Së shpejti do të merrni propozime dhe fi time të papritura. Në dashuri kujdes mos harxhoni energjitë tuaja për një person që nuk ndjen të njëjtën gjë karshi jush.

VIRGJËRESHA (23/VIII-22/IX)



Do ta fi lloni këtë javë me pak dëshirë për t'u impenjuar në aktivitetet e përditshme. Keni nevojë për pak pushim, kushtojni pak kohë vetes tuaj. Mundohuni të evitoni konfliktet me personat që ju rrethojnë. Që nesër do të fi lloni të ndjeheni më mirë.

PESHORJA (23/IX-22/X)



Në këtë ditë të qetë do të ndjeheni xheloz pa pasur ndonjë shkak. Kjo vjen pa dyshim si kundërshtim i Hënës me shenjën tuaj. Duhet t'i lini më shumë hapësirë njeriut që ju dashuron ose në të kundërt ai do të ndjehet i lodhur nga xhelozia juaj.

AKREPI (22/X-21/XII)



Duke fi lluar që sot do të keni një humor më të qetë dhe do të jeni më të gatshëm për të bashkëpunuar me botën që ju rrethon. Do të keni shumë fantazi dhe imagjinatë, mundohuni ta përdorni në diçka të vlefshme dhe të bukur. Dashuria do të paraqitet më mirë se ditët e kaluara.

SHIGJETARI (22/XI-21/XII)



Sot aftësia për t'i dhënë jetë idealeve, frymëzimeve dhe realizimit të ëndrrave tuaja më ambicioze do të jetë e madhe. Gjithashtu aftësia për të penetruar në shpirtin e personave që ju rrethojnë duke mbështetur dëshirat e tyre do ju bëjnë të jeni të kërkuar në çdo ambient.

BRICJAPI (22/XII-20/I)



Sot do të jeni shumë konfuz. Përpara se të merrni një vendim të rëndësishëm për sa i përket shtëpisë, familjes ose një biznesi të rrezikshëm, kërkoni këshillën dikujt që është më ekspert se ju. Yjet në kundërshtim me shenjën tuaj ju sugjerojnë të tregoheni më të kujdesshëm kur të hidhni fi rmen në disa dokumente të rëndësishme.

UJORI (20/I-19/II)




Sot do të jeni shumë konfuz. Përpara se të merrni një vendim të rëndësishëm për sa i përket shtëpisë, familjes ose një biznesi të rrezikshëm, kërkoni këshillën dikujt që është më ekspert se ju. Yjet në kundërshtim me shenjën tuaj ju sugjerojnë të tregoheni më të kujdesshëm kur të hidhni fi rmen në disa dokumente të rëndësishme.

PESHQIT (20/II-19/III)



Të nënvlerësoni pengesat që ju paraqiten mund të jetë një gabim i madh ndërsa t'i përballoni ato me qetësi mund të jetë një avantazh për ju. Harroheni të shkuarën në qoftë se jeni zhgënjyer dhe hapini dyert e zemrës të ardhmes, që me ndihmën e Hënës ju bën të riilindi.



NE KETE DATE	KËNGËTARI AMERIKAN NE FOTO	LIDHËZ, AMA	ITALI	QYTETI I LINDJES SE KËNGËTARIT NE FOTO (NE MISISIP)	I VOGLI I DHISE (PASHQ)	TË NË BASHKIE SHQIPTRE	FUTBOLLISTI BULLGAR, JORDAN	Mensur Mamuti	TITULLI I KËNGËTARIT NE FOTO	NEVOJË PER USHQIM	KËNGË E KËNGËTARIT NE FOTO (ORIGJ)	JO LARG PRANE
								SOPRANOJA JONE, INVA				
								NGRIHEM MENJEHERE ME KEMBE				
								VË PËRSERI				
								SPANJË	ERBIUM	INSHALLAH (SHKURT.)		
								EKIP PËRFUNDIM				FILM ME KËNGËTARIN NE FOTO
KOHA	KËNGËTARI AMERIKAN NE FOTO	LIDHËZ, AMA	ITALI	QYTETI I LINDJES SE KËNGËTARIT NE FOTO (NE MISISIP)	I VOGLI I DHISE (PASHQ)	TË NË BASHKIE SHQIPTRE	FUTBOLLISTI BULLGAR, JORDAN					
EMËR QË I NGJITET DIKUJT							PJESA E ZGJATUR TE DJSA KAFSHE					
UJË (FRENGJ)			RRUGËTAR				NGJYRË LËKURE				ELEKTRO VOLT	
RENDJE VRAPIM					TRIMËRESHA							
IMPULS		QYTET NE GREQI									DALAJ LAMA	
ZBUKUROJ, HUESHUJ		QYTET NE XHORXHI, SHBA						VRAPUESI ITALIAN, PIETRO				
PROVINÇE ROMAKE NE TOKAT E BALLKANIT								LIDHËZ, POR			NATI, OUTBREAK REPORT, SYST.	
REAL LIFE ANALYTICS				SHKRIM, GJERM, HERL (SHQ)							NDËRTUESI ITALIAN I VIOLINAVE	
KOMEDIANI ANGLEZ, FRED				EMRI ORIGJ. IRLANDES				E PA FORMË				VOLT
								LEC BUSHATI				MBARËSI, RISK (SH. PASHQ)
SHOQËROR								E KUQE			ARGJEND	
								ALEKS FERGUSON			KALLAJ	
LITËR		FLORI			FUTB. BRAZIL, ZHOAO DA SILVA							
		AZOT			RËNTGEN							
KLUBI FUTBOLLISTIK ITALIAN, INTERVAZIONALE								GJIMNASTIKË REKREATIVE				

ZGJIDHJET: MULA, BROF, RIVE, E, ER, TIM, MINEV, EPITET, BISHTI, LO, UDHËTAR, EV, VRAP, HEROINA, I, SELANIK, DL, STOLIS, MENEVA, PANONIA, NORS, RLA, OTMARI, V, EMNEJ, AMORFE, SOCIAL, ALL, AG, L, AR, BATISTA, INTER, FITNES.

Sudoku

shumë i lehtë

5	3			2		1	9
	1	2	5		7	4	
		7			5		
9			6			2	
		8	5				
	7		4				8
		9		4			
	2	1		3	6	8	
4	6		7			9	3

shumë i vështirë

		9			4		7
	3			9			
		6	5	1			8
		5		7	3		
7		2	6		5	3	9
			1	4		5	
6				5	7	2	4
				3			8
8		7					

Shumë i lehtë: 534672819, 812539746, 697184532, 958367124, 143825967, 276941358, 389256471, 721493685, 465718293. Shumë i vështirë: 189362457, 534798126, 276514938, 945273861, 712685349, 368149572, 693857214, 421936785, 857421693.



Nacionalistët gjermanë vendosin posterë anti-Islam

Një udhëheqës i partisë anti-emigracion në Gjermani ka deklaruar se ka hequr dorë nga shpërndarja e posterave me sloganin: “Islami nuk përputhet me kuzhinën tonë”, në të cilët postera ishte shfaqur një derr në një fushë bari. Aleksandër Gauland, një nga alternativat nacionaliste për kandidatët kryesorë të Gjermanisë në zgjedhjet e 24 shtatorit, thotë se posteri është “i papërdorshëm”. Megjithatë, partia AfD ka filluar një fushatë të re anti-Islam, duke shpërndarë postera me dy gra në bikini dhe

me sloganin: “Burka? Më pëlqejnë bikinit”. Sipas gazetërs Bild, Gauland ka deklaruar se posteri i mëparshëm me derrin nuk kishte të bënte me Islamin, por ishte për kujdesin ndaj kafshës që gjermanët e pëlqejnë. “Fushata e posterave me derr s’ka të bëjë me Islamin, kështu që mos u merrni me të”, citohet të ketë thanë ai. Sipas sondazheve të fundit në Gjermani, partia AfD ka arritur të mbledhë vetëm 8 për qind mbështetje për zgjedhjet që priten të mbahen në shtator

KALENDARI HISTORIK 16 GUSHT

- 1717 - Princ Eugjeni i Savoijt pushton Beogradin.
- 1777 - Amerikanët mundin britanikët në Betejën e Beningtonit.
- 1794 - Revolucionari hungarez Ignác Martinovics arrestohet në Vjenë.
- 1904 - Në New York City fillon ndërtimi i Grand Central Station.
- 1924 - Nënshkruhet marrëveshja e paqes mes Turqisë dhe Holandës.
- 1934 - SHBA largohet nga Haiti (e ka mbajtur të okupuar që nga viti 1915).
- 1943 - Cari i Bullgarisë Borisi III viziton Adolf Hitlerin.
- 1944 - Holanda fillon kontaktet diplomatike me Vatikanin në Londër.
- 1961 - Martin L King proteston për të drejtat e zezakëve për votim në Majami.
- 1986 - Rebelët e Sudanit qëllojnë aeroplanin Fokker's F-27 ku vrasin 57 persona.

A E DINI SE... ?



ADN-ja u zbulua fillimisht në vitin 1869 nga zvicerani Friedrich Miescher.

Në moshën 5-vjeçare, Ayan Qureshi e kaloi provimin e Microsoftit Teknik IT dhe u bë specialisti më i ri në botë i certifikuar nga Microsoft.



Kavah Ijen është vullkani i vetëm në botë që lëshon llava të kaltër.

BARSOLETA



VAJZA E PISPILLOSME

Vajza u vesh u pispillosme... Babi: Ku po ikën moj bijë tani në gjysmë të natës? Vajza: Në banjo babi, më duhet urgjentisht një foto e re profili në Facebook.

AI DHE AJO

Ajo: Shpirt më duket vetja shumë e shëndoshë, e shëmtuar dhe e plakur. Të lutem më bëj një kompliment. Ai: Zemër ke shikim shumë të mirë...

THËNIA E DITËS

Të mençurit janë të mençur vetëm për shkak se dashurojnë. Budallenjtë janë budallenj vetëm për shkak se mendojnë që mund ta kuptojnë dashurinë. (Paulo Coelho)



Nëse ju dalin thinjat në moshë të re, urgjent tek mjeku

Flokët e bardha apo gri nuk tregojnë medoemos plakjen. Flokët fillojnë të zbardhen kur rrënjët nuk prodhojnë më melaninë, pigmentin që i jep ngjyrë flokëve. Thinjat fillojnë të shfaqen zakonisht në moshën 30-vjeçare, por nuk do të thotë që një 20 vjeçare mund të mos ketë thinja. Përpos melaninës janë disa faktorë të tjerë të cilët luajnë një rol

të rëndësishëm në daljen e thinjave. Pirja e duhanit, faktorët e jashtëm mjedisorë si rrezet ultravjollcë dhe ajri tepër i ndotur janë shkaktarë të flokëve gri. Në raste të rralla, thinjat e parakohshme mund të jetë një shenjë e sëmundjes vitiligo, anemi (kur trupi e ka të vështirë thithjen e vitaminë B12) ose problemet që përfshijnë hipofizën apo gjendrat tiroide.



Doni që kuleta juaj të jetë gjithmonë plot? Ndiqni këto këshilla dhe nuk do të zhgënjejeheni

Një pjesë e madhe e popullatës ankohet për gjendjen financiare, ky po që është një fakt i cili ndikon shumë edhe në gjendjen e njeriut. Por, sipas shumë mitologjive, ekzistojnë disa truke të cilat bëjnë që kuleta juaj të mbushet. Nëse keni dëgjuar se është mirë që kuletën t’ua blejë një person tjetër dhe jo vetë ju, menjëherë hiqni dorë nga ky mendim. Asnjëherë nuk



dihet se çfarë energjie apo fat i parave e përcjellë atë person. Kuletën është mirë ta blini vetë dhe po ashtu

duhet vënë mendjen tek ngjyra, që për femra duhet të jetë e kuqe e zjarrtë apo ngjyrë ari, ndërsa për

meshkuj nuancat e metalit. Po ashtu, kuletën duhet ta doni dhe ta mbani kudo me vete. Një fakt tjetër është edhe sistemimi i parave, sepse nëse paratë janë të pasistemuara, kjo ndikon edhe në shumimin e tyre. Gjithsesi, vlen të ceket se asnjëherë nuk është mirë që në kuletë të mbani fatura, sepse kjo jep një energji që shpjen gjithmonë në shpenzim dhe shpajim borxhi.